

Fjalorthi i botanikës nga FGJSSH (1980)

Mr. Agim Spahiu

10 mars 2009

Përmbledhje

Ky Fjalorth është nxjerrë në mënyrë elektronike (automatikusht), me anë të programeve: *grep*, *sort*, *uniq*, *awk* etj., duke u mbështetur në **Fjalorin e gjuhës së sotme shqipe** të vitit 1980.

- ABANOZ** m. Bimë e vendeve të nxehta, me dru të çmueshëm, të rëndë e të fortë, zakonisht me ngjyrë të zezë, i cili përdoret për orendi, për vegla muzikore e për punime artistike. Abanoz i zi (i kuq). Dru abanozi. Orendi prej abanozi. Vegël muzikore prej abanozi.
- AFION** m. 1. shih HASHASH,~I 1.
- AGALLAR** m. sh. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të gjatë, me fletë gjatoshe e me push, që rritet në livadhe e në gurishta dhe që lulëzon në qershor-gusht.
- AGAVE** f. Bimë e vendeve të ngrohta, me gjethe shumë të gjata, të trasha, me tul, të dhëmbëzuara e me gjemba, nga të cilat nxirren fije për industrinë tekstile, për litarët etj. Fije agaveje. Lulet e agaves. Rritja e agaves.
- AGNUSHE** f. Bar zemre, sanëz.
- AGRUME** f. vet. Emër përmbledhës për portokallet, limonët, mandarinat, nerënxat dhe për drurë të tjerë frutorë të këtij lloji, që rriten në vende të ngrohta dhe që janë gjithnjë të blertë; kokrrat, frutat e këtyre drurëve. Mbjellja (rritja) e agrumeve. Plantacione agrumesh. Vjelja e agrumeve. Lëngje agrumesh.
- AGULIÇE** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të hollë, me gjethe vezake, me lule të verdha, që rritet në livadhe dhe që çel në fillim të pranverës; lule pranvere. Çelin (dalin) aguliçet. Mbledh aguliçe.
- AGULIÇORE** f. vet. Emër i përbashkët për aguliçet dhe për bimët e tjera barishtore, që hyjnë në një grup me to.
- AH** I m. Dru gjethor i pyjeve malore, me trung të trashë, me lëvore të lëmuar të bardheme ose ngjyrë mishi, lënda e të cilit përdoret për orendi, në ndërtim etj. Ah i bardhë (i kuq). Pyll ahu. Dru ahu. Dërrasë ahu. Tryezë (dollap) ahu.
- AHORE** f. vet. Emër i përbashkët për drurë si ahu, dushku, gështenja e të tjerë, që hyjnë në një familje me ta. Familja e ahoreve.
- AJAZMË** II f. shih MEND/ËR,~RA. Ajazmë e egër (e butë).
- AJDËS** m. Dru gjetherënës i pyjeve malore, me lule të verdha në vile, lënda e të cilit është e fortë dhe përdoret për orendi, për sende zbukurimi etj.; karthë. Dru ajdësi.
- AJROR** mb. 2. Që ndodhet në ajër, që nuk është i futur në tokë. Pjesa ajrore e bimës. Rrënjë ajrore.

- AKACIE** f. Dru bishtajor i vendeve të ngrohta, me lëvore të plasaritur, me gjemba, me gjethe vezake të renditura në të dy anët e një bishti të gjatë dhe që bën lule zakonisht të bardha, të grumbulluara në vile e me erë të mirë; drizë e butë. Akacie e bardhë (e verdhë. Pyll akaciesh. Lule akacieje.
- AKSH** m. Trikë, bar ethesh.
- AKSHAM** m. vjet. * Lule akshami shih te LUL/E,~JA.
- AKTH** m. krahin. shih MAKTH, ~I I.
- AKULL** m. 3. Lule akulli shih te LUL/E, ~JA.
- ALL** mb. * Lule alle shih te LUL/E,~JA.
- ALLME** Bimë me kërcell e me gjethe si të lulediellit që i ka rrënjët si patate e që hahen.
- AMË** I f. 4. anat., shih VEZOR/E,~JA.
- ANANAS** m. Bimë e viseve tropikale të Amerikës, që i ka gjethet të gjata e me gjemba dhe që bën kokrra të mëdha vezake me një tufë të vogël gjethesh në majë, me tul të ëmbël, me lëng e me erë të mirë; fryti i kësaj bime. Lëng ananasi.
- ANËSOR** mb. Gjethe (rrënjë) anësore.
- ANGJINARE** f.
Bimë barishtore shumëvjeçare e viseve të ngrohta, me gjethe të mëdha të prera thellë, që mbillet për lulet si kokë me fletë të tulta, të cilat përdoren si ushqim dhe për të përgatitur pije, barna mjekimi etj.; lulja e paçelur e kësaj bime. Kokë angjinareje. Sallatë me angjinare.
- ARAPLI** m. krahin. Gjethe delli, dejëz. Fletë arapliu.
- ARASHKË** f. krahin. Panxhar; rrepë. Arashka sheqeri. Arashkë e egër.
- ARGAN** m. Bimë kaçubore me dru të përdredhur si të dëllinjës, me gjethe heshtore, shumë të vogla e të shpeshta, me lule ngjyrë vjollce, që përdoret për të ngjyer rroba.
- ARGJEND** m. * Bar argjendi këputje. Lule argjendi shih te LUL/E,~JA.
- ARITH** m. krahin. Këputje, bargjan.
- ARITHE** krahin. Urithe.
- ARNE** m. Lloj pishë mali me hala të holla e të shkurtra, të vendosura pesë e nga pesë; pishë ballkanike, molikë. Arneni i zi (i bardhë). Pyll arneni. Bucelë arneni.
- ARQITË** f. krahin. 1. Shelg i butë.
- ARTI** m. Pishë mali, rrobull. Artiri i kuq (i bardhë). Pyll artiri.
- ARUSHË** f. Lule arushë dorëzonjë. Rrush arushe shih te RRUSH,~I.
- ARRAKAÇE** f. krahin. Lulekaçe.
- ARRÇ** I m. Shkurre gjetherënëse dy-tre metra e lartë, me gjethe të këmbëra si të arrës, me lule të blerta në të verdhë, që bën kokrra të vogla e të zeza dhe që përdoret për ngjyrosje e në mjekësi; pjerëz. Arrç i egër. Gjethe arrçi.
- ARRÇORE** f. vet. Familje drurësh, që përfshin drurë e shkurre si arrçi etj.
- ARRË** f. 1. Pemë frutore me trup të lartë e të trashë, me dru të fortë e shumë të mirë për orendi etj., me lëvore të lëmuar ngjyrë hiri, me gjethe të mëdha e me lule si vile, që bën kokrra me lëvozhgë të fortë, me shark të gjelbër e me thelb të ushqyeshëm, të ndarë në katër pjesë; kokrra e kësaj peme. Arrë gunge. Arrë gajgë (rukë). Arrë bukje arrë me thelb të madh, të plotë e që del lehtë. Arrë mishje arrë së cilës nuk i del thelbi lehtë. Arrë pjeshke arrë që i ndahet lehtë thelbi. Arrë vajëse. Arrë fyçkë (fyrbë). Dru arre. Gjethe arre. Vaj arre. Thelbi i arrës. Ngjyrë arre ngjyrë kafe e murrme. Thyej (çaj) arra. I ushqyer me thelpinj arre i ushqyer mirë, me gjëra të mira.
- ARRË** HINDI Dru i egër, i ngjashëm me arrën, me lëvore të murrme, me gjethe që kanë një erë të rëndë, me lule të vogla të bardha e me fryt si bishtajë ngjyrëkafe.

- ARRËS** m. Bimë barishtore ose gjysmëshkurre gjetherënëse, e përhapur sidomos në vendet e Mesdheut, me lule në trajtë vile, që përdoret si bimë aromatike dhe në mjekësi. Arrësi i verdhë bar dhëmballe.
- ARRËZ** III f. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe si të tërflilit, të vendosura dendur rreth kërcellit, që rritet nëpër fushat anës detit.
- ARRORE** f. vet. Familje drurësh dhe shkurresh, në të cilën me e njohura është arra.
- ASHE** f. Shkurre e viseve malore gjithnjë e blertë, me gjethe të ndritshme, të dhëmbëzuara e me gjemba, me lule të bardha a ngjyrë trëndafili, që rritet edhe si bimë zbukuruese. Ashe mali. Druja e ashes.
- ASHËR** II f. Gështenjë e egër.
- ASHT** II m. Bimë barishtore njëvjeçare e livadheve, me gjethe të vogla e të rralla në trajtë vezake, me lule ngjyrëvjollcë dhe me kërcell të degëzuar, që kur këputet lëshon një lëng të bardhë.
- ATHJE** f. shih ATHJEZ,~A.
- ATHJEZ** f. Bimë barishtore njëvjeçare, me trup të vogël e të degëzuar, me lule ngjyrë trëndafili, të verdha a të katërta dhe me gjemba të mprehtë e të helmet; ferrënuse. Rrënjët e athjezës. Zë athjeza gruri.
- BABANIK** m. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë, me gjethe gjatoshë e të dhëmbëzuara, me lule të bardha, të verdha në të blertë ose të kuqe, që përdoret në mjekësinë popullore si bar për plagë. Gjethe (lule) babaniku. I vuri babanik lungës.
- BABË** m. 2. vet. nj. Bimë me farë, që luan rolin e mashkullit në kryqëzimin për të nxjerrë një lloj të ri. Bimë babë. Farë babë.
- BADËR** f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të degëzuar e të lartë rreth një metër, me rrënjë si qepujkë, me gjethe si të preshit dhe me lule të vogla e të bardha, që rritet në kullota dimërore e lulëzon në pranverë; presh i egër. Badra e malit. Badër uji. Lule badre. Karabush badre.
2. Shpatore, luleshpatë.
- BAFËR** f. Rrunjë, qelbës. Shartoj bafër.
- BAGOLINË** Bar i ngjashëm me tërflin, i lartë afër një gjysmë metri, me gjethe të holla, që çel lule në ngjyrë limoni.
- BAJAME** f. 1. Pemë e vendeve të ngrohta, me gjethe të vogla e heshtake dhe me lule të bardha ose ngjyrë trëndafili, që çelin në pranverë; fryti i këtij druri, që ka trajtë vezake dhe lëvozhgë të fortë e të lëmuar; thelbi i këtij fryti, që ka shije të ëmbël ose të hidhur. Bajame e ëmbël (e hidhur). Bajame të pjekura (të qëruara, të thata). Bajame me kripë. Vaj bajamesh. Llokume me bajame. Me sy si bajame.
- BAKËM** m. 1. Dru i vendeve të nxehta, i fortë e me ngjyrë të kuqe, që përdoret për mobilie dhe për të ngjyer. Orendi (tryezë) bakëmi. Bojë (ngjyrë) bakëmi.
- BALÇ** m. 1. Lule balsami. Lule balçi. Lëng balçi.
- BALKROCË** f. Lloj trëndafili, me gjethe gjithmonë të blerta, me lule të bardha, me erë të mirë e të grumbulluara në tufa; trëndafil breshke.
- BALOSHE** f. 2. Mështekën.
- BALSAM** m. Lule balsami shih te LUL/E,~JA.
- BALTËROK** m. Shkurre deri një metër e lartë, e ngjashme me pjerzën e shkëmbinje, me gjethe të forta, të qëndrueshme e me dhëmbëza afër majës, me lule të verdheme, që bën kokrra në ngjyrë si në të verdhë ose të kuqërreme.
- BALTHUKË** f. Shkurre e madhe me dru të lakueshëm, me gjethe të vogla gjatoshë, me lule të verdha, që i kanë petlat të ngjitura si luspat e peshkut e me erë të keqe.
- BALLËBRESHTËZ** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, e ngjashme me grashinën, me gjethe të vogla e të renditura dy e nga

dy në bisqe, me lule të bardha e në tufë si të akacies, që rritet në ara e livadhe dhe që është ushqim i mirë për kafshët.

BALLGUN m. krahin. Shpardh.

BALLKOT m.

1. Bar peshku. Zë peshk me ballkot. 2. Një lloj gruri kokërbardhë, me hala të gjata. * I dha barin e ballkotit dikujt i mori mendjen, e trullosi.

BAMBU f. Bimë e vendeve të nxehta, me kërcell të drunjtë, të fortë, të gjatë, me nyja dhe përbrenda fyl si kallami. Shkop bambuje. Shportë (kanistër, kapele) bambuje. Kasolle bambuje. Pyje me bambu.

BAMJE f. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të degëzuar, me gjethe të mëdha e të çara si pëllëmbë, që bën bishtaja të vogla, shumëfaqëshe e si bri dhe që rritet si perime; bishtaja e kësaj bime, që përdoret për gjellë. Bamje të njoma. Gjellë (mish) me bamje.

BANANE f. Bimë e vendeve të nxehta, me trup të lartë, me gjethe shumë të mëdha, me lule si vile, që bën fruta të gjatë, të kthyer, të tultë, me lëkurë të trashë e të lëmuar, me ngjyrë të verdhë kur piqen, të ëmbël e me erë të mirë; fruti i kësaj bime. Pyll bananesh. Lëkurë bananeje. Ngjyrë bananeje. Akulllore me banane. Qëroi bananen.

BAOBAB m. Dru tropikal me trung shumë të trashë dhe me kurorë të gjerë, që bën kokrra të mëdha si kunguj. Baobabi afrikan.

BAR I m. 1. Bimë zakonisht njëvjeçare, me kërcell të hollë e të njomë që nuk drunjëzohet, me gjethe të holla e të gjata në ngjyrë të gjelbër, e cila mbin e dendur në livadhe e në vende të tjera dhe shërben kryesisht si ushqim për kafshët; përmb. tërësia e bimëve të këtij lloji, që rriten vetë në livadhe, në ara etj.; mbulesa e gjelbër me këto bimë; lëndinë. Bar i gjelbër. Bar i njomë (i ri, i thatë). Bar i egër bimë barishtore që mbin e rritet vetë. Bar i dendur. Bar helmues (i kripur). Bar mali (kënete). Bar vjeshte.

BAR ARGJENDI shih KËPUTJ/E,~A II.

BAR BALSAMI shih BALÇ,~I.

BAR BERONJE Bimë barishtore me gjethe si të rigonit e me lule të bardha, që rritet tufë zakonisht nëpër shkëmbinj dhe që përdoret në mjekësinë popullore për gratë që nuk lindin.

BAR BIBE Bimë barishtore deri një metër e gjysmë e lartë, me lule të bardha si push, me gjethe të gjata e të holla që dalin tufë afër rrënjës dhe që përdoren për mjekimin e verdhëzës së bibave.

BAR BLETE Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe vezake, me push e me erë të mirë si të limonit, me lule ngjyrë trëndafili ose të bardha, që përdoret për të mbledhur bletën kur roit; milcë, lule limoni.

BAR BRENJE Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të degëzuar, me lule të imëta ngjyrë trëndafili, me gjethe si të shelgut e me push në të dy anët, që zihet e përdoret për mjekime popullore.

BAR BRESHKE Një lloj bari si qumështorja, që lëshon kalli si gruri dhe që e ha shumë breshka.

BAR BUÇI Bar gjarpri.

BAR DALLËNDYSHEJE Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të vogla gati të rrumbullakëta, të cilat kanë në mes një njollë të zezë.

BAR DELLI shih GJETHE DELLI.

BAR DERRI Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të trashë e të gjatë dhe me lule si të fshesës.

BAR DJATHI Bimë që përdoret për të zënë qumështin djathë.

BAR DHËMBALLE shih ARRËS,~I.

BAR ETHESH shih TRIK/Ë,~A.

BAR FARE Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të gjata e të holla, me kalli si egjra e me fara, që përdoren në mjekësinë popullore.

BAR GOMARI shih GJEMBAÇ,~I.

- BAR GRISKLE** Bimë barishtore shumëvjeçare, që rritet në pyje e në shkorre, që i ka gjethet të vogla e lulet në trajtë kupe, ngjyrëmanushaqe e të vendosura rresht anës kërcellit dhe që e bën frytin si boçe.
- BAR GRYKE** Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë e të mbuluar me push dhe me gjethet të çara anash.
- BAR GURI** Bimë barishtore njëvjeçare, me lule ngjyrë vjollce, që rritet zakonisht nëpër shkëmbinj dhe bën farë prej tri kokrrash të imëta e të kuqe.
- BAR GJAKU**
a) Bimë barishtore, me kërcell të gjatë mbi një pëllëmbë, i cili, kur këputet, nxjerr një lëng në ngjyrë të kuqe. b) shih BISHTMI, U 1.
- BAR GJALPI** Lloj bari që ka erë si të bulmetit.
- BAR GJARPRI** Bimë barishtore shumëvjeçare, pa lule, me zhardhok, me gjethet dhe kallirin si të këlkazës, që përdoret në mjekësinë popullore kundër helmimit të bagëtive nga gjarpri.
- BAR GJEDHENI** shih KËPUTJ/E, ~A II.
- BAR HELMI** Bimë barishtore me kërcell të gjatë e të degëzuar, që nxjerr lule të verdha dhe që është helmuese për bagëtinë.
- BAR HËNËZE** Bimë barishtore shumëvjeçare, me rrënjë të gjatë boshtore, me gjethet të renditura në një bisht njëra kundrejt tjetrës, me lule si të grashinës, që mbillet në toka të varfra si ushqim për bagëtinë.
- BAR HIKRRAQI** shih SYKA, ~U.
- BAR HIRRE**
a) Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethet si të koprës së egër, me lule të bardha, që rritet nëpër lëndina dhe që i hidhet gjizës për t'i dhënë një erë të mirë ose që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e hirrëzës së kafshëve. b) Bar përdhesi.
- BAR HIRRËZE** Bar hirre.
- BAR I HIDHËT** shih RRUSHKULL, ~I.
- BAR I IMËT** Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të shkurtër e me nyja, me gjethet të holla, që nxjerr lule të imëta, të bardheme e të mbledhura tufë dhe bën fara të zeza e shumë të vogla.
- BAR I KEQ** kryes. Bimë barishtore që mbijnë vetvetiu nëpër ara, nëpër kopshte etj. dhe që dëmtojnë a pengojnë rritjen e bimëve të dobishme.
- BAR I MADH** shih SHPEND/ËR, ~RA.
- BAR I QELBUR** Bimë barishtore me gjethet të holla si të pishës, me lule të kuqe, që mban erë të qelbur.
- BAR I TRASHË** Madërgonë.
- BAR I VERDHË** Kuskutë.
- BAR JODI** Tamblagjak, gjak qumështi.
- BAR KOLANECI** Bar përdhesi.
- BAR KRIMBI** Bimë barishtore, me gjethet të vogla të prera në mes, me lule të bardha e ngjyrë manushaqe në majë, që bën një farë të murrme të imët e të rrumbullakët.
- BAR KRIPI** shih PËRÇUK, ~U.
- BAR KRYEZI** Bar i së paemrës.
- BAR KUKUNJËZE** Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethet të imëta si të gjembaçit e me lule të verdha si të trëndelinës, që përdoret në mjekësinë popullore për të shëruar kukunjëzat.
- BAR LEBRE** Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethet si gjuhë ngjale e me push në të dy anët, me lule ngjyrë trëndafili të çelur, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e lebrës së gjinjve.
- BAR LEPURI** Bimë barishtore njëvjeçare, e butë si mëndafshi, me farën si xhufkë të gjatë e të zbardhur, që rritet deri një pëllëmbë e përdoret si ushqim për kafshët.
- BAR LËNGOSE** Bar përdhesi.
- BAR LËNGJYRE** Bimë barishtore me gjethet të gjata, me lule ngjyrë manushaqe e me erë të rëndë, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e lëngjyrës.

- BAR LUNGE** Bimë barishtore me lule të kaltra ose si të manushaqes, që rritet në pyll dhe që në mjekësinë popullore përdoret për shërimin e lungave.
- BAR MAJASËLLI** Bimë barishtore me kërcell të përkulur, me gjethe ngjyrë argjendi zakonisht me push në të dy anët, me kurorë lulësh të bardha ose të purpurta, që rritet në toka të thata.
- BAR ME KOKË** krahin. Tërfil.
- BAR MËNDAFSHI** Bimë barishtore shumëvjeçare, e helmet, me kërcell të hollë kacakarës, me gjethe në trajtë zemre, me lule në tufë e ngjyrë jargavani të hapur, që bën fara të mbështjella në një fletë me push të gjatë.
- BAR MIU** Shpargull.
- BAR MJALTI** Lule blete.
- BAR MORRI** Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe si të rrapit, me lule të gjelbra në të kaltër, që bën fara me dy bërthama si fasule dhe që përdoret kundër morrave.
- BAR NDËRGISHTEJE** Bimë barishtore shumëvjeçare, me zhardhok, me kërcell që shtrihet përtokë, me gjethe të dhëmbëzuara, me lule të verdha, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e ndërgishtes.
- BAR NEPËRKE** Bimë barishtore, me gjethe si të grurit e me pika të zeza.
- BAR NGALOSE** shih GURGULLESH/Ë,~A.
- BAR NGJITËS** Gjunjéz.
- BAR PASRREGULLI** Bimë barishtore, me lule të kuqe e të rrumbullakëta si të zambakut, me gjethe si këmbë pate, që përdoret në mjekësinë popullore për të sjellë në vete një njeri, të cilit i ka rënë të fikët.
- BAR PATE** Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell që shtrihet përtokë, me gjethe të vogla në nyjat e kërcellit, me lule të gjelbra e anash trëndafili, që bën fara të vogla, të cilat i hanë shpendët.
- BAR PESHKU** Bimë barishtore dyvjeçare, me gjethe të mëdha, të gjata e të mbuluara me push, me kërcell të drejtë, që në majë ka një kalli me lule të verdha.
- BAR PEZMI** Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë, me gjethe të buta e të çara si të fierit, me lule tufë në majë, që përdoret në mjekësinë popullore për plagët me qelb.
- BAR PËRDHESI** Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell në ngjyrë të errët, me rrënjë të dendura e të hidhura, me lule të verdha, që përdoret në mjekësinë popullore kundër përdhësit të bagëtive.
- BAR PLAKASH** Lule vjeshte.
- BAR PLASJEJE** Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të degëzuar në majë si fshesë, me gjethe vezake, me lule të bardha e në tufë, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e plasjes.
- BAR PLEHU** Bimë barishtore me gjethe si të hitrës, me lule ngjyrë trëndafili, me fara si të lirit në ngjyrë të kuqërreme, që rritet në plehërishtë dhe lulëzon nga mesi i verës.
- BAR PLESHTASH** Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell deri një metër, me gjethe si të hitrës, me lule si të shpatores, që rritet nëpër shkëmbinj dhe farat e së cilës përdoren në mjekësinë popullore për shfarosjen e pleshtave.
- BAR PULASH** Bimë barishtore me kërcell të shtrirë përtokë, gjethet e njoma të së cilës përdoren si ushqim ose në mjekimet popullore.
- BAR PUSHI** Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të hollë, me gjethe të imëta, me lule të mbledhura si fshesë, që del në tufa të dendura dhe që e hanë kafshët.
- BAR QENI** Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe si të mendrës e me push, me lule të bardha dhe me fara si të çajit, që rritet e lartë mbi një pëllëmbë.

- BAR QEROSI** Bimë barishtore me kërcell të trashë, me gjethe të rralla e të dhëmbëzuara si të manit, që bën fara të vogla të mbështjella në një lëvozhgë me gjemba si të gështenjës dhe që përdoret në mjekësinë popullore.
- BAR QUMËSHI** Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell si të qumështores, me gjethe të holla e të gjata, me gjemba të vegjël si të hithrës, që u jepet si ushqim bagëtive për të shtuar qumështin.
- BAR RRESH** Bimë barishtore njëvjeçare, me lastarë shumë të hollë, të gjatë, të butë e të verdhemë, me lule ngjyrë limoni, që del nëpër ara të korrura, nuk e hanë kafshët dhe përdoret në mjekësinë popullore kundër rreve.
- BAR SAHATI** Bimë barishtore, me burbuqe si të zymbylit, që nxjerrin disa fijeza si akrepi i sahatit.
- BAR SQUFURI** Bimë barishtore shumëvjeçare gjithmonë e gjelbër, me kërcell të shtrirë për tokë e të rrënjëzuar, me gjethe të holla si push rreth kërcellit, që nxjerr kalli të verdhë.
- BAR SHËLLIRE** Bimë barishtore, me gjethe të vogla e me lule të bardha me push, që vihet në kaden e djathit kundër shtrepave.
- BAR SHKËNDIJE** Bimë barishtore, me gjethe si të hithrës e me një vijë të bardhë, me lule të vogla e të bardha, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e pikës në sy.
- BAR SHPËRGËTIE** Bar i së paemrës.
- BAR SHPIRRE** Kuskutë.
- BAR SHPRETKE** Ryzë.
- BAR SHQIPONJE** Bimë barishtore shumëvjeçare, e helmet, me kërcell të drejtë e me push, me gjethe të gjata, me lule të verdha si këmborë.
- BAR SHURRËGJAKEJE** Bimë barishtore, me kërcell të kuq e të gjatë deri një gjysmë metri, me gjethe si të hives e me lule të bardha, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e shurrëkuqes së bagëtive.
- BAR TAMBLI** Qumështore.
- BAR TELISHI** Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të lëmuar e të gjatë mbi një metër, me gjethe shumë të holla si fije bari, me lule si fshesë, që përdoret si ushqim për kafshët dhe për gjelbërim.
- BAR TESH** Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të degëzuar, me gjethe pendore të çara në buzë dhe me lule të purpura, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e teshit a të shpërgëtisë.
- BAR TË PRERI** shih BALÇ, ~I 1.
- BAR THËLLËZE** a) Bimë barishtore njëvjeçare ose shkurre shumëvjeçare, e helmet, me lule të vogla, të gjelbra, pa petla e të mbledhura në kalli, me gjethe të mëdha, që kanë një lëndë ngjyruese. b) Thërroke, xerxele.
- BAR THIU** shih TRIK/Ë, ~A.
- BAR UJI** Maraskë.
- BAR URDHËJE** Rrushqyqe.
- BAR URITHI** Bimë barishtore e fushave, me kërcell e gjethe si të zymbylit, me lule ngjyrëvjollcë, që e pëlqejnë bletët.
- BAR VEDRE** Bimë barishtore, me lule ngjyrë blu, me gjethe të renditura në dy anët e një kërcelli dhe me erë të këndshme si ajo e rozmarinës.
- BAR VERDHËZE** Bimë barishtore, me kërcell që shtrihet përtokë, me gjethe të bardheme, që bën kokrra si lende të verdha dhe që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e verdhëzës.
- BAR VESE** Bimë barishtore njëvjeçare, e lartë deri një pëllëmbë, me lule në ngjyrë të kaltër, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e sëmundjes së lëkurës të shkaktuar nga vesa.

- BAR VESHI** Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të tulta e me lule ngjyrë trëndafili, që rritet zakonisht në mure të vjetra e mbi çati dhe që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e plagëve dhe të sëmundjeve të veshit.
- BAR ZEMRE** Sanëz, agnushe.
- BAR ZOGU** Lloj luleje me ngjyrë të verdhë dhe me erë të mirë.
- BARABARDH** m. Një lloj bari i gjatë, i bardhë, me xhufkë në ngjyrë të kuqe.
- BARBAROZË** f. Bimë barishtore me erë të mirë, me gjethe si pëllëmbë e me push, me lule të vogla ngjyrë trëndafili, që mbahet në saks për zbukurim. Lule barbaroze. Erë barbaroze.
- BARBUNJË** f. Lloj fasuleje, që bën bishtaja të gjera, me kokrra të mëdha e mishtake; bishtajat e kësaj bime, që të njoma gatohen gjellë. Ngastër me barbunja. Mish me barbunja.
- BARDREDH** m. shih DREDHK/Ë, ~A.
- BARDHESË** f. Bar përdhesi.
- BARDHË** mb. Pisha e bardhë. Bredhi i bardhë. Veshtulla e bardhë. Mëshstekna e bardhë. Zambaku i bardhë. Trëndafili i bardhë. Plepi i bardhë. Lakra e bardhë. Sinapi i bardhë. Frashri i bardhë. Tërfile i bardhë. Nena e bardhë. Fiku i bardhë. Kërpudha e bardhë. Myku i bardhë. Uliri i bardhë. Misri i bardhë. Fasulja e bardhë. Rrushi i bardhë.
Kulpër e bardhë (e egër) shih te KULP/ËR, ~RA.
- BARDHËKUQE** mb.
1. Kërpudhë bardhëkuqe: një lloj kërpudhe që hahet, me mbulesën sipër të bardhë dhe poshtë në ngjyrë si të uthulës. 2. si em. BARDHËKUQ/E JA f. sh. E, ET. Kërpudhë bardhëkuqe.
- BARDHKË** f. Lule dhensh.
- BARGJAN** m. shih KËPUTJ/E, ~A II.
- BARI** I ARIUT shih KRAHNJER, ~I.
- BARI** I ÇIKËS Bimë barishtore, me gjethe si të borzilokut e me push, me lule të bardha, që përdoret në mjekësinë popullore kundër lulëzës së syrit.
- BARI** I DALËS Bar plasjeje.
- BARI** I DREQIT shih KUSKUT/Ë, ~A.
- BARI** I DRITHIT Bimë barishtore me gjethe të holla, të gjata e të dhëmbëzuara, me lule të bardha të grumbulluara në majë, që shtrohet në hambarët me drithë për të larguar kandrrat e dëmshme.
- BARI** I GJËSË Bar plasjeje.
- BARI** I JETËS Bimë barishtore njëvjeçare, që rritet në fusha e nëpër hamullore dhe që bën fara të helmëta, lëngu i të cilave, po të pihet, sjell të vjella e gjumë.
- BARI** I LOTZONJËS Drekëz.
- BARI** I MINURIT Bimë barishtore me kërcell të degëzuar, me gjethe gjatore e të dhëmbëzuara, me lule si të blerta, që mban erë të keqe kur thërrmohet.
- BARI** I SË PAEMRËS Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të gjatë e të degëzuar, me gjethe pak më të vogla se të hithrës, me lule të bardha si të borzilokut, që përdoret në mjekësinë popullore për shërimin e shpërgëtisë.
- BARI** I SYRIT Bimë barishtore, me gjethe si të borzilokut fletëmadh, me fara në majë si të arrësit, që rritet rreth dy pëllëmbë.
- BARI** I TË HASURIT
Bimë barishtore me gjethe të vogla e të shpeshta, me lule të bardha, që rritet për tokë në vende me lagështirë dhe që, sipas besëtytnive, përdoret për mjekimin e «të hasurit» a të shuplakurit.
- BARI** I ZGJEBES Bimë barishtore njëvjeçare ose shumëvjeçare, me kërcell të degëzuar e të gjatë deri një metër, me gjethe të dhëmbëzuara, me lule si gjysmërruzull në ngjyrë trëndafili, vishnjeje a të bardhë, që përdoret në mjekësinë popullore kundër zgjebes ose për të ngjyer.

- BARIMËZ** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë e të lëmuar, me gjethe të holla, me lule të imëta të mbledhura si fshesë, që e hanë shumë bagëtitë. Barimëza e bardhë. Barimëza e zakonshme.
- BARKKUQE** f. 1. Lloj kërpudhe që hahet, e cila e ka anën e poshtme të kuqe.
- BASTËR** f. krahin. 1. shih VRUG,~U. Bastra e grurit (e duhanit, e qepës, e hardhisë). I ra (e vrau) bastra.
- BATHË** f. 1. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe pak të trasha, me lule të bardha në manushaqe e me një pikë të errët në petla, e cila mbillet për të pasuruar tokën me azot dhe për bishtajat e kokrrat; bishtajat dhe kokrrat e kësaj bime, që përdoren për ushqim. Bathë kokërrvogël. Bathe të njoma (të thata). Ndryshku i bathës. Gjellë me bathë. Miell bathe. Mbjell bathë.
- BATHË** DETI Çiqibanoz.
- BATHË** E EGËR Bimë barishtore njëvjeçare, e egër, e helmët, me gjethe pak të trasha, me lule të bardha në manushaqe me një pikë të errët në petla, që rritet zakonisht në vende malore dhe bën bishtaja të mbushura me kokrra.
- BATHËR** f. bot
1. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të drejtë e me zhardhok, me gjethe si të zambakut dhe me lule si xhufkë në krye të kërcellit, në ngjyrë të bardhë ose të verdhë, që çelin në pranverë. Kodër me bathra. Çelën bathrat. 2. shih BAD/ËR, RA 1. .
- BATHËZ** f. 1. Bimë bishtajore si batha, me kokrra më të vogla, që përdoret kryesisht si ushqim për kafshët; bathë kokërrvogël. Ushqej me bathëza.
- BATHORE** II f. Presh i egër, badër. Kokat e bathoreve.
- BEDUNICË** f. 1. Shkurre e vogël, me gjethe të imëta e të tulta dhe me lule të merme ngjyrë trëndafili, që rritet në vise të ngrohta, zakonisht nëpër kodra të thata e në gurishte. Lule bedunice. Erë bedunice. 2. krahin. Sherbelë. Mbledh bedunicë.
- BEHAR** m. Lule behari (vere) shih te LUL/E,~JA.
- BELOT** m. Shkurre e vendeve mesdhetare, me degë që thyhen lehtë, me gjethe të trasha, të lëmuara e përherë të gjelbra, kokrrat e së cilës përdoren për ngjyrosje.
- BELUSH** m. Shkurre e vogël e vendeve të ftohta, me gjethe përherë të gjelbra, me lule të vogla si këmborë ngjyrë trëndafili të hapur, që bën kokrra të vogla, të kuqe dhe pak të tharta; kokrrat e kësaj bime. Shkurre (kokrra) belushi. Mbledh (ha) belushë.
- BERONJË** II f. 2. Ashe. Fletë beronjë.
- BESHTË** f. krahin. Kuskutë. Ferrave e besh-tave.
- BEZGË** f. Shkurre e vendeve mesdhetare, me shumë degë të holla, me gjethe të zgjatura si heshtë e poshtë me push, me lule të verdha e të mbledhura tufë, që tërheqin bletët; sfakë. Bezgë e egër. Bezgë e butë. Lule bezge.
- BËRCEL** m. Tepë, okër.
- BËRHAPË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, e egër dhe e dëmshme, me kërcell një pëllëmbë të gjatë, që rritet në kullota dimërore dhe që nxjerr ca kallinj të veçuar e pa bisht.
- BËRHUKË** f. 1. Kopër e egër.
- BËRSHEN** m. Dru halor, i ngjashëm me dëllinjën, me gjethe përherë të blerta, që e ka lëndën të kuqërreme, të rëndë e të fortë dhe që ka lëng të helmët në bala, në lëvore e në trung. Dru bërsheni.
- BËRTHAMOR** mb. 3. Që ka bërthamë. Pemë (farë) bërthamore.
- BËRTHAMORE** f. vet. Pemë, fryti i të cilave ka bërthamë.
- BËRTHANËZ** f. Thanukël, thanë e egër.

BËRTHOKËL f. 2. Fryt i tultë, që ka një bërthamë të fortë.

3. krahin. Boçkë, qepë deti.

BIBË f. Bar bibe shih te BAR,~I.

BIFË f. Pazi.

BINEK m. Bimë barishtore parazitare, me kërcell të shkurtër e të hollë, që bën kokrra të vogla si të fshesës dhe që del në arat e mbjella me oriz.

BISHT DACI Bimë barishtore me kërcell të gjatë e të hollë si fill dhe me një tufë gjatoshë në majë.

BISHT GOMARI Bimë barishtore, rreth një metër e lartë, me gjethe të holla si hala, që rritet anës përrenjve, kanaleve etj.

BISHT MIU Bishtmi.

BISHTADHIZË f. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të hollë, me gjethe si zemër, me lule të bardha, që kacavaret në bimët e tjera të arave.

BISHTAJORE f. vet. Familje bimësh, e cila përmbledh barishte, shkurre ose drurë, që e kanë frytin bishtajë. Bishtajore njëvjeçare (shumëvjeçare). Bishtajore për kokërr. Familja e bishtajoreve.

BISHTAQEN m. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të pakta dhe me kërcell të shkurtër, me lule vezake, që rritet në livadhet malore. Bishtaqen kreshtak. Bishtaqen me gjemba.

BISHTDAC m. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të holla e të gjata si gjilpërë, me lule të bardha si në të blertë, që rritet nëpër livadhe.

BISHTDUNGË f. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell si të grurit e me gjethe të holla, me tufën e farës të gjatë dhe me fije të dendura e të buta, që rritet nëpër livadhe me lagështi.

BISHTDHELPËR f.

1. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të gjata me push nga sipër dhe me gjemba anash, që bën lule të blerta ose

ngjyrë vjollce të mbyllët. 2. Lloj rrushi i bardhë e kokërrgjatë, që e bën vilen gjatoshë si bisht dhelpre.

BISHTMI m. 1. Gjysmëshkurre e vendeve të ngrohta, me gjethe heshtake, pa bisht e të mbuluara me push, me lule si kalli, në ngjyrë të purpurt e me erë të mirë, që rritet zakonisht në toka të thata e shkëmbore. Lule bishtmiu.

BISHTPELËZ f. Bimë barishtore shumëvjeçare me lloje të ndryshme, me kërcell të hollë, me gjethe si të grurit, me lule të bashkuara në krye si fshesë ose si kalli, që rritet zakonisht ndër livadhe dhe që shërben si ushqim për kafshët. Bishtpelëz e kuqe. Bishtpelëz e lartë. Bishtpelëza e livadheve. Bishtpelëz delesh.

BIZELE f. 1. Bimë kacavarëse njëvjeçare, me lule të bardha ose ngjyrë trëndafil, që bën bishtaja me kokrra të blerta; bishtajat dhe kokrrat e kësaj bime, që përdoren për ushqim. Bizele pranverore. Bizele të njoma (të thata). Krimbi i bizeles. Mish (supë) me bizele.

BLANË II f. Urra e drurit.

BLETË f. Bar blete shih te BAR,~I I. Lule blete shih te LUL/E,~JA.

BLETËZ f. 1. Bar blete, milcë. 2. Lëpjetë.

BLI m. Dru me trup të lartë e të drejtë, me gjethe si zemër e të dhëmbëzuara anës, me lule të verdha të mbledhura në tufë dhe me erë të mirë; lulet e këtij druri, që përdoren për çaj. Bli i butë. Bli i egër. Lule (gjethe) bliri. Era e blirit. Çaj bliri.

BLINORE f. vet. Familje drurësh e shkurresh ku hyjnë bliri etj.

BLINTH m. Bimë barishtore me kërcell të trashë, me fije të holla si shtiza, që rritet nëpër toka moçalore. Blinth i imët.

BOÇËBORË f. Lule bore.

BOÇKË f. 2. Bimë mjekësore shumëvjeçare, e helmët, me rrënjë si të qepës, me lule të bardha si në të blertë dhe të mbledhura në vile, që del nëpër shkëmbinj në viset bregdetare; qepë deti. Boçkë bregdetare. Boçka e kuqe. Kokë boçke.

- BORDULLAK** m. Bimë barishtore e degëzuar, e cila rritet e shtrirë nëpër livadhe, anës arave etj., ka kërcej të butë dhe gjethe të trasha, që përdoren për ushqim. Lakror (byrek) me bordullak. Sallatë me bordullak.
- BORDULLAKORE** f. vet. Familje bimësh barishtore ku bën pjesë edhe bordullaku.
- BORË** f. kryes. nj. Lule bore shih te LUL/E,~JA.
- BORIGË** f. Pishë e zezë, çetinë. Pyll me boriga. Kurorë borige. * Kërkon dardha nga boriga kërkon diçka të pamundur, kërkon qiçra në hell.
- BORONICË** f. Qershizë, thrashegër, rrush mali. Lëng boronice. Çaj boronice. Ngjyrë boronice.
- BORZILOK** m.
Bimë barishtore njëvjeçare, me lule të bardha, me gjethe të vogla e me erë të këndshme, që mbillet në saksi ose në oborret e shtëpive. Borzilok i egër bimë barishtore njëvjeçare me gjethe të rralla e me lule të kaltra, që rritet nëpër livadhe dhe që e hanë kafshët. Lule (gjethe) borziloku. Një degë (një tufë) borzilok. Era e borzilokut.
- BOSHTËR** f. Shkurre që i ngjet shtogut, e lartë deri dy metra, me gjethe vezake me pak push, që bën lule të verdha me bisht të shkurtër; shtogër. Gardh me boshtira.
- BOTANIK** mb. * Pjekje botanike pjekje natyrore e farërave të bimëve.
- BOZHURE** f. 1. Lule gjak. Lule bozhureje.
- BREDH** m. Dru halor përherë i gjelbër, me kurorë me majë, që lëshon boçe të gjata dhe që përdoret më shumë për mobilie. Bredh i bardhë. Bredh i zi. Bredh i kuq. Bredhi i Vitit të Ri. Dru bredhi. Boçë bredhi. Pyll bredhash.
- BRENGË** II f. * BRENGË THIU Bimë barishtore me degë të gjata e të shtrira përtokë, me gjethe të imëta e të mprehta, që del e rritet zakonisht nëpër pyje.
- BRESË** f. Radhiqe.
- BRESHKË** f. 3. shih BRESHKËZ,~A 4.
Grurë breshke shih te GRUR/Ë,~I. Liri i breshkës liri i egër. Lule breshke shih te LUL/E,~JA. Trëndafil breshke balkrocë.
- BRESHKËZ** f. 4. Gungë që del në trung të ulurit, e cila mund të shkëputet nga trungu e të mbillet si fidan.
- BRETK** I m. zool. * Lule bretku zhabinë.
- BRI** m. Brirët e gjetthes.
- BRI** THEKRE Lloj kerpudhe në trajtë brirësh të zinj, që del në kallinjtë e drithërave e sidomos të thekrës.
- BRIGJËR** m. Ashe.
- BROKËR** m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të gjatë, me lule të verdha, me gjethe të gjata e të shtrira përtokë, që del në vjeshtë zakonisht nëpër hamullore misri.
- BRUKË** f. Dru a shkurre e viseve mesdhetare, me gjethe të holla si leskra e me lule të grumbulluara në tufë, që rritet zakonisht afër ujërave.
- BRUKTH** m. Bimë, që në rrënjë lëshon një kokërr të madhe si patate, me lëkurë të zezë e me shumë fije të holla. Rrënjë brukthi.
- BRUSHTOVATË** f. Shkurre me kërcell me gjemba e zakonisht të shtrirë përtokë, me gjethe vezake, të dhëmbëzuara e të bashkuara tri e tri, me lule të bardha, që bën fryte si të manaferrës.
- BRUSHTULL** f. shih URTH,~I I.
- BUALL** m. Fik bualli shih te FIK,~U 1. Lule bualli shih te LUL/E,~JA.
- BUALLËS** mb. * Rrush buallës (kumbullor) shih te RRUSH, ~I.
- BUÇ** II m. zool. krahin. * Bar buçi shih te BAR,~I I.
- BUFË** f. Hardhi e egër, larushk, larëz.
- BUFKË** f. 4. Lulebufkë.

- BUHAVICË** f. Bimë barishtore, që rritet zakonisht tufë, me kërcell të lartë deri një metër, me lule të verdha, me gjethe vezake shumë të gjata e me push, të cilat lëshojnë një lëng ngjitës. Lule buhavicë. Kanistër buhavicë.
- BUJGËR** m. Lloj qarri, i gjatë deri njëzet e pesë metra, me lëkurë të murrme, me gjethe vezake e të dhëmbëzuara si të lisit dhe me dru të fortë; qarr i kuq. Bujgri i ashpër bungëkeqja. Tra (dërrasë) bujgri.
- BUKË DERRI** Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe vezake e me lule në ngjyrë trëndafili a të bardha, që rritet nëpër shkurre e çel në vjeshtë.
- BUKË MALI** Një lloj lakre e ëmbël, fletët e së cilës bëhen gjellë.
- BUKËLEPE** f. Bimë barishtore, që rritet në fusha bregdetare, lulëzon gjatë dimrit dhe mund të përdoret për ushqim.
- BUKJE** f. Kashtë kënete me kërcell të mbushur e të butë, që përdoret për të mbuluar çatitë e kasolleve, për të bërë rrogoza etj.; kashtë frytje; lulja e kësaj kashte.
- BUKUR** mb. Lëpjetë e bukur shih te LËPJET/Ë, ~A. Zonjë e bukur shih te ZONJ/Ë, ~A.
- BULB** m. 1. Pjesë e trashur e kërcellit të disa bimëve barishtore në trajtën e kokës së qepës e me fletë të tulta. Bulbi i qepës. Bulbi i zambakut. Gjethet e bulbit.
- BULBOR** mb. 1. Që ka bulb. Bimë bulbore.
- BULI** m. Lloj vidhi deri tridhjetë metra i lartë, me kurorë të gjerë e me degë të varura, me gjethe të rrumbullakëta e të dhëmbëzuara, që rritet zakonisht në fusha e në toka të lagëta bregdetare.
- BULLEDËR** f. 1. Kërpudhë e madhe në trajtën e thundrës së kalit, që rritet në trung të drurëve dhe që përdoret për të bërë eshkë; kërpudhë eshke.
- BUNG** m. Lloj dushku tridhjetë-dyzet metra i lartë, me trung të trashë, me kurorë të gjerë e të çrregullt, me lëkurë të murrme e me gjethe vezake, që nxjerr tri deri shtatë lende së bashku në një bisht. Bunga e butë. Lende bingu. Dërrasë bingu. Pyll bungjesh.
- BUNGËBUTË** f. Lloj bingu njëzet-tridhjetë metra i lartë, me lëkurë të plasaritur e me push, me gjethe vezake dhe me lende më të vogla se të bungut, që kur bien, e lënë kësulën në degë; bungë e butë. Dru bungëbutë. Lendet e bungëbutës. Pyll bungëbutë.
- BUNGËKEQE** f. Lloj bingu, që i ka gjethet të hidhura.
- BUNGËKUQE** f. Bung, që i ka degëzat e reja të kuqërreme; qarr i kuq.
- BUNGËL** f. Shpardh.
- BUNGËLESHE** f. shih BUNGËBUT/Ë, ~A.
- BURBULL** m. Shkurre deri dy metra e lartë, me gjethe vezake e me push, me lule të bardhëlleme, që bën kokrra të vogla e të rrumbullakëta me ngjyrë të kuqe; ftua i egër. Burbulli i butë. Kokrra burbulli.
- BURTH** I m. Bimë barishtore, me kërcell të shkurtër, me gjethe në trajtë zemre, me lule të merme ngjyrë trëndafili në të bardhë, që çelin në korrik; ciklamin i egër.
- BUSH** I m. Shkurre me shumë degë ose dru deri tetë metra i lartë, me gjethe vezake jorënëse, me lule të vogla në tufë, që e ka lëndën të verdhë, të fortë e me palcë dhe që përdoret për të bërë orendi, vegla pune, çibukë, lodra etj. Bush i egër. Çibukë (lugë, fyell) bushi.
- BUSHK** m. Bush. Mal me dushk e me bushk.
- BUTË** mb. Ferrë e butë shih te FERR/Ë, ~A. Kulpër e butë sumbullare. 1. Ujë i butë (i lehtë) shih tek UJ/Ë, ~I 1.
- BUTINË** f. Gjini shkurresh a drurësh me gjethe rënëse ose të qëndrueshme, me lule të vogla zakonisht të bardha, që bëjnë kokrra të kuqe a të zeza me një farë brenda dhe që mbillen për zbukurim.

Butina e butë shkurre ose dru i vogël deri katër metra i lartë, me lule të bardha, të mbledhura tufë e me erë të mirë. Butina e kuqe shkurre ose dru i vogël deri katër metra i lartë, me gjethe vezake e të dhëmbëzuara, me lule të bardha në të kuqërreme. Butina fletëlarë shkurre me gjethe të qëndrueshme, me lëvore të kuqërreme, me lule të merme, të bardha si në të kuqe.

BUTISHTË f. Bungëbutë.

BUXHAK II m. Bimë barishtore njëvjeçare, e ngjashme me grashinën, me kërcell të gjatë e të përkuqshëm, me gjethe çift e me lule të kuqe, që lëshon bishtaja me shumë fara të zeza e të rrumbullakëta dhe që mbillet si hasëll për ushqim të kafshëve. Buxhak hasëll. Farë (bishtajë) buxhaku. Kullot në buxhak (lopët). Ushqen me buxhak.

BUZË NUSEJE Gjembraç, që lëshon lule të verdha.

BUZËDELE f. Luleshqerrë.

BUZËMADHE f. Bimë e egër barishtore, me gjethe të gjera si të luleshqiponjës, por të pa çara, dhe me lule të bardha në trajtën e manushaqes, që rritet buzë kanaleve.

BUZORE f. vet. Familje bimësh barishtore ose shkurre, ku bëjnë pjesë borziloku, rigoni, sherbela, rozmarina, livanda etj.

BYTHËKROMË f.

1. Trëndafili i egër. 2. Ferrac.

BYTHËQIQËR f. Bimë që rritet si shkurre, me degë të holla e të gjata që kacavaren, me lule gjatoshe si kallam dhe me kokrra si qiqër.

BYTHËQYQE f. Bimë e egër, me kërcell të gjatë, të mbushur në të dyja anët me gjethe të mëdha e të rrumbullakëta, që lëshon fara si kokrrat e arrës dhe që del zakonisht nëpër ara të mbjella.

CARANGTH m. Bimë barishtore shumëvjeçare, me rrënjë të gjatë, me një lule në trajtë tufe me thekë e ngjyrëvjollcë, me kërcell të lartë, të veshur me gjethe

të vogla, të cilat kanë anash gjemba të mprehtë e të hollë. E shëroi plagën me rrënjë carangthi.

CEDËR m. Dru halor i lartë me kurorë si piramidë, me hala të ashpra, të gjelbra në të hirtë e të mbledhura tufë, që bën boçe rrumbullake ose vezake dhe që përdoret për orendi e në ndërtim. Dru cedri. Rrëshirë cedri. Boçet e cedrit. Pyll me cedra.

CËRMËDELL m. Shkurre e vendeve të ngrohta, e afërt me shqemen, me dru të verdhemë e me gjethe vezake, që përdoren për të regjur lëkurët. Dru cërmëdelli. Ngjyey me cërmëdell. Mban erë të rëndë si cërmëdell.

CIKLAMIN m. 1. Bimë barishtore zbukuruese, me gjethe në trajtë zemre dhe me zhardhok të trashë, që nxjerr lule të mëdha me ngjyrë të bardhë e vjollcë të hapur në të kuqe. Ciklamin i egër. Lule ciklamini.

CIKUTË f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të gjatë e të degëzuar lart, me gjethe të holla e të dhëmbëzuara, me lule të vogla, të bardha e të mbledhura tufë, që ka rrënjë të trashë e me lëng të helmet dhe që rritet në vende me ujë.

CILINDËR m. 5. Pjesa e trungut, e degëve ose e rrënjëve të një druri, që mbetet po të heqim lëvoren. Cilindër qendror.

CIMARTE f. Shkurre me gjethe të vogla si të shegës, me lule të verdha, që bën kokrra të zeza dhe që rritet në vende bregdetare.

CIMBËL f. Bimë barishtore me gjethe të vogla e të lëmuara, të mbledhura tufë, që rritet në shkëmbinjtë e bregdetit dhe përdoret e zier si sallatë.

CIMË II f. Tufë lulesh të një bime, e cila përbëhet nga një lule e parë dhe nga disa lule të tjera rrotull saj, që dalin më vonë nga e njëjta nyjë.

CUCUFENDË f. Fendëdosë.

CURRUBABË f. 2. Tërshërë e egër.

ÇAÇANIK m. 1. Pema e arrës; kokërr arre me lëvozhgë të njomë. Gjethe çaçaniku.

- ÇAFËR** II m. Lloj gruri me kokrra të mëdha e të rrumbullakëta.
- ÇAJ** m. 1. Shkurre, që rritet në disa vende të ngrohta, me lule të bardha, me gjethe përherë të gjelbra e me erë të këndshme, që thahen e përdoren për të përgatitur një pije të ngrohtë; çaj i zi, çaj Evrope; emërtim për disa lloje të veçanta bimësh barishtore të vendit tone, që përdoren për të përgatitur një pije të ngrohtë. Çaj mali bimë e tillë shumëvjeçare që rritet në malet e vendit tone, me kërcell e me gjethe në ngjyrë argjendi, me lule të verdha e me erë të këndshme. Gjethe çaji. Lule çaji. Një tufë çaj. Kuti me çaj. Mbledh çaj.
- ÇAKLLAZ** m. 1. Bar breshke, halmucë.
- ÇALLMARE** f. Bimë barishtore zbukuruese me kërcell të gjatë dhe me lule pa erë, që i kanë petlat të mbledhura njëra mbi tjetrën.
- ÇALLMË** f. Lule çallmë çallmare.
- ÇAM** II m. shih BREDH, ~I. Çam i bardhë. Dru çami. Pyll çami.
- ÇAPAROZ** m. Lloj gruri kokërrmadh e i fortë, me ngjyrë të bardhë në të kuqërremë e me hala të zeza. Çaparoz i bardhë (i kuq).
- ÇAUSH** m. hist. * Rrush çaush lloj rrushi kokërrmadhe i bardhë.
- ÇERÇEM** m. krahin. Carac. Dru çerçemi. Kokrra çerçemi.
- ÇETINË** f. 1. Pishë e zezë, borigë. Çetinë e zezë harmoç. Pyll çetine. Mal me çetinë.
- ÇILEK** m.
- ÇOL** m. 2. Lloj bime që rritet nëpër moçalishte dhe e hanë kafshët e ngarkesës.
- DAFINË** f. 1. Dru a shkurre që rritet në vendet mesdhetare, me gjethe gjithmonë të gjelbra e me erë të këndshme, që bën kokrra të vogla me ngjyrë të errët; lar. Dafinë fletëgjere (fletëngushtë). Druri i dafinës. Degë (fletë, gjethe) dafine. Pyll dafinash.
- DAFINOR** mb. bot 1. Që është i së njëjtës familje me dafinën. Shkurre dafinore. Familja dafinore. 2. I dafintë. .
- DAFINORE** f. vet. Familje drurësh e shkurresh ku bëjnë pjesë dafina, kanella etj.
- DALLËNDYSHE** f. Bar dallëndysheje shih te BAR, ~I I.
- DAMAR** m. 2. Çdonjëri nga gypat, nëpër të cilët kalojnë lëndët ushqyese në trupin e bimës, në gjethet etj. Damarë kryesorë. Damarët e drurit (e gjetthes). Iu thanë damarët.
- DARDHËZ** f. Bimë barishtore me kërcell të trashë e me gjethe të tulta si të bordullakut, me lule të bardha pesëcepëshe e të merme, që rritet zakonisht nëpër murishte të vjetra dhe përdoret për t'u ngrënë. Lulet e dardhëzës.
- DARDHISHTË** f. 2. Dardhë e egër, gorricë; kokrra e saj. E preu dardhishtën. Shar-toi një dardhishtë. Mblodhi ca dardhishta.
- DARDHORE** f. Gorricë e vogël, që nuk ka lëshuar ende kokrra.
- DARDHUKËL** f. Dardhë e egër, gorricë; kokrra e saj.
- DARKAJKË** f. Rrënja e pazisë.
- DASHE** f. * Kërpudhë dashe shih te KËRPUDH/Ë, ~A 1.
- DASHEZ** f. Bimë barishtore njëvjeçare, që i ka gjethet si të angjinare e me gjemba të butë nëpër të çarat dhe që rritet gjatë dimrit në vende të ngrohta, buzë lumenjve a në bregdet e përdoret si ushqim.
- DASHTËR** f. 1. Bimë barishtore e egër, me kërcell të drejtë e të lartë, me gjethe të gjera, të çara e të kthyera nga lart, me gjemba të fortë, që çel në verë lule të bardha.
- DEGËZ** f. 2. Bisk anësor i ri dhe i hollë, që del në degët e një druri dhe që zakonisht ka gjethe; lastar. Degëza të shkurtra. Ka nxjerrë degëza. Krasit degëzat.
- DEJÇË** f. Gjethe delli, dejëz.

- DEJËZ** f. Gjethe delli, bar delli.
- DELE** f. Lule deleje shih te LUL/E,~JA.
- DELL** m. Gjethe (fletë, bar) delli shih te GJETH/E,~JA.
- DELLËZIM** m. Degëzim i një delli te bimët; tërësia e dejve në gjethet e bimëve. Dellëzimet e gjetthes.
- DELLËZUAR** mb. Që përshkohet nga shumë dej, që ka shumë dellëzime (kryesisht për gjethet). Gjethe të dellëzuara.
- DERVISH** m. 3. Lloj kërpudhe me bisht të gjatë e me kësulë të bardhë.
- DERR** m. Bar derri shih te BAR,~I 1. Bukë derri shih te BUK/Ë,~A. Kërpudhë derri shih te KËRPUDH/Ë,~A. Lule derri shih te LUL/E,~JA.
- DET** m. Sallatë deti. Dafinë deti shih te DAFIN/Ë,~A. Ferrë deti shih te FERR/Ë,~A. Fik deti (frëngu) shih te FIK,~U. Misër deti shih te MIS/ËR,~RI. Pishë deti shih te PISH/Ë,~A 1. Qepë deti shih te QEP/Ë,~A.
- DËLLINJË** f. Dru a shkurre me gjethe halore gjithnjë të blerta, që bën kokrra të vogla e të rrumbullakëta me ngjyrë zakonisht të zezë, të kuqërremtë ose blu të errët dhe me erë të mirë; kokrrat e kësaj bime, që përdoren në industrinë farmaceutike, për të bërë një lloj rakië, hardhiç etj. Dëllinjë e zezë (e kuqe). Dru dëllinje. Kokrrat e dëllinjës. Vaj dëllinje. Raki dëllinje. Mbledh dëllinja.
- DËRNOK** m. Bimë barishtore helmuese, me kërcell fyl, me gjethe heshtore të dhëmbëzuara afër majës, me lule në ngjyrë trëndafili të çelur, që rritet në toka të punuara e me lagështirë.
- DIELL** m. Lule dielli shih te LUL/E,~JA.
- DIMËR** m. Lule dimri shih te LUL/E,~JA.
- DISTIK** mb. Elb distik shih tek ELB,~I.
- DJATHË** m. Bar djathi shih te BAR, ~I I. Lule djathi shih te LUL/E,~JA.
- DJEGË** f. Kërpudhë që e ka këmbën të kuqe e kapelën të bardhë dhe të djeg kur e ha.
- DJEGËS** II m. Bimë barishtore me gjethe vezake, me lule të bardha, të verdha a të kuqërreme, të mbledhura në vile e me erë shumë të mirë, që rritet në vende me klimë të butë e mund të mbahet edhe si bimë zbukuruese.
- DORDOLINË** f. Tërfile i livadheve, tërfili i kuq.
- DORËZONJË** f. Shkurre kacavarëse me gjethe gati rrotullare, që çel lule të kuqërreme nga jashtë e të verdha nga brenda, të cilat i ngjajnë një dore të vogël me gishtërinj të përkulur dhe kanë erë shumë të mirë; lulemustak. Kundërmon dorëzonja.
- DREDHAK** mb. 2. Që është i lakuar dhe i përdredhur disa herë, që është dredha-dredha; që dridhet, i përdredhur. Kërcell dredhak. Bimë dredhake.
- DREDHE** f.
- DREDHË** f. 9. Dredhë; urth.
1. Dredhkë. Dredhja e zakonshme. Dredhja e arave.
- DREDHËL** f. 1. Bimë barishtore kacavarëse, me gjethe në trajtë zemre, me lule të mëdha e të vetmuara, në trajtë kambane dhe në ngjyrë të kaltër, që rritet brigjeve të lumenjve a përrenjve, anës udhëve etj. ose që mbahet në kopshte si bimë zburuese. 2. Lulekëmborë.
- DREDHËS** mb. 2. Që ngjitet pas një druri a një bime tjetër duke u përdredhur, kacavarës; dredhak. Bimë dredhëse. Kërcell dredhës.
- DREDHËZ** I f. 1. Luleshtrydhe. Dredhëza të pjekura. Reçel dredhëzash. 2. Dredhkë. Shkul dredhëzat. 3. Urth. Mur i mbuluar me dredhëza. 4. Dredhë hardhie etj. Ka nxjerrë dredhëza. Është kapur me dredhëza.

- DREDHKË** f. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të hollë e të gjatë, që shtrihet për tokë ose kacavaret pas një bime tjetër, me gjethe të vogla vezake e me lule të bardha në trajtën e ziles. Dredhka e arave. Heqin dredhkat. E ka mbuluar dredhka misrin.
- DREDHORE** f. vet. Familje bimësh si dredhla, dredhka etj. që përdridhen ose që kacavaren pas drurëve e bimëve të tjera.
- DREJTË** mb. Pjalnim i drejtë. Pjalnim që bëhet kur pjalmi i një luleje bie në krezat e pistilit të po kësaj luleje.
- DREKËZ** f. Bimë barishtore shumëvjeçare e pyjeve halore me dy-tri gjethe vezake të zgjatura në rrëzë të kërcellit, me lule të vogla në trajtë kambane, të bardha e me erë të mirë, që bën kokrra të vogla në ngjyrë të kuqe të ndezur dhe përdoret si bimë mjekësore.
- DRITËDASHËS** mb. Që rritet e zhvillohet mirë në dritë, që ka shumë nevojë për dritë, që do dritë; kund. hijedashës (për bimët). Bimë (lule) dritëdashëse.
- DRITHË** m. 2. kryes. Bimë barishtore njëvjeçare (si gruri, misri etj.) që bëjnë kokrra të grumbulluara në kalli, të cilat shërbejnë si ushqim për njerëzit e për kafshët; bimët e bukës. Drithëra pranverore. Drithëra buke. Dëmtuesit e drithërave.
- DRIZARE** f. Lloj laverdhëze e pyjeve a e kullotave, me degë të drejta e me push, me gjethe vezake e me majë të mprehtë, që bën lule të kuqe të vendosura dy e nga dy në një bisht të përbashkët dhe kokrra të kuqe gjatose.
- DRIZË** f. Shkurre e vendeve mesdhetare me degë të shtrembra e me shumë gjemba, me lëkurë në ngjyrë si të kuqe, me gjethe vezake të këmbyera, me lule të gjelbra në të verdhë, që mbin nëpër vende të papunuara, anës udhëve etj. dhe përdoret për gjerdhe; ferrëkuqe. Vend me driza. Gardh me driza. Një krah me driza. Heq (pret) drizat. Zë shtegun me drizë. Ngeci në një drizë.
- DROKTH** m.
1. Fshikartë. 2. Vjegjës. * Iu bë buka drokth i mbeti buka në grykë, nuk i shkon buka, iu bë buka lëmsh (komb) në grykë (nga një lajm i hidhur, nga një hall etj.).
- DROSHT** m. Shkurre e vogël me gjethe vezake, me lule të gjata në ngjyrë të bardhë ose të trëndafilte, që mbin vetiu nëpër pyje e në vende të thata dhe i ka farat në bishtajë.
- DRUJUBË** f. Shkurre e lartë, me degë të shumta të mbuluara me push, me gjethe në trajtën e veshkës, me lule ngjyrëvjollcë, që mbillet nëpër parqe si bimë zbukuruese.
- DRUNAKUQ** m. Zogël.
- DRURRYELL** m. Shkurre e lartë, me degë të buta, me lule të verdha e të mbledhura në trajtë ombrelle dhe me gjethe të zgjatura si heshta e të grumbulluara më shumë në majat e degëve, të cilat përmbajnë një lëng të bardhë si qumësht.
- DUHAN** m. 1. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të trashë e të lartë dhe me gjethe të gjera, të cilat përmbajnë nikotinë dhe kanë shije të hidhur. Duhan i shkurtër (i gjatë). Duhan i bardhë. Duhan gërxhall. Duhan gjethemadh (gjethe vogël). Duhan vjeshtak. Duhan vendi. Duhan plepi. Lloj duhani që e ka gjethe si të plepit. Gjethe (lule, kërcell, farë, rasat) duhani. Lehe duhani. Llojet e duhaneve. Vrugu i duhanit. Hiri i duhanit. Duhan i egër madërgonë. Zjarri i duhanit (zjarri i egër) shih te ZJARR, ~I.
- DUNICË** f. Bezgë. Dunicë mali.
- DUSHK** m. 1. Dru i lartë pyjor me kurorë të dendur, me gjethe të shumta e të dhëmbëzuara, që lidh lende dhe që e ka lëndën mjaft të fortë e të rëndë; emërtim i përgjithshëm i disa llojeve drurësh që kanë tipare të tilla të afërta (si p.sh. rrënja, bunga, qarri, shpardihi, valanidhi etj.); lis. Dushk i ri. Gjethe (degë, dru, lende) dushku. Prush (hi) dushku. Pyll me dushqe. Lule dushku shih te LUL/E, ~JA.

DUSHK I EGËR Ashe.

DUSHKULL m. shih XIN/Ë,~A II.

DYBUZOR mb. 2. Që është çarë në dy pjesë të pabarabarta dhe ka pamjen e dy buzëve të hapura (për lulet e disa bimëve). Kurora dybuzore e lules.

DYLLË m. 2. Rrëshira e disa drurëve (si kumbulla, qershia, kajsia etj.); lëngu i trashë si rrëshirë që nxjerr në krye kokrra e fikut kur piqet mirë. Dylli i kumbullës (i qershisë). Sëmundja e dyllit. sëmundje që u bie disa pemëve (kumbullës, qershisë etj.) dhe që i bën t'u kullojë vende-vende rrëshirë nga trangu. Lule dylli shih te LUL/E,~JA.

DYTHELBOR mb. Që ka dy thelpinj; që ka embrionin e farës të ndarë në dy thelpinj. Bimë dythelbore. Farë dythelbore.

DHE m. sh Mollë dheu shih te MOLL/Ë,~A. Të rëndët e dheut shih te RËNDË,~T (të).

DHEN vet. Lule dhensh shih te LUL/E,~JA.

DHËMBËKALË m. Lloj misri me kalli të madh e me kokrra të bardha e të mëdha; misër i bardhë.

DHIOZMË f. Mendër e butë, nenexhik.

EGËR mb. Duhan i egër madërgonë. Dushk i egër shih te DUSHK,~U. DHI,~A. Elb i egër shih tek ELB,~I. Frashër i egër rrunjë. Gështenjë e egër shih te GËSHTENJ/Ë,~A. Kafe e egër bar miu. Kumbull e egër kullumbri. Kungull i egër shih te KUNGULL,~I. Liri i egër shih te LI,~RI. Mel i egër kostrevë. Pambuk i egër shih te PAMBUK,~U. Qershi e egër thrashegër, rrush mali, qershizë, qershigël.

Tërshërë e egër shih tek TËRSHËR/Ë,~A. Thanë e egër thanukël. Zjarri i egër (zjarri i duhanit) shih te ZJARR,~I. Vishnjë e egër shih te VISHNJ/Ë,~A.

EGËRLE f. Ulli i egër, ullastër.

EGJËR f. 1. Bar i keq që rritet zakonisht në arat e mbjella me grurë dhe që bën kokrra të vogla në ngjyrë të zezë, të cilat po të bluhën bashkë me grurin, e prishin cilësinë e bukës që gatuhet me këtë miell dhe e bëjnë këtë të dëmshme për njeriun; kokrrat e kësaj bime. Grurë me egjër. Bukë me egjër. Qëroj egjërën. E zuri (e trulloi) egjra.

ELB m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kalli si të grurit, por me thekë me të gjatë që mbillet zakonisht për tagji, për prodhimin e birrës, për të bërë një lloj kafeje etj. Elb pranveror (vjeshtor). Elb dyrreshtor (distik) lloj elbi që e ka kallirin me dy radhë kokrrash dhe që përdoret zakonisht për prodhimin e birrës. Elb i egër bar i keq i kullotave dimërore me kalli si të elbit dyrreshtor, që është i dëmshëm edhe për bagëtinë. Elb vendi. Kalli elbi. Bukë elbi. Kafe elbi. Mbjell elb. Korr elbin.

ELBAROZË f. Barbarozë.

EMBRION m. 2. Organizmi fillestar i bimëve që formohet në farën e tyre nga qeliza e pllenuar. Embrioni i bimës.

END m. Pjalm. Endi i dardhës (i mollës).

ENDË f. 1. Pjalm; tërësia e luleve të imëta që çelin disa lloje drurësh a shkurresh, zakonisht në pranverë, endëz. Enda e ullirit (e kumbullës, e shqopës).

ENDËS II m. Mugull, syth i bimëve.

ENDËZIM m. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve ENDËZON, ENDËZOHET. Endëzim natyror (artificial). Endëzim i drejtë. Endëzim i zhdrejtë (i tërthortë).

ENË f. 3. Secili nga gypat qelizorë të bimët, që shërbejnë për kalimin e ujit dhe të lëndëve të tretura në të. Enë përcuese.

ENËZOR mb. 2. Që përbëhet prej gypash qelizorë, nëpër të cilët kalojnë uji dhe lëndët e tjera të tretura në të.

ENGJËRDHISHTE f. Shkurre me degë të gjata e të holla, të cilat përdoren zakonisht për të lidhur duajt, hardhitë pas hunjve etj.

- ENJË** II f. Bërshen.
- EPIDERMË** f. anat., Mbilëkurë. Epiderma e domates. Qelizat e epidermës.
- ETHACAK** m. Bimë barishtore që përdoret në mjekësinë popullore kundër etheve.
- ETHE** f. kryes. Bar ethesh trikë. Lule ethesh trikë.
- EUKALIPT** m. Dru gjithmonë i gjelbër, me prejardhje nga Australia, që rritet shumë shpejt dhe ka trung shumë të lartë e gjethe të holla të merme, nga të cilat nxirret një lloj vaji që përdoret në mjekësi e në industri. Dru eukalipti. Gjethe eukalipti. Vaj eukalipti.
- ËMBËL** mb. Limon i ëmbël limetë.
- FARASHKË** II f. Melekuqe.
- FARË** f. 6. Vezore e pllenuar. Vezorja bëhet farë.
- FARËKUQE** f. Murriz i kuq, ushinh.
- FARËVESHUR** mb. Që i ka farat brenda frytit të vet; që bën fryte me bërthamë (për bimët); që i ka farat të veshura me një cipë a me një mbulesë. Bimë farëveshur.
- FARËZHESHUR** mb. Që i ka farat jashtë, të pambuluara, që i duken farat. Bimë farëzhveshur.
- FARJE** f. 1. Lloj pemësh a perimesh, fryti i të cilave ka tul të lëngshëm e me shumë fara (si rrushi, domatja etj.).
- FAROR** mb. 2. Që e ka frytin me fara, që bën fryte me fara. Bimë farore. Drurët farorë.
- FASULE** f.
- FEMËR** f. 3. Vezorja e lules.
- FEMËROR** mb. 4. Që ka vetëm vezore (për lulet). Lule femërore.
- FEMËRORE** f. 2. Vezorja e lules.
- FENDOSË** f. Lloj kërpudhe e rrumbullakët e pa bisht, e cila kur piqet mbushet me një pluhur në ngjyrë të errët.
- FENIKS** m. libr. * PALMA FENIKS Lloj palme, degët e përkulura të së cilës u ngjajnë pendëve të gjata të një zogu të madh.
- FERRAC** m. Shkurre kacavarëse e vendeve mesdhetare, që ka gjethe të trasha në trajtë zemre e me gjemba anëve dhe që bën lule të bardha në vile e kokrra të kuqe.
- FERRACAK** mb. * Kungull ferracak stërkungull.
- FERRCË** f. 1. Gjembraç; ferrë.
- FERRECKË** f. 1. Gjembraç; ferrë. Ferrecka gomari. 2. krahin. Ferrë deti, akacie.
- FERRË** f. 1. Emërtim i përgjithshëm për shkurre të ndryshme me shumë degë e me gjemba, që mbijnë vetiu nëpër vende të papunuara, nëpër ledhe, anës udhëve etj. Gjinia e ferrave.
2. Shkurre që mbin vetiu nëpër vende të papunuara, anës udhëve etj., me shumë degë të holla e të mbuluara me gjemba të shkurtër, me gjethe të dhëmbëzuara në trajtë zemre dhe me lute të bardha, që bën kokrra si të manit, të cilat kur piqen marrin ngjyrë të zezë e bëhen të ëmbla; manaferrë. Degë (gjethe) ferre. Gjemb ferre. Mana ferre. Gardh me ferra. Pres ferrat.
4. Gjembraç. Ferrë e bardhë ferrëbardhë. Ferrë e butë ferrëbutë. Ferrë deti akacie. Ferrë (gjemb) gomari gjembraç, rrëfeshk. Ferrë e keqe drizë. Ferrë e kuqe ferrëkuqe, drizë.
- FERRËBARDHË** f. Trëndafil i egër; kaçë.
- FERRËBUTË** f. Bimë barishtore, me degë të holla, me gjethe si fiqe e me push, me lule zakonisht të verdha, që bën kokrra si një rruazë e vogël në ngjyrë të kuqe.
- FERRËDET** m. Akacie.
- FERRËKAÇE** f. Trëndafil i egër, kaçë.
- FERRËKUQE** f. Drizë.
- FERRËLAGËSE** f. Lloj manaferre me lastarë zvarritës, me gjemba të vegjël, me gjethe të dhëmbëzuara e me push të butë nga poshtë.

- FERRĒMANZĒ** f. Manaferrë.
- FERRĒMI** m. Brengë thiu.
- FERRĒNUSE** f. Bimë barishtore, me shumë degë e me gjemba të helmet, me lule të vogla në ngjyrë trëndafili a të verdha, që mbin anës rrugëve ose në kullota e livadhe; kolmuth.
- FERRĒPATË** f. Lloj gjembaçi me gjethe të trasha e me një majë si ferrë, me lule në trajtën e një tufëze të bardhë e me kokë të verdhë.
- FËNG** m. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare e kullotave, me kërcell të hollë dhe me fije të gjata e të ashpra si të tërshërës së egër, që dalin tufë nga rrënja. Nuk e ha fëngun delja.
- FËSTËK** m. Pisha e butë; fara e kësaj pise, që i ngjan thelbit të bajames dhe që hahet zakonisht e pjekur.
- FIDHËS** m. Lloj dëllinje e vendeve mesdhetare me degë e gjethe si të selvisë, që bën kokrra të mëdha në ngjyrë të kuqe të errët e me veti mjekuese dhe që ka dru të fortë, i cili përdoret sidomos për të bërë sende zbukurimi. Dru fidhësi. Kokrra fidhësi.
- FIER** m. * Lule fieri shih te LUL/E,~JA.
- FIERORE** f. vet. Familje bimësh barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë e të holle pa lule, me gjethe të dhëmbëzuara e të përdredhura kur janë të reja, me rizomë të trashë e të fortë, që rriten nëpër pyje, në vende me hije e në toka të lagështa.
- FIK** DETI Bimë shumë vjeçare a shkurre e vendeve të ngrohta, me gjethe të trasha, të tulta e të mbuluara me gjemba dhe me fryte që kanë shije si të fikut të zakonshëm; lule zbukurimi e ngjashme me këtë bimë.
- FILXHAN** m. 3. Lule filxhani.
Lule filxhani shih te LUL/E,~JA.
- FILLIKATE** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të shkurtër, me gjethe të prera thellë e me një lule të vetme si yll ngjyrë trëndafili në majë, që çel në pranverë.
- FINOK** m. Lloj maraqi i butë me erë të mirë, me gjethe e poshtme të mishta e të mbledhura si qepë, që hahen ose përdoren në mjekësi. Finok i zier (i skuqur). Sallatë (gjellë) me finok.
- FJETUR** mb. Syth i fjetur shih te SYTH,~I 1.
- FLAMUR** m. 8. Petla e sipërme e me e madhe e kurorës së lules te fasulja e bizelja dhe te fluturoret e tjera.
- FLEGËR** f. 2. Cipë e hollë e lëvozhgës së një fryti; secili prej dy kapakëve të zgjatur dhe të bashkuar që mbajnë kokrrat e bish-tajës.
- FLETË** I f. Fletë delli shih GJETHE DELLI te GJETH/E,~JA.
- FLETË** MISRI Bimë që i ka gjethe të gjera e me majë si të misrit, që e duron shumë thatësirën dhe që mbillet në vazo ose në oborr për zbukurim.
- FLOKËKUQ** mb. * Grurë flokëkuq shih te GRUR/Ë,
- FLOKËSHTRIGË** f. 2. Kuskutë. Flokështriga e jonxhës.
- FLOKËZ** f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të hollë, me gjethe të holla e të zgjatura e me lule si tufëz e degëzuar në majë të kërcellit, që rritet zakonisht në toka me lagështirë, lulëzon në pranverë dhe përdoret si ushqim për kafshët. Flokëza e livadheve.
- FLORI** m. Lule floriri shih te LUL/E,~JA.
- FLUTURORE** f. vet. Familje bimësh barishtore njëvjeçare, si fasulja, bizelja etj., që e kanë kurorën e lules në trajtë fluturore.
- FLLUSKË** f. 5. Sëmundje e bimëve, që ua fryn këtyre gjethe dhe ua bën si fshika. Flluska kap gjethe e majës.
- FOJLETË** f. Caracë.

- FOM** m. Bimë barishtore njëvjeçare e livadheve, me kërcell të zbrazët, me shumë gjethe, me lule të vogla e të kuqërreme në vile, që e bën frytin si kapsulë të mbushur me farëza dhe që përdoret si ushqim për bagëtinë e në mjekësi.
- FORTË** mb. Grurë i fortë shih te GRUR/Ë,~I.
- FRASHËR** m. Dru ose shkurre pylli me gjethe të gjata e të dhëmbëzuara dhe me degë të trasha, që e ka lëndën të bardhë, të fortë e pa nyja dhe përdoret për të bërë vegla të ndryshme ose për zjarr. Frashër i bardhë (i zi). Frashër mali (fushe). Frashër uji. Sfurk (heshtë) frashri.
- FRËNG** m. bised. Fik frëngu (deti) shih te FIK,~U. Rrush frëngu (tokë) botë shih te RRUSH,~I.
- FRYTJE** mb. Kashtë frytje. fryzë. 2. si em. FRYTJ/E,~A f. ~E, ~ET Fryzë.
- FRYZË** f. Kashtë me kërcell të gjatë, të përkulshëm, të mbushur e pa gjethe, që rritet nëpër kënetat ose në brigjet e lumenjve dhe përdoret për të bërë rrogoza etj. Fryzë e kuqe fryzëkuqe.
- FSHESË** f. 4. Melekuqe. Mbjellin fshesë. Korrin fshesën.
5. Emërtim i përgjithshëm për disa lloje bimësh, kërceltë e degët e të cilave përdoren për të fshirë. Fshesë e egër. Lule fshese shih te LUL/E,~JA.
- FSHIKET** mb. 1. Që ka fshika në trung a në degë (për drurët).
- FSHIKËZ** f. 2. Fshikartë, drokth.
- FTUA** m. Ftua i egër shkurre e vendeve malore, që i ngjan ftoit; me gjethe të vogla e të dendura, që bën kokra të vogla e të mbuluara me push, të cilat nuk hahen.
- FYSHTËR** f. Boshtër.
- FYTËZ** f. 1. Fryzë.
- GAÇKË** f. Lakër e bardhë.
- GALLORE** f. Bimë barishtore si kaçubë e gjerë, që mbin nëpër ara dhe dëmton të lashtat.
- GARDH** m. Rrush gardhi larushk, rrush i egër.
- GATH** m. 1. Grumbull lulesh në trajtën e një vileje a te një kalliri që varet; vastak, lëvare.
- GËRDEC** II m. 1. Shkurre e vogël e viseve të ftohta malore, me lule si vile të bardha a të kuqërreme e me gjethe të trasha, që përdoren në mjekësinë popullore për sëmundjet e veshkave a të fshikëzës së ujit.
- GËRTHAC** II m. Ullastër.
- GËRTHE** m. krahin. Dredhëz, luleshtrydhe.
- GËSHILL** m. Bimë barishtore e egër, e cila nxjerr nga kërcelli një lëng të bardhë si qumësht dhe i ka gjethet me gjemba të butë, që i hanë shumë bagëtitë.
- GËSHTENJË** f. 1. Dru i viseve malore, me trung të madh e me gjethe si heshtë, që bën fryte në trajtë kokrrash të vogla, të veshur me një lëkurë të ndritshme ngjyrëkafe e me një shark me gjemba; fryti i kësaj peme, i cili hahet. Gështenjë e butë. Gështenja të ziera (të pjekura). Dru gështenjë. Pyll gështenjash. Lëkura e gështenjës. Thelbi i gështenjës. Miell gështenjash. Qëroj gështenja.
- GËSHTENJË E EGËR** Dru i madh me lule të bardha të mbledhura tufë në trajtën e një koni, që mbillet anës rrugëve ose nëpër parqe për zbukurim.
- GËSHTENJË KALI** Gështenjë e egër.
- GËVEZHËZ** f. Bimë barishtore shumëvjeçare e livadheve me shumë kërceltë të hollë, me gjethe të mbledhura nga pesë, me lule në ngjyrë të verdhë ose manushaqe të ngjashme me ato të tërfilit, që e hanë shumë bagëtia.
- GISHT** m. Lule gishti luletogëz.
- GISHTJE** f. 1. Sharku i fortë, që mbështjell gjysmën e lëndës së lisit.
- GISHTOR** mb. 2. Që ka zgjatime si gishtat e dorës, pëllëmbor (për gjethet e disa drurëve e bimëve); që ka trajtën e gishtave të dorës. Gjethe gishtore.

- GLIKANXO** f. Bimë barishtore me lule të bardha si ombrellë, me fara të ëmbla e të merme që përmbajnë vaj; farat e kësaj bime. Farat e glikanxos. Vaj glikanxoje.
- GOJASLLAN** m. Lulegojë. Gojasllan i bardhë (i kuq). Lulet e gojasllanit.
- GOJË** ASLLANI Gojasllan.
- GOJË** UJKU Gojujk.
- GOJËKRAPE** f. Lulegojë. Lulet e gojëkrapes.
- GOJËLUAN** m. Gojujk.
- GOJËZ** f. 9. kryes. Gropëza shumë të vogla në pjesën e poshtme të gjethes, që zakonisht dallohen me mikroskop. Gojëzat e gjethes.
- GOJUJK** m. Lulegojë.
- GOMAR** m. Bisht gomari shih te BISHT,~I. Ferrë (gjemb) gomari shih te FERR/Ë,~A. Lule gomari shih te LUL/E,~JA. Vesh gomari veshgomar.
- GOMARE** f. 4. Dardhë gushtake, që i bën kokrrat të mëdha, me ngjyrë të verdhë në të kuqe dhe me shumë lëng; kokrrat e kësaj dardhe. Voli gomaren.
- GOMARTH** m. Gjembaç. Gjembat e gomarthit.
- GORRICË** f. 1. Dardhë e egër me degë të shkurtra e me gjemba, që bën kokrra të vogla e të forta, të cilat zbuten e ëmbëltohen kur piqen ose kur rrinë në kashtë; fryti i kësaj peme. Gorrica të ziera. Shar-tojnë gorricat.
- GRAM** II m. Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të nyjzuar e zvarritës, me gjethë të sheshta, të holla e të gjata, që rritet i shtrirë për tokë bashkë me të lashtat, më bimët prashitëse ose anës arave dhe që përdoret si ushqim për bagëtinë; krisje. Gram i trashë. Gram zvarritës. Rrënjët e gramit. Shkul gramit.
- GRAMOR** mb. Që lidhet me gramoret, që i përket familjes së gramoreve, që bën pjesë në familjen e gramoreve. Bimë gramore. Kulturat gramore.
- GRAMORE** f. vet. Familje bimësh njëthelbore, kryesisht barishtore, me kërcell të rrumbullakët, zakonisht fyl përbrenda e të nyjzuar, me lule të grumbulluara në kalli a në trajtë fshese, si grami, gruri, misri, elbi, thekra, tërshëra etj.
- GRAMUJË** m. Gram që rritet në kënetë a në vende me lagështirë e me ujë.
- GRASHINË** f. Bimë barishtore zvarritëse e kacavarëse me kërcell të degëzuar, me gjethë çift e me lule ngjyrëmanushaqe ose të verdha, që lidh bishtaja me fara të zeza dhe që dëmton drithërat e sidomos grurin, por është ushqim i mirë për bagëtinë; secila nga kokrrat e bishtajave të kësaj bime. Grashina leshatake. Grashina lulemadhe. Grashina gjethehollë. Bishtaja e grashinës. Grurë me grashinë. Qëroj grashinën. Pastroj grurin nga grashina.
- GRATHATEL** m. Grathatë.
- GRATHATË** f. Shkurre e vogël me degë të holla e të dendura me gjethë si hala, që çel lule në ngjyrë trëndafili, të cilat shërbejnë si kullotë e mirë për bletët.
- GRILL** II m. Shkurre zbukuruese, e cila rritet deri në dy metra e lartë, me gjethë trifletëshe e me lule të verdha në trajtë vileje, që lidhin fryte si bishtaja.
- GRISKËL** f. * Bar griskle shih te BAR,~I I.
- GROBULL** f. Koçkull.
- GROSHËZ** f.
1. Bimë barishtore njëvjeçare që rritet nëpër livadhe ose nëpër ara të mbjella me të lashta, me kërcell të përdredhur e me gjethë të vogla e të holla, që çel lule të kuqërreme dhe bën fryte si bishtaja. Groshëza i dëmton të lashtat.
- GROSHILË** f. Modhull.
- GROZHËL** f. Bimë barishtore kacavarëse, me kërcell të hollë e të përdredhur, që çel dytri lule në një vend me ngjyrë vjollce të hapët dhe që e bën frytin si bishtajë të mbushur me kokrra të vogla e të rrumbullakëta.

- GRUMBULLOR** mb. 2. Që rritet e bëhet në trajtë kaçube; që ka shumë degë të grumbulluara si tufë, që ka trajtën e një tufe, tufshak. Pemë (arrë, dardhë) grumbullore. Lule grumbullore.
- GRUMBULLORE** f. 2. vet. Drurë me degë të grumbulluara në trajtë tufe, drurë që rriten si kaçubë; bimë që i bëjnë lulet të grumbulluara si vile.
- GRUNAMADH** m. Bimë mjekësore, me kërcell të drejtë, me gjethe të këmbjera si të tërfilit, që bën lule ngjyrëkafe, të bashkuara në vile dhe me erë të mirë.
- GRUNESHË** f. Bimë barishtore njëvjeçare, që rritet nëpër ledhet e arave e në gurishte, me lule ngjyrë vjollce e me gjethe të trasha e pushatake, të cilat përdoren në mjekësinë popullore për mjekimin e pjesëve të vrara a të shembura të trupit dhe për plagët.
- GRUNOR** mb. * Bimët grunore Tërësia e bimëve barishtore njëvjeçare me kërcell si cilindër, të zbrazët e me nyja, me lule të grumbulluara në kalli, që bëjnë fryte njëthelbore (si gruri, thekra, elbi etj.).
- GRUNORE** f. 2. vet. Bimët grunore.
- GRURË** m. Grurë breshke lloj bari që bën kalli si të grurit, grurë i egër, grurth.
- GRURËKUQ** m. Lloj gruri me kalli të madh e pak të shtypur, që i bën kokrrat në ngjyrë të kuqërreme dhe jep prodhim të lartë.
- GRURTH** m. 1. Bimë barishtore njëvjeçare që i ngjan grurit e që rritet anës arave ose nëpër lëndina; grurë i egër, grurë breshke.
- GRUZË** f. Buhavicë.
- GUGUSHE** II f. Lulja e lofatës.
- GUNEZË** f. Bar blete, milcë.
- GUNGAÇE** mb. 2. Gungor. Rrënjë gungaçe.
- GUNGOR** mb. Që ka ose formon pjesë të dala si gungë; që ka ose formon zhardhok. Zgjatime gungore. Patatja (panxhari) është bimë gungore.
- GUNISHTE** II f. Bimë barishtore me fletë të vogla si të ullirit e të mbuluara me push, që çel lule ngjyrëmanushaqe.
- GUR** m. Bar guri shih te BAR, ~I I. Fier guri (shkëmbi) shih te FIER, ~I 1.
- GURGULLESHË** f. Bimë barishtore me gjethe të mëdha, me rrënjë si kokë hudhre, që përdoret në mjekësinë popullore kundër ngalosës së bagëtive; bar ngalose.
- GJAK** m. b) u tremb pa masë, u trondit shumë. Vajti (shkoi) gjaku deri në bark (deri në shalë) të kalit (deri në tra) shih te BAR/K, ~KU. Bar gjaku shih te BAR, ~I I. Lule gjaku shih te LUL/E, ~JA.
- GJAK QUMËSHTI** Tamblagjak.
- GJAKOS HAR** mb.
1. Që bën kokrra me tul të kuq (për një lloj portokalli); që e ka tulin të kuq (për kokrrën). Portokall gjakoshar.
- GJALPËTORE** f. Bimë barishtore, me gjethe të gjera e me lule të verdha, që rritet nëpër ara e që e ha shumë bagëtia.
- GJARPËR** m. Bar gjarpri shih te BAR, ~I I. Kërpudhë gjarpri shih te KËRPUDH/Ë, ~A. Lule gjarpri shih te LUL/E, ~JA. Presh gjarpri (i egër) shih te PRESH, ~I. Qepë gjarpri xhërrokull. Rrush gjarpri shih te RRUSH, ~I.
- GJEL** m. Lule gjeli lulëkuqe.
- GJEMB** m. Lule gjembi shih te LUL/E, ~JA.
- GJEMB (FERRË)** GOMARI Gjembraç, rrëfeshk.
- GJEMB I BARDHË** Bimë e egër shumëvjeçare me gjethe të zgjatura e me gjemba, që rritet nëpër ara.
- GJEMB LUGATI** Bimë njëvjeçare, me kërcell të degëzuar e plot me gjemba të gjatë, me gjethe të buta, pa bisht e të mbuluara me push të bardhë nga poshtë, që mbin në vende të thata, buzë rrugëze e kullotave.
- GJEMB UJKU** Ashe.

- GJEMBAÇ** m. 1. Bimë e egër barishtore me kërcell të drejtë, me gjethe të mëdha, të zgjatura, të dhëmbëzuara e me gjemba të fortë, me lule si boçë ngjyrëmanushaqe; gjemb gomari, rrëfeshk, ferreckë.
- GJEMBBARDHË** m. Gjemb i bardhë.
- GJEMBËRISHTË** f. Shkurre gjithnjë e gjelbër, me gjethe si të borzilokut, të mbuluar në të dyja anët me push dhe me lule ngjyrë trëndafili në të kuqe.
- GJEMBOR** mb. 1. Që ka gjemba, me gjemba. Shkurre gjembore. Kërcell gjembor.
- GJERDHISHTË** f. 1. Shkurre e lartë, me degë pushatake në ngjyrë argjendi, që bën lule të kuqe dhe kokrra të vogla të zeza me erë të këndshme.
- GJESHTËR** f. shih GJINESHT/ËR,~RA.
- GJETHE DELLI** Bimë barishtore e egër me gjethe të trasha, me shumë deje e të shtrira përtokë, që rritet anës vijave të ujit e pranë moçaleve dhe përdoret në mjekësinë popullore; dejëz.
- GJETHEMBAJTËS** mb. 2. Që mban gjethen; që ka a nxjerr gjethen. Bishti gjethembajtës.
- GJETHËZ** f. Gjethe e vogël, që del në fillim në sythin e bimës; gjethe e vogël, që është pjesë e një gjetheje të madhe të përbërë.
- GJETHIMË** f. Krifshë, mret.
- GJETHOR** mb.
1. Që ka gjethe, që nuk ka hala në vend të gjetheve (për drurët e shkurret); që përbëhet prej drurësh me gjethe e jo me hala. Drurët gjethorë. Pyll gjethor. 2. Që ka të bëjë me gjethen, që i përket gjethes, i gjethes; që ka të bëjë me tërësinë e gjetheve të një bime a të një druri. In-det gjethorë. Mbështjellje gjethore. Në trajtë gjethore.
- GJËNDËR** f. 3. Organ si fshikëz shumë e vogël te bimët ose në lëkurën e disa frutave, që prodhon lëngje. Gjëndrat e rrëshirës. Gjëndrat e lëkurës së portokallit.
- GJI** m. 10. Pjesa e thelluar ndërmjet bishtit të gjetthes dhe degës ose ndërmjet degës dhe trungut.
- GJILPËRËZ** f. 3. Bimë barishtore e egër, që mbin nëpër arat me grurë dhe që i ka gjethet shumë të holla si gjilpërë e lulet ngjyrëmanushaqe të hapët.
- GJINESHTËR** Shkurre e vogël, me degë të holla e të gjata, me gjethe të rralla, të vogla e heshtake, me lule të verdha, në trajtë vileje e me erë të këndshme, që lidh si fryt një bishtajë; degët e kësaj bime që përdoren për të thurur ose për të nxjerrë një fije të fortë. Degë gjineshtre. Lule gjineshtre. Lesë prej gjineshtre. Thasë prej gjineshtre.
- GJINEVERDHË** f. Lloj gjineshtre, nga lulet dhe rrënjët e së cilës del një bojë e verdhë që përdoret për të ngjyer lesh, të linjta etj.
- GJIPISTË** f. Bajame e egër.
- GJIRAK** Që është me të çara të thella e të harkuara. Gjethe gjirake.
- GJIZË** f. M'u prish gjiza thjeshtligj, iron. nuk shqetësohem fare për diçka, nuk bëhem merak, nuk më prishet puna. Lule gjize shih te LUL/E,~JA.
- GJUHË** LOPE Gjuhëlopë.
- GJUHËDELE** f. Bimë barishtore e livadheve, me gjethe të gjata si të dejëzës e me lule ngjyrë trëndafili të çelët.
- GJUHËLOPË** f. Bimë barishtore dyvjeçare me kërcell të drejtë, me gjethe pushatake të ashpra, të zgjatura në trajtë heshte dhe me lule ngjyrëmanushaqe, të grumbulluara në vile, që rritet zakonisht në fusha e buzë rrugëve.
- GJUHËNUSE** f.
1. Bimë barishtore njëvjeçare me trup të vogël e me gjethe të holla e të imëta, lulet e së cilës kanë te bishti një zgjatim si gjuhë dhe janë të helmëta. 2. Ferrënuse

- GJUHËQEN** m. Bimë barishtore dyvjeçare me kërcell të degëzuar, me gjethe të zgjatura si gjuhë qeni, me lule të kuqërreme në një degëz nga rrëza e gjetthes, që mbin nëpër livadhe ose buzë përrenjve.
- GJUHËZ** f. 5. Cipë e vogël që ndodhet në pjesën e sipërme të këllëfit të gjetthes dhe që mbështjell kërcellin (zakonisht te gramoret). Gjuhëz e bardhë.
- GJUHOR** mb. 3. Që ka trajtën e gjuhës. Gjethe gjuhore.
- GJUNJËZ** f. Shkurre e ulët me degë të holla me nyje, me gjethe shumë të vogla e me lule të bardheme, që del nëpër shkëmbinj dhe që lidh disa kokrra të kuqe të vogla me shije të athët.
- GJUNJËZORE** f. vet. Familje shkurresh të vendeve të ngrohta e të shkretëtirave, në të cilën hyjnë gjunjëza e disa shkurre të tjera.
- GJURMË** MUSHKE Gjurmëmushkë.
- GJURMËMUSHKË** f. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të rrëgjuar e me gjethe që i ngjajnë gjurmës së mushkës, që rritet në vende me lagështirë dhe përdoret si bimë mjekësore.
- GJYSMËSHKURRE** f. Bimë që e ka pjesën e poshtme të kërcellit të drunjëzuar, kurse pjesën e sipërme e ka si të barishteve; bimë që nga kërcelli qëndron midis barishteve dhe shkurreve. Rritet si gjysmëshkurre.
- HALË** f. 4. Pisha e zezë; pishë. Dru hale. Pyll hale. Si hala në bjeshkë.
- HALËZ** f. Bimë e egër barishtore, e helmët, me kërcell të ashpër në majë, me kallinj të blertë ose të kuqërremë, që rritet në toka me lagështirë.
- HALMUCË** f. Bimë barishtore njëvjeçare, që lëshon kalli me hala si gruri dhe që e ha shumë breshka; bar breshke. Halmucë vezake. Halmucë me tri hala. Kalli halmuce.
- HALOR** m. zakon. Familje drurësh si pisha, bredhi etj., që i kanë gjethet të holla e të gjata si gjilpëra dhe përherë të blerta, farat të mbledhura në një kokërr të vetme dhe drurin me shumë rrëshirë; dru që bën pjesë në këtë familje. Druri i halorëve. Pyll halorësh.
- HALOR** mb. 1. Që është i hollë, i gjatë dhe me majë të mprehtë si halë; që i ka gjethet në këtë trajtë; që përbëhet nga halorë. Gjethe halore. Dru halor. Pyll halor.
- HALTH** m. 1. Gjethe e hollë dhe e gjatë si gjilpërë që ka pisha, bredhi etj., gjethe halorësh. 2. krahin. Halmucë, bar breshke.
- HARDALL** m. 1. Sinap. Gjethe hardalli. Farat e hardallit. Rritet si hardall.
- HARDHI** f. Shkurre kacavarëse, me trung të hollë, të gjatë e të përdredhur, me lëvore ngjyrë hiri në të kuqërremtë e me plasa, me gjethe të gjera në trajtë të pëllëmbës, me lule të vogla, të grumbulluara në vile, të cilat japin si fryt rrushin; pema e mishit. Hardhi e butë. Hardhi e egër larushk. Fidan (kalem, rrënjë) hardhie. Gjethe (fletë) hardhie. Krasit hardhinë. Tenja e hardhisë. zool. Pleshti i hardhisë. zool. Merimanga e hardhisë. zool. Zhuzhaku i hardhisë. zool. Turigjati (hundëgjati) i hardhisë. zool. Këpusha e hardhisë. zool. Hiri i hardhisë. Vrug i hardhisë.
- HARDHIORE** f. vet. Familje shkurresh ku bëjnë pjesë lloje të ndryshme të hardhive etj.
- HARMOÇ** I m. 1. Pisha e butë. Pyll me harmoçë. Dru harmoçi.
- HARTINË** f. Pishë e lartë e vendeve malore, me lëvore ngjyrë hiri në të kuqe, me gjethe si halë të vendosura dy e nga dy dhe me kurorë vezake; pisha e butë. Dru hartine. Shkurre hartine. Pyll hartine.
- HASHASH** m. 1. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të gjatë e të degëzuar, me

lule të mëdha me petla si të lulëkuqes e me ngjyrë vjollce të hapët, që e ka frytin si kapsulë e të mbushur me fara të vogla. Gjethe hashashi. Lulja e hashashit. Lëngu i hashashit. Ngjyrë hashashi ngjyrë vjollce e hapët.

* Lule hashashi shih te LUL/E,~JA.

HEJDË f. shih HIK/ËRR,~RRA I 1.

HELMARINË f. Bimë barishtore shumëvjeçare, e helmët, me lule në ngjyrë të kuqe të errët në vjollcë, me kokrra si ato të kullumbrisë, që përdoren në mjekësi. Rrënjët (gjethet, kokrrat) e helmarine. Lëng (shurup) helmarine.

HELME f. Shkurre me gjethe si të shलगut e me lëng të hidhur; helmës.

HELMËS m. Shkurre e helmët e viseve jugore, me gjethe të gjata e të ngushta që nuk bien në dimër, me lule të mëdha në ngjyrë trëndafili ose të bardha dhe të bashkuara si tufë. Gjethet e helmësit. Fletë helmësi.

HELMËZ f. Bimë barishtore parazite me kërcell kacavarës e pa gjethe, që bën lule të verdha, të bashkuara si tufë dhe që dëmton rëndë bimët bujqësore; kuskutë. Helmëza e jonxhës. Helmëza dëmton fasulen (kungullin, qepën, pataten).

HEQËSE f. 6. Këputje.

HIDE f. Dru frutor me degë të shtrembra e plot gjemba, me gjethe të vogla, vezake e me dhëmbëza anash, që bën kokrra të zgjatura si ulli, të cilat kur piqen bëhen ngjyrëkafe në të kuq e të ëmbla; kokrrat e kësaj bime që hahen; xinxife.

HIDHËS m. krahin. Hithër.

HIDHNAKTH m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të lartë deri dy pëllëmbë e me lule të bardha, që mbin në toka të punuara, në djerrishta, në gërmadha, anës rrugëve etj., lulëzon nga prilli deri në vjeshtë dhe bën kokrra të zeza e shumë të hidhura.

HIDHNAQ m. Bimë shumëvjeçare kacavarëse me kërcell të drunjëzuar, me lule në ngjyrë të vjollcës ose të bardha, që lulëzon nga prilli deri në vjeshtë, bën kokrra vezake e të kuqe dhe përdoret si bimë mjekësore.

HIKËRR I f.

1. Lloj drithi që bën kokrra të vogla me cipë të murrme e përbrenda të bardha, të cilat përdoren më shumë si tagji për kafshët; grurë i zi, hejdë; kokrrat e këtij drithi. Bollgur hikkre. Arë e mbjellë me hikërr. 2. Bimë e egër barishtore ose shkurre e livadheve, me shumë lloje, me gjethe të dhëmbëzuara si të domates që bën kokrra të vogla të rrumbullakëta. Hikkra e kuqe shkurre e tillë e shtrirë ose kacavarëse, që rritet deri 2-3 metra. Familja e hikkrave.

HINARDH m. Angjinare.

HIRTË mb. Që ka ngjyrën e hirit. Ngjyrë (bojë) e hirtë. Cohë e hirtë. Sy të hirtë. Mjegulla e hirtë. Shलगu i hirtë.

HIRRË f. Bar hirre shih te BAR,~I I.

HIRRËZ f. veter. * Bar hirrëze shih te BAR,~I I.

HISËLL m. krahin. Hithër.

HITHËR f. 1. Bimë e egër barishtore që në kërcellin e në gjethet e saj të dhëmbëzuara ka një push të imët djegës dhe që përdoret si bimë mjekësore e për ushqim. Hithra mali. Gjethe (fletë) hithre. Lëng hithre. Lakror me hithra. E dogji hithra. E rrahu me hithra. Vend ku rriten hithrat vend i braktisur; gërmadhë.

HITHËRORE f. vet. 1. Familje bimësh barishtore, ku bëjnë pjesë lloje të ndryshme hithrash etj.

HITHËS m.

dhëmbëzuara e me majë, të mbuluara nga lart me push të ashpër, me lule të vogla pa bisht, druri i të cilit përdoret për lëndë ndërtimi.

HITHKË f. krahin. 1. Ajdës. Dru hithke. Gjethet e hithkës. 2. Hithër.

HUDHËR f. 1. Bimë barishtore njëvjeçare me kërcell e me gjethe si të preshit, që bën në tokë një kokë me thelpinj të bashkuar, që ka erë të fortë e të djeg dhe që përdoret si ushqim a si bimë mjekësore. Hudhër e njomë (e thatë). Kokë (thelb) hudhre. Një varg (një tufë) hudhrash. Shtypëse hudhrash. Gjellë (kos) me hudhër. Qëronte hudhra. **HUDHËR E EGËR** Bimë barishtore njëvjeçare, që rritet nëpër kullota dhe është e ngjashme me hudhrën.

HUNAP m. Shelg i butë. Gjethe hunapi. Lulet e hunapit.

HURMË f. 1. Pemë e vendeve të ngrohta, e lartë deri në dhjetë metra, me gjethe të gjata e vezake, me lule të bardha si në të verdhë, që bën kokrra të mëdha e të tulta si mollë, të cilat kur piqen, zbuten, marrin një ngjyrë të verdhë me të kuq dhe ëmbëlsohen; kokrrat e kësaj peme; kaki, hurmë deti. Hurma farëzeza. Hurma me fara (pa fara). 2. Pemë e vendeve mesdhetare, e lartë mbi dhjetë metra, me gjethe të gjata, vezake e me push të hirtë, me lule të kuqërreme ose të bardha në të gjelbër, që bën kokrra të tulta sa një lajthi e me ngjyrë të verdhë në gështenjë, të cilat, kur piqen, ëmbëlsohen shumë, hurmë vendi; kokrrat e kësaj peme. 3. Palmë frutore e vendeve të nxeha të Azisë e të Afrikës, me gjethe si pendë të zgjatura e me lule të grumbulluara në vile, që bën kokrra më të mëdha se një arrë, të tulta e me ngjyrë të verdhë në gështenjë, të cilat, kur piqen, zbuten dhe ëmbëlsohen shumë; kokrrat e kësaj palme. Hurma të thata. Hurma me farë (pa farë). 4. krahin. Vadhëviçe.

IDËRSHAH m. Barbarozë, elbarozë. Lule idërshahu. Stolisur me idërshah.

ILNJË f. shih ILQ/E,~JA.

ILQE f. Lloj dushku i vendeve mesdhetare, me trung të shkurtër e të trashë dhe me shumë degë, me gjethe dhëmbë-dhëmbë, gjithmonë të gjelbra e të shkëlqyeshme nga sipër, që bën lëndë të vogla gjatoshë

e me thumb në majë. Ilqe shekullore. Dru (lende) ilqeje. Pyll me ilqe.

JAMBALL m. Bimë bishtajore si shkurre, me kërcell të gjatë, me gjethe vezake, me lule të mbledhura në vile dhe me rrënjë të fuqishme të drunjta, që ka një shije të ëmbël dhe që përdoret për të përgatitur barëra të ndryshme, pije etj. Lëng jamballi.

JARGAVAN m. Shkurre a dru i vogël, me lule në ngjyrë vjollce të çelët ose të bardha dhe me erë të mirë, që mbillet në kopshte, në oborre etj. për zbukurim; lulja e kësaj bime; ngjyra vjollcë e kësaj luleje. Jargavan i bardhë. Ngjyrë (erë) jargavani. Kopsht me jargavanë.

JASEMIN m. Shkurre, zakonisht kacavarëse, me lule të bardha ose të verdha në trajtë ylli e me erë të mirë, që rritet në vende të ngrohta dhe që mbahet si bimë zbukuruese; lulja e kësaj shkurreje. Jasemin i bardhë (i verdhë). Erë jasemini. Lule jasemini.

JERMËSINË f. Dru ose shkurre shumë e ngjashme me dëllinjën, që ka erë të rëndë dhe bën kokrra të zeza. Dru jermësine. Erë jermësine.

JESHIL mb. bised. * Myku jeshil (i gjelbër) shih te MYK,~U.

JONXHË f. Bimë barishtore me kërcell të drejtë, me gjethe të përbëra në tri pjesë, me lule të vogla në ngjyrë manushaqe ose të verdhë, që mbillet për ta përdorur si ushqim për bagëtinë. Jonxhë e njomë (e thatë). Jonxhë e egër.

JUTË f. Bimë që rritet në Azinë Jugore e sidomos në Indi për të nxjerrë prej saj fije, të cilat shërbejnë për të bërë litarë, pëlhura të trasha etj.; fijet që nxirren nga lëvorja e kësaj bime.

KAÇE f.

1. Bimë barishtore e vogël, që nxjerr në fillim të pranverës lule me petla të bardha në të verdhë a në ngjyrë vjollce dhe që ka në rrënjë një zhardhok me shijen e pjeprit të papjekur; zhardhoku i

- kësaj luleje. Lule kaçeje. Çelën kaçet. 2. Trëndafil i egër, kacibardhë; fryti i kësaj shkurreje. 3. Lule vjeshte.
- KAÇUBOR** mb. 1. Me degë të holla që dalin tufë drejtpërdrejt nga rrënja, që rritet si kaçubë.
- KADAIFI I TOKËS** Kuskutë.
- KAFE** f. 1. Shkurre e vendeve tropikale, përherë e blertë, që bën kokrra të vogla, të cilat kanë brenda dy pjesë si gjysmërruzuj në ngjyrë të gjelbër a të përhimë; kokrrat e kësaj shkurreje. Dru kafeje. Kokrra kafeje. Mulli kafeje. Pjek (bluaj) kafënë.
- KAFE** E EGËR Bar miu.
- KAKAO** f. 1. Dru i vendeve tropikale, përherë i blertë, që bën kokrra të vogla të mbledhura në një bishtajë të madhe, të cilat bluhen e përdoren për çokollata dhe për një pije të veçantë me erë të këndshme; kokrrat e këtij druri. Kokrrat (farat) e kakaos. Gjalpi i kakaos (yndyra e kakaos) lëndë e yndyrshme që nxirret nga kokrrat e këtij druri e që përdoret në industrinë farmaceutike e ushqimore. Kakao e bluar. Një kuti kakao. Kek me kakao.
- KAKI** f. 1. shih HURM/Ë, A 1. Kaki e egër lloj hurme që bën kokrra sa një lajthi e të mbuluara me një shtresë të hollë dyllore.
- KAKUTË** f. 1. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të mëdha, që e ka kërcellin dhe lulesën si të shpendrës dhe rritet zakonisht nëpër kullota ose nëpër ledhet e arave.
- KALBËSIRË** f. 4. shih KALBËZIM, ~I 3. Kalbësira rrënjore. Kalbësira e kumbullës.
- KALBËZIM** m. 3. Sëmundje kërpudhore, që u bie pemëve ose bimëve në gjethe, në rrënjë, në fryte etj., zakonisht nga lagështira e tepërt, kalbësirë. Kalbëzimi i hidhur i pemëve.
- KALË** m. Gështenjë kali shih te GËSHTENJ/Ë, ~A.
- KALTËR** mb. Myku i kaltër shih te MYK, ~U 1.
- KALLAM** m. 1. Bimë shumëvjeçare e vendeve të lagështa, me kërcell të fortë, të lartë, të drejtë, me nyja e bosh përbrenda dhe me gjethe të gjata e heshtore; kërcelli pa gjethe i kësaj bime, që përdoret për të mbuluar çatitë, për të bërë tavane, për gardhe etj. Kallam i butë. Fyell prej kallami. Resë (lesë) kallamash. Gardh (mur) me kallama. Kolltuk prej kallamash. I gjatë e i hollë si kallam.
2. Shavar, kundje.
- * Kallam sheqeri bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe si të misrit, me kërcell të drejtë e të gjatë, nga e cila nxirret sheqer.
- KALLAMBOQ** m. krahin. * Kallamboq i hollë mel.
- KALLAMSHEQER** m. Kallami i sheqerit. Xhufka e kallamsheqerit.
- KALLM** m. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të gjatë, të hollë e të fortë, që rritet nëpër moçale dhe përdoret për të bërë tavanet e shtëpive etj., kundje. Tavan me kallma.
2. krahin. shih KALLAM, ~I I.
- KAMBANË** f. Lule kambane (këmbore) shih te LUL/E, ~JA.
- KAMBANËZ** f. 2. Lulekambanë.
- KAMBANORE** f. vet. Familje bimësh barishtore, që bëjnë lule në trajtë të kambanës.
- KAMOMIL** m. 1. Bimë barishtore njëvjeçare, që rritet në vende fushore e kodrinore dhe që bën lule si të luledeles e me erë të këndshme; lulja e kësaj bime, e cila përdoret në mjekësi si qetësues i sistemit nervor, kundër sëmundjeve të lëkurës etj. Lule kamomili. Vaj kamomili. Grumbullimi i kamomilit. 2. Pije qetësuese që përgatitet duke zier me ujë lulet e thara të kësaj bime. Një gotë kamomil. I dha fëmijës pak kamomil.

KANADEZ mb. * Plep kanadez lloj plepi me trung të trashë e me kurorë të gjerë që bëhet deri 30 metra i lartë dhe jep shumë lëndë druri.

KANELLË f. Bimë shumëvjeçare e vendeve tropikale, me lëkurë që mund të hiqet dhe të përdoret në mjekësi ose në pije e në gatesa; lëkura e tharë e kësaj bime; pluhur në ngjyrë kafe nga lëkura e tharë e kësaj bime, që ka erë të këndshme dhe që u hidhet pijeve ose ëmbëlsirave për t'u dhënë erë e shije të mirë. Erë kanelle. Ngjyrë kanelle. Salep (sytliac) me kanelle. I hedh kanelle.

KAPASTËR f. Lloj panje, me lëkurë të lëmuar, me gjethe të çara si pëllëmbë dhe me lule të ndara si dy grremça.

KAPINË f. krahin. Manaferrë, ferrëmanzë.

KAPINOK m. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell katërfaqësh e të degëzuar, me gjethe vezake e me push, e cila bën lule të vogla e të bardha dhe rritet në toka djerre, nëpër gërmadha etj.

KAPOSH m. * Një kaposh (një këndes, një kokosh) plaçka shih te **KËNDES**, ~I. Kapardisej (krekosej) si kaposhi (si gjeli, si këndesi) majë plehut shih te **GJEL**, ~I. Mbeti (katandisi) kaposhi (kokoshi) një thellë shih te **THEL/Ë**, ~A. Pendë kaposhi shih te **PEND/Ë**, ~A.

KAPSULË f. 1. Fryti i thatë i disa bimëve, që ka shumë dhomëza të mbushura me fara. Kapsula e hashashit.

KAPTINË f. (e bastunit, e lules etj.). Kaptina e malit (e kodrës). Kaptina e lules. lulesë e përbërë nga disa lule që është si një kokë.

KARAFIL m. 1. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të dobët, me nyja e të degëzuar, me gjethe të holla e të gjata, që bën lule të bukura, me ngjyra të ndryshme e me erë të këndshme. Karafil i kuq (i bardhë, me pikla). Erë karafil.

KARAFILORË m. vet. Familje bimësh barishtore njëvjeçare, me kërcell me nyja e

të degëzuar, me gjethe të holla e të gjata dhe që bëjnë lule të bukura, me ngjyra të ndryshme e me erë të këndshme; familja e karafilave.

KAROTË f. Bimë barishtore me gjethe të buta që dalin tufë afër rrënjës dhe me rrënjë boshtore më të gjerë përsipër e në ngjyrë tulle, që ka vlera të mëdha ushqimore; rrënja e kësaj bime, që përdoret si ushqim. Karotë e egër karotë që del nëpër toka kodrinore, rrënja e së cilës nuk hahet. Karota të ziera. Ngjyrë karote. Pure karotash.

KARTHË f. Ajdës. Karthë e egër rrunjë.

KASTRAVEC m. 1. Bimë njëvjeçare, me kërcell të shtrirë përtokë dhe me gjethe të mëdha pëllëmbore, që bën një fryt të gjatë, të trashë e me ngjyrë të gjelbër; fryti i kësaj bime, që përdoret i njomë për sallatë ose bëhet turshi; trangull. 2. Lloj fiku që i bën kokrrat të mëdha e të gjata. 3. përd. mb. fig. keq. I papjekur dhe pa përvojë në jetë; budalla. Ishte fare kastravec.

KASHTË f. Lule kashte shih te **LUL/E**, ~JA.

KASHTËBARDHË f. Lloj kashtë e tokave të lagëta, me kërcell të mbushur me palcë, e cila i ka gjethet të holla e me push dhe nxjerr një lulesë në trajtë kalliri me fara.

KASHTËKUQE f. Bimë e vendeve moçalore, e ngjashme me shqirrën, që e ka kërcellin të kuq e me tri degëzime.

KASHTËRROJË f. 1. Bimë barishtore me kërcell të gjatë, të drunjëzuar e me gjemba.

KAT m. 3. Grup bimësh a drurësh të një lloji në një pyll ose në një zonë, që rriten në të njëjtën lartësi. Katet e bimëve. Kali i shkurreve (i barishteve).

KAVAK m. Lloj plepi i gjatë e i hollë, me degë të drejtuara përpjetë, që rritet anës ledheve të arave ose anës rrugëve dhe e duron thatësinë; plep i butë. Maja e kavakut. I gjatë (i drejtë) si kavak. Lloj plepi i gjatë e i hollë, me degë të drejtuara përpjetë, që rritet anës ledheve

të arave ose anës rrugëve dhe e duron thatësirën; plep i butë. Maja e kavakut. I gjatë (i drejtë) si kavak.

KEPCË f. krahin. Shelg i butë, thupër nga ky shelg për të thurur shporta, për të lidhur dua; etj.

KEQ mb. Bar i keq (i lig) shih te BAR, ~I I. Ferrë e keqe shih te FERR/Ë, ~ A. Shkoza e keqe shkozëzeza.

KËLKAZË f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, e helmët, me gjethe të mëdha e të tulta, me lule të verdha dhe me një fryt në trajtën e kallirit të misrit, i cili kur piqet mbushet me kokrra të kuqe. Gjethe këlkaze. 2. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të gjera e me zhardhokë, që përdoren si ushqim për derrat.

KËLPISHTË f. Bajame e egër. Vaj këlpishte.

KËLYSHËZ f. 2. Ndajgjethez.

KËLLËF m. 4. Pjesa e fundit e gjethe pa bisht, që mbështjell njëën e kërcellit te disa bimë (te misri, gruri etj.).

KËMBËDELE f. Radhiqe.

KËMBËPATË f. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe si këmbë pate, që bën lule në trajtë të një lëmshi me ngjyrë të gjelbër në të verdhë dhe që rritet në vende të lagështa, anës rrugëve e nëpër ledhe.

KËMBËPULË f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell si të egjërës, me gjethe të holla, me lule të verdha në trajtë kalliri, e cila bën fara si të fshesës dhe përdoret si ushqim për bagëtinë.

KËMBORË f. Lule këmbore (kambane) shih te LUL/E, ~JA.

KËMBYER mb. Gjethe të këmbjera. gjethe që në degë ose në kërcell nuk dalin çift njëra kundrejt tjetrës, por tek (nga njëra dhe nga tjetra anë) në një largësi të caktuar.

KËPUTJE II f. Bimë barishtore shumëvjeçare e tokave të lagështa, e ngjashme me fierin, me gjethe të holla e të lëmuara si ato të pishës, që këputen lehtë.

KËRP m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të lartë, nga i cili nxirren fiye për të bërë thasë, litarë etj. Fiye (litar, pëlhurë) kërpi. Vaj kërpi. Farë kërpi. Mbjell kërpi.

KËRPORE f. vet. Familje bimësh (si kërpi etj.), me kërcell të gjatë, nga i cili mund të nxirren fiye për të bërë litarë, pëlhurë të trashë etj.

KËRPUDHË f. 1. Bimë e tipit të ulët pa klo-rofil, që është zakonisht si një ombrellë e vogël, që nuk bën lule e fara, por shumëzohet me spore dhe rritet në livadhe e në pyje, në vende me hije e me lagështirë. Kërpudhë e helmët (helmuese, djegëse). Kërpudhë e bardhë (e kuqe, me pika). Kërpudhë që hahet. Kërpudhë eshke. Kërpudhë dashe lloj kërpudhe me kësulë të trëndafiltë, që hahet. Kërpudhë derri lloj kërpudhe që ka kësulën me ngjyrë të verdhë në të errët. Kërpudhë gjarpri lloj kërpudhe me kësulë në të bardhë nga jashtë dhe në të zezë nga brenda, që nuk hahet. Kërpudhë qeni lloj kërpudhe me kësulë në trajtë hinke, me ngjyrë të gjelbër të çelur dhe me këmbë të hollë, që nuk hahet. Kësula (kapela) e kërpudhës. Këmbe e kërpudhës. Supë me kërpudha. Mbledh kërpudha. Dalin (mbijnë, rriten, shtohen) si kërpudhat pas shiut (si kërpudha plehu). mospërf. dalin e rriten shpejt e me shumicë.

KËSULËKUQE I f. Lloj kërpudhe e vogël, në trajtën e një kuqe, që e ka faqen e jashtme në ngjyrë si të kuqërreme.

KIKIRIK m.

Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell shumë të degëzuar dhe me gjethe të përbëra nga katër fletëza vezake, me lule të verdha, që bën në tokë disa bishtaja me dy-tri kokrra brenda; kokrrat e thara të kësaj bime, të cilat përmbajnë vaj dhe hahen të pjekura. Kikirik i pjekur. Vaj kikiriku. Kaush me kikirik. Çokollatë me kikirik. Shiste kikirik.

KINË f. Bimë shumëvjeçare e vendeve të nxehta, me lule si vile, me lëkurë të hidhur, nga e cila nxirret pluhuri i kininës.

- KLEKË** f. Lloj pishe e vogël, që rritet si shkurre, me degë të shtrira përtokë dhe me lëkurë të përhimë në të zezë.
- KLLOGJËR** f. Kërpuhë parazitare në trajtë brirësh të vegjël, me ngjyrë të errët në të zezë, që del mbi kallinjët e thekrës, të grurit etj. në mot me lagështirë; kërpuha e thekrës; sëmundja e këtyre bimëve që shkaktohet nga kjo kërpuhë.
- KOÇIMARE** f. Mare. Lulet e koçimares. Raki koçimareje. Pyll me koçimare.
- KOÇKULL** f. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell si të urovit, që mbillet në toka të thata, bën bishtaja me kokrra të murrme në të zezë, dhe përdoret si ushqim për bagëtinë.
- KOKOÇEL** m. Bimë barishtore njëvjeçare me kërcell të degëzuar, me gjethe të buta e pak të dhëmbëzuara, që bën lule në ngjyrë të kaltër dhe rritet zakonisht në kullota, në toka jopjellore e nëpër ara; ngjyra e lules së kësaj bime.
- KOLMUTH** m. Ferrënuse.
- KOLLOGJONË** f. shih MURRIZ, ~I.
- KONOPISTË** f. Marenë. Lulet e konopishtës.
- KONVEJER** m. * Konvejeri i gjelbër vargu i rezervave ushqimore, që përbëhet prej bimësh të njoma (tërfil, jonxhë, lakër, foragjere etj.).
- KOPËR** f. Bimë barishtore njëvjeçare me kërcell të drejtë e pak të degëzuar, me gjethe të ëvogla e shumë të holla treshe, që mbillet nëpër kopshte e përdoret si erëz në gjellë. Erë kopre. Një tufë kopër. Gjizanik me kopër.
- KOQE LEPURI** Shkurre që bën kokrra të ngjashme me rrushin, rrush me gjemba.
- KOQËZ** f. 1. Bimë barishtore njëvjeçare me kërcell të degëzuar, me gjethe të gjata e heshtake, me lule të vogla e të bardha, që bën një fryt plot me farëza të zeza.
- KORTHITË** f. Bisk që nxjerr druri i cunguluar, filiz që del rreth kërcurit të një druri të prerë, mitë. Ka nxjerrë korthita. Pres korthitat.
- KOSTREVË** f. Bimë barishtore njëvjeçare e egër, me kërcell të trashë, të fortë e të gjatë, me gjethe si halëza, që bën lule si të misrit, rritet në toka me ujë dhe përdoret si ushqim për kafshët; meli i pulës, meli i egër. Kostrevë e thatë. Shkul kostrevën. I hedhin kostrevë bagëtisë.
- KRAHJETË** f. Mështekën.
- KRAHNJERR** m. Shkurre me degë të holla në ngjyrë gështenje të hapur, me gjethe si hala e me bisht të shkurtër, me lule në ngjyrë trëndafili të grumbulluara në vile, që bën fryte të vogla e të gjata, rritet më shumë në pyjet me pishë të zezë dhe përdoret për të bërë fshesa.
- KREHËR** m. * Lule krehri shih te LUL/E, ~JA.
- KREKË** f. Dru i vendeve të ngrohta, i ngjashëm me panjën, me lëvore të lëmuar në ngjyrë të kuqërreme, me gjethe të mëdha të ndara zakonisht në pesë pjesë, me lule të vogla, të blerta në të verdhë dhe me push, që bën fryte prej dy farash në ngjyrë të gjelbër dhe ka lëndë të fortë, e cila përdoret sidomos për të bërë vegla muzikore; krekëz. Kreka fletëvogël. Kreka fletëmadhe.
- KREKËZ** f. 2. Krekë.
- KRESHT** m. Pishë e zezë.
- KRIFSHË** f. Shkurre a dru me gjethe gjithnjë të gjelbra, me lule të vogla, të bardha në të verdhë e të grumbulluara si vile në rrëzë të gjetheve, që rritet në çdo lloj toke dhe përdoret kryesisht si dru zjarri ose për të bërë qymyr; mret.
- KRIPTOGAME** f. vet. Grup bimësh (si kërpuhat, fieri; etj.), që nuk çelin lule dhe nuk bëjnë fryte të vërteta, që i kanë organet e riprodhimit të fshehta dhe që shumëzohen me spore; bimë pa lule.

- KRIPTH** m. 2. shih VESHTULL,~A 1. Kokrrat e kripthit. Lëngu i kripthit. Bagëtia ha degët e kripthit.
- KRISJE** II f. Gram. Shkul krisjet në arë.
- KRIZANTEMË** f. Lule vjeshte. Krizantemë e verdhë (e bardhë). Tufë krizantemash. Lulëzuan krizantemat.
- KROCË** f. Trëndafil i egër, kaçë.
- KROMË** f. 3. Trëndafil i egër, krocë.
- KRUSPULLUK** m. Madërgonë.
- KRYELAKËR** f. Lakër e bardhë, lakër kungullore.
- KRYQORE** f. vet.
Familje bimësh që e kanë kurorën e lules të përbërë nga katër peta të vëna kryq (si lakra, sinapi, sheboja etj.).
- KUFIRMË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë e të gjatë deri një metër, me gjethe të mëdha, me lule si kambanë zakonisht në ngjyrë vjollcë të çelur dhe me rrënjë të madhe, e cila përdoret në mjekësi.
- KUKURAQ** m. Taçe.
- KULMAK** m. Lloj xunkthi që rritet në vende moçalore e që përdoret për të bërë shporta, për të lidhur tufat e perimeve etj.
- KULMETIN** m. Lloj plepi me kurorë të gjerë, me trung të trashë e me lëkurë të lëmuar në ngjyrë hiri të errët, me lule të vogla, të blerta në të verdhë të varura si vile, që rritet zakonisht anës lumenjve dhe pranë bregut të detit; plepi i zi.
- KULPËR** f. * Kulpër e butë sumbullare. Kulpër e egër (e bardhë) shkurre kaccavarëse, që rritet deri në gjashtë metra dhe bën lule të bardha, me erë të mirë.
- KULLUMBRI** f. Shkurre me degë të dendura e me gjemba, me lule të bardha, që bën kokrra të rrumbullakëta më të vogla se të qershisë, në ngjyrë blu të errët e me shije të athët; kumbull e egër; kokrrat e kësaj bime. Kullumbri të thara. Raki kullumbrish. Është si kullumbri e ka fytyrën të rrumbullakët, të mbushur e të bukur; është i shëndoshë dhe i bukur (për femijet etj.).
- KUMAK** m. Bimë barishtore njëvjeçare e vendeve të ngrohta, me gjethe pak të zgjatura, me lule të verdha që dalin grumbull nga një bisk.
- KUMBULL** f. Kumbull e egër kullumbri.
- KUNDJE** f. Lloj kallami i hollë, që rritet nëpër vende me lagështi e nëpër kënetat dhe që përdoret zakonisht për resë tavani. Resë me kundje. Mbuloj me kundje.
- KUNGULL** m. 1. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të gjatë zvarritës, me fletë të gjera sa një pëllëmbë e me lule, të verdha, që lidh kokrra të mëdha, në trajtë vezake ose gjatoshe e me fara brenda; kokrrat e kësaj bime që përdoren si ushqim. Kungull ujës kungullujës. Lule kungulli shih te LUL/E,~JA.
- KUNGULLESHKË** f. 1. Lloj kungulli që bën kokrra të holla e të gjata si tranguj, me lëkurë të butë në ngjyrë të bardheme; kokrrat e kësaj bime, që përdoren për gjellë. Kungulleshka të mbushura (të skuqura).
- KUNGULLISHTË** f. 1. Kungullujës. E mbante dhallin (qumështin) në kungullishtë.
- KUNGULLOR** mb.
1. Që e ka frytin të tultë si të kungullit, që bën fryte të rrumbullakëta e të mëdha si kungulli; që rritet e zhvillohet si kungulli (për disa bimë si trangulli, pjepri etj.). Bimë kungullore.
- KUNGULLUSH** m. Lloj kungulli i egër, me gjethe të trasha, në trajtë trekëndëshi e me lule të verdha, që del vetiu nëpër gërmadha e toka të papunuara dhe bën kokrra të gjata e të tulta.
- KUNUPICË** f. shih MAREN/Ë,~A. Lulet e kunupicës.
- KUPË** f. 8. Fletë të vogla të gjelbra, të vendosura në trajtë hinke, që mbështjellin dhe mbrojnë burbuqen e lules. Kupa e lules (e karafilin, e trëndafilin).

KUQ mb. Misër i kuq. Grurë i kuq. Tërshërë e kuqe. Pisha e kuqe. Trëndafil i kuq. Oriz i kuq. Panxhari i kuq. Ulliri i kuq. Dëllinja e kuqe. Man i kuq. Kumbull e kuqe. Duhani i kuq. Ferrë e kuqe fer-rëkuqe, drizë. Fryzë e kuqe fryzëkuqe.

KUQËLARE f. Bimë shumëvjeçare, me kërcell të lëmuar e të gjatë deri në një metër, me gjethe të gjera e të ashpra, me lule të kuqe a ngjyrë trëndafili, që rritet në toka të lëna djerr. Mbuloi kasollen me kuqëlare.

KUQËLORE f. Lloj kërpudhe me ngjyrë si të arit, që është shumë e shijshme në të ngrënë. Mbledh kuqëlore.

KURORË f. 7. Pjesa e sipërme e një druri, që përbëhet nga degët, gjethet e lulet.

8. Pjesë e lules, që përbëhet nga disa petla të vendosura sipër kupës; lulesë. Kurora e lules.

KURORËZ f. 2. Kurora e lules.

KUSKUTË f. Helmëz.

LABOT m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të gjatë, me gjethe të gjelbra të errëta a të çelëta në të verdhë, të ngjashme me ato të spinaqit, që mbin nëpër toka të punuara ose mbillet dhe përdoret si ushqim. Labot i egër. Labot i butë. Dollma me fletë laboti. Farat e labotit. Lakror me labot.

LAFSHAGJELE f. 2. Lloj kërpudhe johelmuese, që i ngjan lafshës së gjelit.

LAFSHË GJELI Bimë barishtore me kërcell e me gjethe në ngjyrë të kuqërreme dhe me lule të kuqe, të ngjashme me kreshtën e gjelit, e cila rritet nëpër kopshte e lulishte për zbukurim.

LAFSHINË f. Bimë barishtore kacavarëse, me gjethe vezake përherë të blerta, me lule në ngjyrë të kaltër a si të bardha, që rritet nëpër gardhe, në pyje e në vende me hije; menekshe gomari.

LAJTHATË f. Lofatë.

LAJTHI f. Dru a shkurre e vendeve malore me klimë të butë ose e vendeve të ngrohta e me lagështi, me degë të holla e të lakueshme, me gjethe si zemër, të gjera e me dhëmbëza anash që bën kokrra të vogla me guaskë të fortë; kokrrat e kësaj bime, që kanë brenda një thelb të rumbullakët a pak të zgjatur, i cili hahet. Lajthi e butë. Lajthi e egër. Lajthi të pjekura (të qëruara). Pyll me lajthi. Thyej (çaj) lajthi.

LAJTHIZË f. Bimë barishtore njëvjeçare, që rritet në bjeshkë në trajtë xhufke dhe bën lule me pak erë. Lajthiza del në pranverë.

LAKËR f. 1. Një nga perimet kryesore të vjeshtës e të dimrit që mbillet në kopshte e rritet si kokërr e madhe me gjethe të gjera, të mbledhura e të ngjeshura njëra mbi tjetrën. Lakër e bardhë (e kuqe). Lakër turshi. Një kokë lakër. Koçani (kërcelli) i lakrës.

3. zakon. Barishte të ndryshme të egra e të buta (si lëpjetë, laboti, nenët, hithra, spinaqi etj.) që përdoren si ushqim për njerëzit e për kafshët. Lakra të egra (të buta). Lakra dimri (behari). Lakra mali. Byrek (lakror) me lakra. Gjellë me lakra. Mbledh lakra. Grij lakrat.

Lule lakre lulëlakër.

LAKËR DETI Lloj alge e ujërave të kripura që bëhet e rumbullakët si kokë lakre.

LAKËR PATE Bimë barishtore e egër, me gjethe si të dejzës, por më të vogla, me lule të verdha e me fara të grumbulluara në vile, që rritet në toka me lagështi dhe e hanë shumë patat e rosat.

LAKËR QENI Bimë barishtore e egër, që rritet në kullota e në vende me shkurre dhe që ka lëng të hidhur e mund të helmojë kafshët që e hanë.

LAKËR E VERDHË Bimë barishtore e egër, me lule të verdha e të rumbullakëta, me gjethe të vogla e me push në anën e poshtme, që rritet në vende pa ujë ose pa lagështirë të tepërt.

- LAKËR** ZOGU Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të holla, me lule të grumbulluara dhe me fara të mbledhura si xhufkë, të cilat i hanë shumë zogjtë dhe që rritet në lëndina e fusha.
- LAKËRISHTË** II f. Bimë barishtore ujëse, me kërcell të gjatë, me lule të bardha dhe me gjethe të gjera gjithë push, të cilat rrinë të zhytura në ujë.
- LAPËRUSHE** f. Kërpudhë me kësulë të rumbullakët, në ngjyrë të bardhë në të murme, që ka erë të këndshme dhe që ahahet.
- LAPËRUSHKË** f. Lapërushë.
- LAR** m. * Lari i egër (lari i zi) ashe, beronjë. E diela e larit (e dafinave, e luleve) fet., vjet. shih te DAFIN/Ë, ~A.
- LARËZ** I f. shih LARUSHK, ~U.
- LARTH** m. 1. Ashe. 2. Urth.
- LARUSHK** m. 1. Lloj rrushi i egër, me kokrra të vogla si të kuqërreme, të rralla e të athëta; fryti i kësaj peme. Larushku i pylit. Një vesh larushk. Ta mbledh gjuhën larushku.
- LARUSHKË** f. 1. vet. nj. shih LARUSHK, ~U 1.
- LAVARE** f. 5. Dredhëz e hollë që lëshojnë disa bimë për t'u kapur nëpër degë a diku tjetër.
11. Lule të grumbulluara në bistak, që nxjerrin disa drurë, vile.
- LAVERDHËZ** f. Shkurre kacavarëse, në shumë lloje, me gjethe e me lule në trajta e në ngjyra të ndryshme, që rriten nëpër pyje e kullota, anës ledheve etj. e mbahehen edhe si bimë zbukuruese. Laverdhëza përdredhëse. Laverdhëza erëkëndshme dorëzonja. Laverdhëza e pyjeve.
- LEBËR** f. mjek. veter. * Bar lebre shih te BAR, ~I I.
- LEPUR** m. Koqe lepuri shih te KOQ/E, ~JA. Lule lepuri shih te LUL/E, ~JA. Rrush lepuri larushk.
- LEPURUSHKË** f. 3. Lloj kërpudhe e madhe, me kësulë të bardhë, e cila ahahet.
- LEQIKË** f. 1. Marule. Sallatë me leqika. 2. Radhiqe.
- LERTH** m. 1. Urth. Gjethe (lule) lerthi. 2. Hudhër e egër.
- LESHNJE** f. Myshk.
- LESHTAK** mb. Që ka shumë push; që ka fije të holla e të gjata. Gjethe (rrënjë) leshtake. Kërcell leshtak.
- LESHTERIK** m. Bimë e thjeshtë që nuk ndahet në kërcell, gjethe e rrënjë dhe që rritet në det ose në vende të tjera me ujë. Leshterik i gjelbër (i kuq). Leshterik deti (liqeni). Leshterik kroi.
- LETËR** f. Lule letre shih te LUL/E, ~JA.
- LËKORE** II f. Radhiqe. Lëkore e egër.
- LËKUA** m. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të mëdha e me lule të bardha në të verdhë që dalin mbi ujë, e cila rritet në liqene e në ujëra të ndenjura; lëpushë. Lëkua gjoli. Lule lëkoi.
- LËKURTË** mb. 2. Lëkuror. Gjethe (fletë) të lëkurta.
- LËMASHK** m. 1. Lëmyshk. Lëmashku bren gurin, përtimi fik burrin. fj. u.
- LËMYSHK** m. 1. Bimë e thjeshtë, zakonisht e gjelbër e në trajta të ndryshme, që nuk ka ndarje në kërcell e në gjethe dhe që rritet në vende të lagëta; në ujë, mbi trungun e drurëve, mbi gurë e tjeçulla, mbi mure etj.; myshk. Lëmyshk uji (lumi, kroi, burimi). Lëmyshk guri (shkëmbi, muresh). Lëmyshk drurësh (lisi). Lëmyshk bjeshkësh (pyjesh). Erë lëmyshku. Mbledh lëmyshk. Ka zënë (ka vënë) lëmyshk muri.
- LËNGSHTRYDHE** f. Luleshtrydhe.
- LËPJETË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare në lloje të ndryshme, me gjethe vezake a gjatoshe, që rritet e egër ose mbillet në kopshte dhe përdoret si ushqim për njerëzit e për kafshët. Lëpjetë e egër (e

- butë). Lëpjetë e thartë (e ëmbël). Lëpjetë bjeshke lloj lëpjetë që rritet në vise malore dhe është mjaft e thartë, uthullaç. Lëpjetë uji. Lëpjetë kali lloj lëpjetë me fletë të gjata si heshtë e me njolla të keqe. Lëpjetë guri. Lëpjetë lepuri uthullishte. Lëpjetë me oriz (me miell). Gjethe (fletë) lëpjetë. Lakror me lëpjetë. Tavë me lëpjetë. Mbledh lëpjetë.
- LËPUSHË** f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të mëdha, me lule të bardha në të verdhë, që rritet në liqene, në ujëra të ndenjura etj.; lëkua. Lëpushë gjoli.
2. Bimë barishtore dyvjeçare, me gjethe vezake e me push nga të dyja anët, me kërcell të lartë deri dy metra, që çel lule të verdha në tufë.
3. Lloj lëpjetë e hidhur me fletë të gjata e si të kuqërreme që rritet nëpër hendeqe e në vende me lagështirë dhe që nuk hahet; lëpjetë kali. Nuk është lëpjetë, po lëpushë.
- LËPUSHKË** f. 1. shih LËPUSH/Ë,~A 1, 4. Lëpushkë kënete. Lëpushkat e duhanit.
- LËVARËS** m. 2. Emërtim i përgjithshëm për bimë kacavarëse si hardhia etj., që ngjiten e kapen nëpër degët e pemëve; shtalbës.
- LI** m. Liri i breshkës Liri i egër. Liri i egër Bimë barishtore e hidhur, me gjethe të holla, të gjata e të dendura, me lule të verdha, që rritet në vende të ulëta dhe nuk e hanë bagëtitë.
- LIG** mb. Bar i lig (i keq) shih te BAR,~I.
- LIGUSTËR** f. shih VOSHT/ËR,~RA. Ligustër tra e rëndomtë. Ligustër japoneze.
- LIKEN** m. Bimë e ulët, që përbëhet nga një kërpudhë e nga alge, të cilat bashkëjetojnë e formojnë një organizëm të vetëm mbi lëvoret e drurëve, mbi gurë e shkëmbinj, nëpër mure etj.; shpërgëti; në grup bimësh të këtilla. Likeni i verdhë. Llojet e likeneve.
- LILAK** m. Jargavan. Ngjyrë lilaku. Erë lilaku. Kopsht me lilakë.
- LIMFË** f. 2. Lëngu që qarkullon brenda trupit të bimëve dhe që përbëhet nga uji e nga kripëra të ndryshme. Limfë organike (joorganike). Limfa e drurit.
- LIMON** m. 1. Agrume me gjethe gjithnjë të gjelbra, që bën kokrra vezake në ngjyrë të verdhë të çelur; kokrra e këtij druri me lëvore të trashë, me lëng të thartë e me erë të mirë. Lule (gjethe, kokërr) limoni. Lëkurë limoni. Lëng limoni. Erë limoni. Ngjyrë limoni ngjyra e verdhë e çelur. Çaj me limon. Supë me limon. Shtrydh limonin.
- Limon i ëmbël lloj limoni që bën kokrra vezake pak si të rrumbullakëta e të ëmbla.
- LIQE** I f. Xinë.
- LIRË** mb. Thekë të lira. Organ i lirë. organ që nuk është i ngjitur me trupin e një bime.
- LIS** m. 1. Dru pylli i lartë, me gjethe me dhëmbëza anash, që lidh lëndë dhe që përdoret si lëndë ndërtimi e për zjarr; dushk. Lis i bardhë qarri. Lis i butë bungëbuta.
- LISËN** f. Bimë e egër barishtore, zvarritëse ose gjysmëshkurre, me gjethe të vogla vezake, me lule të kuqërreme, të kaltra, të kuqe ose të bardha, që ka erë të këndshme e në disa krahina përdoret edhe si erëz për gjellë.
- LIVADH** m. Tërfile i livadheve. Trumcaku i livadheve. zool. E la livadh. Kositin livadhet.
- LIVANDË** f. 1. Gjysmëshkurre shumëvjeçare, me degë të shumta e të thjeshta, me gjethe vezake ose edhe të zgjatura si heshtë, që bën lule të kaltra me erë të mirë; trumzë e butë. Vaj livande. Erë livande.
- LOFATË** f. Dru a shkurre e vendeve të ngrohta mesdhetare, me degë mjaft të lakueshme, me gjethe të gjera në trajtë zemre dhe me lule ngjyrë trëndafili, që çelin në tufë para gjetheve. Lëkurë lofate. Gardh (kosh) lofate.

- LOFATORE** f. vet. Gjini drurësh e shkurresh (si lofata etj.) me degë të holla e zakonisht të lakueshme, me gjethe të rumbullakëta e me lule të kuqe ose ngjyrë trëndafili në trajtë vilesh, që rriten në viset mesdhetare dhe lidhin bishtaja.
- LOPË** f. Gjuhë lope shih te GJUH/Ë,~A I.
- LOTUES** mb. * Shelg lotues (vajtues) shih te SHELG,~U.
- LOTZONJË** f. Bari i lotzonjës drekëz.
- LOZE** f. 1. Dredhë hardhie, kungulli etj. Loze hardhie (rrushi). Lozet e kungullit.
- LUGAT** m. Gjemb lugati shih te GJEMB,~I.
- LULE** f. 1. Organi i riprodhimit të bimëve, që përbëhet nga bishti, kupa, kurora, thekët e pistili dhe që lidh kokrrën e formon farën; pjesë e bimëve që përmban organet e riprodhimit të tyre dhe që zakonisht ka petla me ngjyra. Lule mashkullore (femërore). Lule njëseksore (dyseksore). Lulet e bathës (e fasules, e duhanit, e patates). Lule kungulli (trangulli). Lule dardhe (kumbulle, molle, qershie, shege, arre).
- LULE AKSHAMI** Bimë barishtore zbukuruese, me kërcell të lartë rreth një metër, me gjethe si zemër, që çel afër mbrëmjes lule të kuqe në trajtë hinke.
- LULE AKULLI** Bimë barishtore zbukuruese me gjethe të tulta e të veshura me një cipë të bardhë dhe me lule të ashpra që nuk fishken.
- LULE ALLE** Bimë barishtore zbukuruese, me gjethe të gjata, të dhëmbëzuara e të tulta dhe me lule në ngjyrë të kuqe të ndezur, që rritet nëpër kopshte dhe i lëshon lehtë farat përtokë.
- LULE ARGJENDI** Bimë zbukuruese me gjethe si të portokallit, që bën një lule të vogël të bardhë me pesë petla e pa erë.
- LULE ARUSHE** Dorëzonjë.
- LULE BALSAM** a) Bimë barishtore, me gjethe të holla dhe me lule të vogla ngjyrë portokalli e me erë të mirë, që përdoret në mjekësinë popullore për të mjekuar plagët; balç; lule gjaku; b) Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe si heshtë dhe me lule të verdha me pesë petla, që del gjatë muajve prill-gusht nëpër vende me bar.
- LULE BEHARI** Lule vere.
- LULE BLETE** a) Bar blete, milcë; b) Dorëzonjë.
- LULE BORE** Luleborë.
- LULE BRESHKE** Lulebreshkë.
- LULE BRET KU** Zhabinë.
- LULE BUALLI** Tatull.
- LULE ÇALLME** Çallmare.
- LULE DELEJE** Luledele.
- LULE DERRI** Bar derri.
- LULE DIELLI** Bimë njëvjeçare, me kërcell të gjatë e të trashë, me lule të grumbulluara në një kokë të madhe si disk e rreth e rrotull me petla të verdha, që kthehet nga drita e diellit dhe që mbushet me fara të zeza, nga të cilat nxirret vaj.
- LULE DIMRI** Bimë barishtore shumëvjeçare me gjethe të rumbullakëta e të tulta, me lule të bardha e me erë të mirë, që rritet si bimë zbukuruese.
- LULE DJATHI** Bimë barishtore e egër, me gjethe si ato të fierit, me lule të verdha, që përdoret për të zënë qumështin djathë.
- LULE DUSHKU** Bimë barishtore e egër, me gjethe si ato të dushkut e të mbuluara me push, që qel lule të bardhë.
- LULE DYLLI** a) Bimë kacavarëse, me gjethe vezake të tulta, të mbuluara me një lëndë si dyllë dhe me lule të bardha në vile, që rritet si bimë zbukuruese; b) Qumështore, lulequmështore, luleradhique.
- LULE DHENSH** Luledele.
- LULE ETHESH** Trikë, bar ethesh.
- LULE FIERI** Bimë barishtore, me gjethe si të fierit, që rritet edhe si bimë zbukuruese.
- LULE FILXHANI** Lulefilxhan.

- LULE FLORIRI** Bimë barishtore, me gjethe të gjata anës kërcellit dhe me një boçe me lule të verdha në krye, që rritet si bimë zbukuruese.
- LULE FSHESE** Bimë barishtore, me gjethe në ngjyrë të gjelbër të errët e me lule të bardha, që rritet edhe si bimë zbukuruese dhe, kur thahet, përdoret për të bërë fshesa.
- LULE GISHTI** Luletogëz.
- LULE GOMARI** Qumështore, luleradhique.
- LULE GJAKU** Lule balsami, balç.
- LULE GJARPRI** Bimë barishtore zvarritëse, me gjethe të vogla, me degë të tulta dhe me lule të verdha e të kaltra, që rritet fushave e pranë gardheve.
- LULE GJELI** , krahin. Lulëkuqe.
(LULE GJEMBI) Ferrë gomari, gjembaç.
- LULE GJIZE** Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të drejtë e me gjethe heshtake, që çel lule të verdha dhe rritet zakonisht nëpër ara.
- LULE HASHASHI** Hashash.
- LULE KADIFEJE** Lulekadife.
- LULE KASHTE** Bimë barishtore, me kërcell të lartë rreth një metër, me gjethe të gjata në trajtë heshte, që rritet në tokë të pastër, të lehtë e me shumë diell; lulekashtë, lulebukje.
- LULE KËMBORE (KAMBANE)** Lulekëmborë.
- LULE KREHRI** Lulekrehër.
- LULE KUNGULLI** Lulekungull.
- LULE LAKRE** Lulelakër.
- LULE LËPURI** Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë, me gjethe vezake e me bisht të gjatë, që çel lule të kaltra.
- LULE LETRE** Luleletër.
- LULE MAJI** Bimë zbukuruese, që kacavaret në mur dhe që çel në maj lule të bardha ose të verdha e me erë shumë të mirë.
- LULE MBRËMJEJE** Lule akshami.
- LULE MËLLAGE** Lulemëllagë.
- LULE MËNGJESI** Bimë zbukuruese kacavarëse, me gjethe si zemër, me lule të bardha, të kaltra ose ngjyrë vjollce dhe me njolla e me vija të ndryshme, të cilat rrinë të çelura vetëm në mëngjes ose në ditë pa diell.
- LULE MIZE** Lulemizë.
- LULE MOSMËHARRO** Lulemizë 1.
- LULE MOSMËPREK (MOSPRAK)** Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të vogla si ato të mimozës, të cilat kur i prek ulen poshtë, mblidhen e rrudhen.
- LULE NGJITËSE** Lulengjitëse.
- LULE PASHKE** Menekshe.
- LULE PESHKU** Bimë barishtore dyvjeçare, me kërcell të drejtë e të lartë deri në një metër e gjysmë, me gjethe të gjata të mbuluara me push, me lule të verdha e të grumbulluara si kalli në majë të kërcellit, e cila rritet në toka të varfra e në gurishte.
- LULE PJATE** Bimë barishtore zbukuruese, me lule të vogla në ngjyrë trëndafili e pa erë, e cila rritet e rrumbullakët si rreth.
- LULE PLEPI** Bimë barishtore rreth një pëlëmbë e lartë, me lule të verdhë, të madhe e të rrumbullakët, që i ka petlat të mbyllura si kupë.
- LULE PRANVERE** Aguliçe.
- LULE PRESHI** Lulepresh.
- LULE QENI** Kamomil.
- LULE QENGJI** Luledele.
- LULE QUMËSHTORE** Qumështore, lule-qumështore, luleradhique.
- LULE QYQEJE** Luleqyqe.
- LULE REZHDE** Bimë barishtore, që rritet mbi një gjysmë metri dhe që çel lule të vogla ngjyrë jargavani.
- LULE RRUAZE** Lulerruazë.
- LULE SABAHU** Lule mëngjesi.

- LULE SAHATI** Bimë kacavarëse, me lule të bukura në ngjyrë të kaltër e të bardhë, që i ngjajnë orës së xhepit.
- LULE SAPUNI** Shkumëz, lulesapun.
- LULE SYRI** Bimë barishtore me kërcell të drejtë, me gjethe të rrumbullakëta si të vjollcës, që çel lule në ngjyra të ndryshme e pa erë; menekshe e egër.
- LULE SHARRE** Bimë barishtore e dendur si shkurre, me gjethe të gjata, të tulta e me dhëmbëza anash, që çel lule të mëdha të bardha, ngjyrë trëndafili ose të kuqe dhe mbillet për zbukurim; gjuhë vjehre.
- LULE SHEBOJE** Shebojë.
- LULE SHPATE** Shpatore, luleshatë.
- LULE SHQERRE** Luledele, luleshqerrë.
- LULE SHQIPONJE** Luleshqiponjë.
- LULE TAMBLI** Qumështore, bar tambl.
- LULE THOI** Bimë zbukuruese, me gjethe të grumbulluara, të holla e të shkurtra si hala pishe, por të buta, e cila çel lule të verdha.
- LULE VATHI** Lulevath.
- LULE VEDRE** Lulevedër.
- LULE VERE** Bimë barishtore me lule të verdha, që çel në verë.
- LULE VEZE (VEJE)** Luleve.
- LULE VIZHE** Lulevizhë.
- LULE VJESHTE** a) Bimë barishtore e helmët, me lule të bardha në vjollcë, e cila rritet në kullota me lagështi dhe çel në vjeshtë; bar plakash; b) Bimë barishtore shumëvjeçare zbukurimi, me gjethe shumë të çara e të mbuluara me një push të imët, me lule të verdha, të mëdha e pa erë, të cilat çelin në vjeshtë.
- LULE VRESHTI** Dorëzonjë, lulevreshtë.
- LULE YLLI** Luleyll.
- LULE ZJARRI** Lulezjarr.
- LULE ZOGU** Gjuhënuse.
- LULE ZONJE** Lulezonjë.
- LULEAKSHAM** m. Lule akshami.
- LULEALLE** f. Lule alle.
- LULEBARTËS** mb. Që çel lule, që ka lule. Bimë lulebartëse.
- LULEBLETË** f. Bar blete, milcë.
- LULEBRESHKË** f. Bimë barishtore, me gjethe e me degë të mbuluara me push të gjatë, me lule ngjyrë trëndafili, që rritet në vende të thata e fushore.
- LULEBUFKË** f.
1. Bimë barishtore zbukuruese me gjethe të vogla e të holla, me lule të verdha e të grumbulluara në tufë. 2. Bimë e egër barishtore, me degë të holla e të grumbulluara si tufë, që rritet në ujëra të kripura dhe që e hanë peshqit si ushqim.
- LULEBUKJE** f. Lule kashte.
- LULEÇIMKË** f. Bimë barishtore e egër, që çel lule të vogla, të verdha, pa erë e me shumë petla.
- LULEDELE** f. Luleshqerrë, lule dhensh.
- LULEDIELLI** m. Lule dielli.
- LULEDIMËR** m. Lule dimri.
- LULEDREDHË** f. Dredhëz.
- LULEFILXHAN** m. Bimë barishtore dyvjeçare ose shumëvjeçare, me kërcell të drejtë, me lule si kupë e vogël a si filxhan dhe në ngjyra të ndryshme, e cila rritet në natyrë ose mbillet si bimë mjekësore e zbukuruese.
- LULEFIN** m. Bar thëllëze.
- LULEFROSË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të mëdha, të rrumbullakëta a si zemër dhe me lule të bardha, që rritet në cekëtinat e liqeneve e të kënetave; zambak i bardhë uji.
- LULEGOJË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të degëzuar, me gjethe të zgjatura dhe me lule shumëngjyrëshe në trajtë goje, që mbillet në oborre e lulishte për zbukurim; gojasllan, gojujk, gojë ujku, gojë asllani.

- LULEGRERËZ** f. Bimë barishtore, me lule të vogla në ngjyra të ndryshme, që rritet si bimë zbukuruese.
- LULEKAÇE** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe të dhëmbëzuara anash, me lule të verdha ose të bardha në të kuqërreme, që çelin në tufë nëpër livadhe sapo vjen pranvera.
- LULEKADIFE** f. Bimë barishtore me kërcell të lartë rreth një metër, me gjethe të çara e të dhëmbëzuara, që çel lule të bukura shumëngjyrëshe dhe që mbillet për zbukurim.
- LULEKASHTË** f. Lule kashte.
- LULEKËMBËPULË** f. Lulekërdhokull.
- LULEKËMBORË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcel të shumtë, të drejtë e pothuajse bosh përbrenda, me gjethe vezake, me lule në trajtë këmbore e me petla të bashkuara në ngjyrë vjollce, që rritet nëpër lëndina, nëpër shkurre etj.
- LULEKËRDHOKULL** f. Bimë barishtore e ngjashme me vjollcën, që rritet në vende të larta malore.
- LULEKORCULL** f. Bimë shumëvjeçare, që rritet si shkurre ose me kërcell të drejtë e të lartë, ka gjethe të gjata e të çara dhe çel lule në trajtë tufe, të cilat lidhin kokrra të verdha; bar të preri.
- LULEKREHËR** m. Bimë barishtore, që i ka gjethet të holla e të gjata si dhëmbët e krehrit.
- LULEKUNDE** f. krahin. Lulëkuqe.
- LULEKUNGULL** m. Bimë barishtore zvarritëse, me gjethe të rrumbullakëta e të mbuluara me push dhe me lule shumë të bukura, që mbillet nëpër kopshte si bimë zbukuruese.
- LULEKUPË** f. Bimë barishtore zbukuruese, me kërcel mbi gjysmë metri të lartë, me tri-katër gjethe të trasha, të gjera e heshtake dhe me zardhok në rrënjë, e cila nxjerr vetëm një lule në trajtë kuqe në çdo kërcell, pa erë e zakonisht në ngjyrë të kuqe, të verdhë ose të bardhë; tulipan. Lulekupë e kuqe (e verdhë, e bardhë).
- LULELAKËR** f. Lloj lakre, që bën në mes të gjetheve një kokë lulësh të tulta e të ngjeshura, me ngjyrë të bardhë në të verdhë, të cilat përdoren për t'u ngrënë.
- LULELESHE** f. Bimë barishtore e ngjashme me tërflin, që rritet nëpër livadhe dhe përdoret në mjekësinë popullore për të shëruar plagë të ndryshme; tërfil plagësh.
- LULELETËR** f. Bimë barishtore zbukuruese, me gjethe të gjelbra në mes dhe të bardha anës, me lule të bardha në tufa, që i kanë petlat me vija si gjurmët që lënë gishtat në letër.
- LULEMAJ** m. Lule maji.
- LULEMËLLAGË** f. Bimë zbukuruese me gjethe të rrumbullakëta si të mëllagës e me erë të mirë, me lule tufa-tufa në ngjyra të ndryshme, që mbillet në saksia dhe nëpër kopshte.
- LULEMINE** f. Shporiz.
- LULEMIZË** f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, me lule shumë të vogla, zakonisht në ngjyrë qielli të hapur, që rritet nëpër livadhe e çeltira, në pyjet e rrallë etj. ose që mbillet si bimë zbukuruese. 2. Bimë e vogël barishtore në disa lloje, me lule të vogla, të kaltra të grumbulluara në vile, që rritet në bokërima, në pyje, në livadhe e kullota.
- LULEMUSTAK** m. Dorëzonjë.
- LULENGJITËSE** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me lule të kuqe, që i ka gjethet e kërcellin me push të imët ngjitës dhe që rritet në ara e livadhe.
- LULENISHTE** f. Bimë barishtore me lule të kuqe, që mbillet për zbukurim nëpër oborre e në lulishte.
- LULENURË** f. Bimë barishtore, me gjethe si zemër e me lule të verdha, që rritet nëpër pyje e mbillet edhe si bimë zbukuruese.
- LULENUSE** f. Lulëkuqe.

- LULEPATATE** f. Bimë shumëvjeçare, me lule të mëdha në ngjyra të ndryshme, që i ka rrënjët si kokrra patateje dhe mbillet për zbukurim nëpër oborre e lulishte.
- LULEPRESH** m. Shpatëz II 2.
- LULEQERSHI** f. Shkurre e vogël me gjethe të imëta gjithnjë të blerta, që bën kokrra të kuqe si qershi dhe që mbillet si bimë zbukuruese në lulishte, në oborre etj. ose në saksi.
- LULEQYQE** f. Bimë barishtore, me gjethe të ngjashme me ato të zymbylit dhe me lule ngjyrë trëndafili e të grumbulluara në një vesh të dendur, që rritet e vetmuar nëpër kullota e livadhe.
- LULERADHIQE** f. Qumështore, lulequmështore.
- LULERRUAZË** f. Bimë barishtore, që rritet deri në një pëllëmbë dhe çel lule të vogla si rruaza.
- LULESAPUN** m. Shkumëz, lule sapuni.
- LULESË** f.
Tërësia e luleve të grumbulluara në trajtën e një koke, të një lëvari, të një kalliri, të një vileje etj.; grumbull a tufë lulesh që kanë një bisht kryesor. Lulesë e madhe (e vogël). Bimë me një lulesë (me shumë lulesa).
- LULESY** m. Lule syri.
- LULESHEBOJË** f. Shebojë.
- LULESHPATË** f. Shpatore, lule shpate.
- LULESHPATËZ** f. Shpatore.
- LULESHQERRË** f. Bimë barishtore e vogël e livadheve, me kërcell të hollë e me gjethe vezake, që bën lule me zemër të verdhë e me shumë petla të bardha rreth saj dhe që çel në fillim të pranverës, luledele, lule dhensh.
- LULESHQIPONJË** f. Bimë shumëvjeçare zbukurimi, përherë e gjelbër, me gjethe të mëdha e të prera thellë, që u përngajnë krahëve të shqiponjës; shqiponjë.
- LULESHTRYDHE** f. Dredhëz. Lëng luleshtrydhesh.
- LULESHURDHË** f. Qumështore, lulequmështore, luleradhiqe.
- LULETAÇE** f. Taçe.
- LULETOGËZ** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, e lartë deri në një metër, me lule ngjyrë trëndafili a të bardha e me pika të ndryshme, të cilat dalin në një bisht të gjatë të mbledhura si gisht e varen poshtë; lule gishti.
- LULEVATH** m. Bimë barishtore shumëvjeçare, që çel lule të vogla në ngjyrë të koqe të ndezur e me pika të bardha dhe që mbillet për zbukurim.
- LULEVE** f. Bimë barishtore, me gjethe si të patëllxhanit, me lule të bardha e të rrumbullakëta si vezë, që mbillet për zbukurim.
- LULEVEDËR** f. Bimë barishtore, me gjethe të gjera e të mbledhura në tufa, me lule të bardha a të verdha, që rritet nëpër kullota.
- LULEVERDHË** f. Zhabinë
- LULEVERË** f. Lule verë.
- LULEVILE** f. Shkurre kacavarëse, me gjethe të përbëra nga shumë fletë të vogla e heshtake, me lule ngjyrë qielli të grumbulluara në vile, që mbahet si bimë zbukuruese në mure, ballkone e kopshte.
- LULEVIZHË** f. Bimë në lloje të ndryshme, gjethet e së cilës kanë aftësinë të mblidhen e të kapin kandrrat që qëndrojnë në to.
- LULEVJESHTË** f. Lule vjeshtë.
- LULEVRESHTË** f. Dorëzonjë.
- LULEXIXËLLONJË** f. Lulemizë.
- LULEYLL** m. Bimë barishtore, me gjethe e kërcell me shumë push, që rritet në male e çel lule të bardha me pesë petla si yll.
- LULEZEMËR** f. Bimë barishtore, me gjethe të tulta, të çara më trish, të gjelbra në të hirtë përsipër, që çel lule ngjyrë trëndafili

- të ndritshme, të grumbulluara në një vile me bisht të vogël dhe që mbahet si bimë zbukuruese.
- LULEZJARR** m. Bimë barishtore në lloje të ndryshme, me gjethe vezake dhe me lule të kuqe të ndezura, që rritet si shkurre ose mbillet për zbukurim në lulishte, oborre etj.
- LULEZONJË** f. Bimë barishtore, me lule me pesë petla të mëdha e të bardha dhe me erë shumë të mirë, që rritet në male dhe kur këputet nxjerr nga kërcelli një lëng ngjitës.
- LULËBARDHË** I f. 1. Bimë barishtore e egër, me gjethe të vogla heshtore, me lule të bardha në vjollcë, që rritet zakonisht në arat e mbjella me drithëra. 2. Lloj lakre e ëmbël, me gjethe të mbledhura, që çel lule të bardha.
- LULËBARDHË** m. Fshikartë; drokth.
- LULËBUKUR** m. Bimë barishtore shumëvjeçare, që i ngjan karafilin dhe çel lule të bukura, të grumbulluara në tufa.
- LULËGJAKE** f. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe të gjera dhe me lule të mëdha në ngjyrë të kuqe të ndezur, që rritet zakonisht në vise malore ose që mbillet për zbukurim, bozhure.
- LULËKUQE** f. 1. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe si pendë të çara, me lule të kuqe me katër petla të mëdha, që rritet në të lashtat dhe në vende me gurë.
- LULËZ** I f. 1. Bimë barishtore, me gjethe të holla si hala pishe e të grumbulluara në tufë, e cila bën një boçë në majë që e thajné dhe e përdorin për fare djathi.
- LYTH** m. 4. Xhungë e vogël që del në trungun ose në degët e disa drurëve. Degë me lytha.
- LYTHËT** mb. Që ka xhunga të vogla. Degë të lythëta.
- LLAPUSHË** f. 1. shih LËPUSH/Ë, ~A.
- LLASHTËR** f. 1. Bimë e egër barishtore, me gjethe të holla e të vogla, me lule të bardha në tufë, bishtat e të cilave, kur thahen, i përdorin zakonisht si kruese dhëmbësh.
- LLOSH** m. 1. Lloj bari i gjatë me gjethe të holla e me majë, që rritet nëpër pyje, në kullota, në arat e mbjella etj. dhe e hanë shumë bagëtitë. Mal me llosh.
- LLUKË** II f. krahin. Bli.
- MADËRGONË** f. 1. Bimë barishtore helmuese pa kërcell, me rrënjë të mëdha, me gjethe të gjera që kanë erë të rëndë dhe me lule të verdha në të gjelbër; bar i trashë.
- MAJ** I m. Lule maji shih te LUL/E, ~JA.
- MAJDANOZ** m. Bimë barishtore, që mbillet në kopshte, me kërcell të butë e të hollë, me gjethe të vogla e pak të çara, të cilat kanë erë të këndshme e përdoren si erëza në gjellë të ndryshme. Tufë me majdanoz. Supë (sallatë) me majdanoz. Era e majdanozit. * Në çdo gjellë majdanoz iron. thuhet kur dikush, me vend e pa vend, merr pjesë në të gjitha punët a çështjet ose kur diçka përdoret për shumë punë edhe kur s'është nevoja.
- MAKTH** I m. Lloj bari i ngjashëm me trëndelinën, që rritet zakonisht në ara të mbjella me grurë dhe bën lule të verdha a të bardha e me erë si të mjaltit.
- MAL** m. Bukë mali shih te BUK/Ë, ~A. Rrush mali shih te RRUSH, ~I.
- MAN** m. * E shkund manin në prill shih te SHKUND. Mana toke luleshtrydhet, dredhëzat.
- MANAFERRË** f. kryes. Shkurre plot gjemba, me degë të holla e të përkulura, me gjethe të dhëmbëzuara, me lule ngjyrë trëndafili në të bardhë, e cila bën kokrra si të manit e në ngjyrë të zezë kur piqen; kokrrat e kësaj shkurroje, që kanë shije të ëmbël a majhoshe dhe hahen ose bëhen reçel etj.; ferrëmanzë. Reçel (shurup, lëng) manaferrash. Mbledh manaferra.

MANDARINË f.

Agrume si portokalli, e cila bën kokrra të vogla, me lëkurë të hollë, që i qërohet lehtë, të ëmbla dhe me erë të mirë; kokrrat e kësaj agrumeje. Mandarina pa bërthama. Lëng (shurup) mandarine.

MANUSHAQE f. * Manushaqe e verdhë badër me lule të verdha, që rritet zakonisht nëpër kënetat.

MANXURANË f. Rigon. Era e manxuranës.

MARAJ m. Maraqq.

MARAQ m. * Maraqq i ëmbël Lloj maraqqi që mbillet në kopshte dhe që e ka rrëzën e kërcellit të mbështjellë me disa palë petësh të tulta, të cilat hahen si sallatë ose gatuhet në mënyra të ndryshme.

MARASKË f. Bimë barishtore e egër, e ngjashme me koprrën, me gjethe të holla si fije, me lulesë të bardhë në majë të kërcellit e me fara të helmëta, që rritet nëpër moçale e kullota me lagështirë dhe ka erë të keqe; kopër e egër, kopër qeni, bar uji.

MARE f. Shkurre e viseve bregdetare, me gjethe përherë të gjelbra dhe me lule të bardha të mbledhura në vile, që bën kokrra të kuqe si të dredhëzës, me shije të ëmbël; kokrrat e kësaj shkurreje, nga të cilat mund të nxirret raki; koçimare. Pyll maresh.

MARENË f.

Shkurre që rritet në toka të lagështa, me gjethe të holla, të tulta e përherë të gjelbra, me lule në ngjyrë të vjollcës në të bardhë që i varen si vile dhe me dru të rëndë që përdoret për zjarr. Lule marene. Nxeh furrën me dru marene. * S'bëhet lundra me dru marene fj. u. s'vlen për një punë të caktuar, s'bëhet bukë me krunde (për një njeri ose për diçka pa vlerë).

MARENËKUQE f. Marenë.

MARSHALLOJË f. Landër. Era e marshallojës.

MARULE f. Bimë barishtore njëvjeçare që mbillet në kopshte, me gjethe të trasha e të gjata, që hahen të njoma si sallatë; zakon. gjethet e njoma të kësaj bime që bëhen sallatë. Gjethet e marules. Sallatë marule.

MARRTH m. Bimë barishtore e egër, që i ngjan grurit.

MASHKULL m. 3. Kërçelli i një bime (kryesisht i qepës) që mban farat dhe që është zakonisht i fortë, rabush. Mashkulli i qepës. Mashkulli i misrit kërcelli i misrit pa kalli.

MASHKULLOR mb. 4. Që ka vetëm thekë (për lulet). Lule mashkullore.

MBILËKURË f. 2. Shtresa e sipërme e lëvores së drurëve; cipa e jashtme që mbulon kërcellin, rrënjën, gjethet, frytin etj. Mbilëkura e pishës. Mbilëkura e domates.

MBITOKËSOR mb. (të bimës). Shpërthime mbitokësore.

MBRËMJE f. Lule mbrëmjeje shih te LUL/E,~JA.

MEÇKADIN m. Bujgër.

MEL m. Lloj drithi me kërcell të hollë e me gjethe si të grurit, që nxjerr sipër një xhufkë të mbushur me kokrra shumë të vogla; kokrrat e kësaj bime, që përdoren zakonisht si ushqim për zogjtë, për të përgatitur bozë etj. Miell (bukë) meli. Bozë meli. Sa një kokërr mel shumë i vogël. * U bë mel u mblodh, u struk e s'u ndie më (nga frika, nga turpi etj.). Humbi si meli në haliç (në rërë) u zhduk fare, nuk duket gjëkund. Është tre mel e dy grurë mospërf. është i trashë nga mendja, nuk ia pret, s'ka shumë në kokë. Të merr kokrrën (koqen) e melit para gjelit shih te KOK/ËRR, RRA.

MEL I EGËR (MELI I PULËS) Kostrevë.

MELEKUQE f. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të fortë, të hollë, të gjatë, me gjethe si të misrit e me një xhufkë të madhe në majë, që bën kokrra të vogla

si meli e në ngjyrë të kuqe dhe që përdoret zakonisht për të bërë fshesa; fshesë. Fshesë melekuqe.

MENDËR f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare me lloje të ndryshme, me gjethe vezake e me lule të imëta, të grumbulluara tufë si kalli, e cila ka erë të mirë dhe përdoret si erëz në gjellë, në industrinë farmaceutike etj. Mendër e butë dhiozmë, nenexhik. Mendër e egër. Gjethe mendre. Vaj mendre. Erë mendre. Mbjell mendër.

MENDËRZ f. Mendër e butë, dhiozmë, nenexhik.

MENEKSHE f. * Menekshe gomari bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcëj të zgjatur, me gjethe të buta e të mëdha, me lule ngjyrë blu të vetmuara e me bisht më të shkurtër se gjethet.

MERUDHI f. krahin. 1. Majdanoz.

MËGASHTËR f. Sherbelë.

MËHORR m. shih MUHAR,~I.

MËLLAGË f. * Lule mëllage shih te LUL/E,~JA. Mëllagë uji takër.

MËLLAGORE f. vet. Familje bimësh e vendeve të ngrohta, që i kanë gjethet zakonisht në trajtë të pëllëmbës dhe lulet të mëdha e me pesë petla.

MËLLAGJËR m. Shkurre e viseve mesdhetare me lëkurë të kuqe, me gjethe përherë të gjelbra e me lule të bardha në të blertë, që lidh kokrra si ato të mares, por të hidhura; shkopkuqe, shtopje. Pyje mëllagjri. Qymyr mëllagjri.

MËLLEZË f. Shkurre me lëvore të kuqërreme në të murrme, me gjethe të vogla si të shkozës së bardhë, me kokrra si rezhde, që përdoret zakonisht për zjarr.

MËMË f. 6. vet. nj. Bimë me farë, që luan rolin e femrës në kryqëzimin për të nxjerrë një lloj të ri. Zgjedhin mëmën.

MËNGJES m. Lule mëngjesi shih te LUL/E,~JA.

MËNISHTE f. Shkurre e vogël, me gjethe të imëta e të tulta dhe me lule të merme ngjyrë trëndafili, që rritet në vise të ngrohta, zakonisht nëpër kodra të thata o në gurishte, bedunicë. Lule mënishte. Erë mënishte.

MËRQINJË f. 1. Ferrëkuqe, drizë. 2. krahin. Hide, xinxife

MËRSINË f.

Shkurre me gjethe të vogla, të forta, me majë të mprehtë e përherë të gjelbra dhe me lule të bardha, nga degët e së cilës kullon një lëng me erë të mirë. Kokrra mërsine. Erë mërsine. * Mërsinë mali rrush thëllëze.

MËRTIK m. Ricin.

MËSHTEKËN f. Dru pylli i viseve të ftohta, me trung të drejtë, me lëvore të lëmuar e të bardhë dhe me gjethe si zemër e të dhëmbëzuara, lënda e të cilit përdoret zakonisht për orendi; krahjetë, baloshe. Pyll me mëshstekna.

MËSHTEKËR f. Mëshstekën.

MËTRIK m. Bimë barishtore që rritet në pyje e buzë lumenjve, me kërcell të shtrirë, me gjethe vezake e përherë të gjelbra, me lule në ngjyrë të kaltër të mbyllët, të vendosura në sqetullën e gjethes. Bari i mëtrikut bar që nxirret nga kjo bimë dhe që përdoret në mjekësinë popullore.

MËZHDRAVË f. Qershi e egër.

MI m. MAC/E,~JA. Vrima e miut - pesëqind grosh thuhet kur njerëzve u kanoset një rrezik i madh dhe s'dinë ku të futen që të shpëtojnë. Bar miu shpargull. Bisht miu shih te BISHTMI,~U.

MILCË f. Bar blete.

MIMOZË f. Dru i viseve të ngrohta, me trungun të mbuluar me lëvore të lëmuar, me gjethe të holla e përherë të blerta, i cili çel në fund të dimrit lule të imëta me ngjyrë të verdhë e me erë të mirë. Lule mimoze. Era e mimozës. Një tufë me mimoza. Çelën mimozat.

- MISËR** m. Fletë misri shih te FLET/Ë, ~A I.
- MISËR QYQEJE** Këlkazë.
- MISHËL** II f. Lloj kërpudhe e tultë, që hahet, e cila e ka anën e poshtme të ombrellës në ngjyrë kafe të çelur.
- MITËR** II f. Bisk i vogël i të lashtave ose i bimëve të tjera, që ka mbetur i pazhvilluar, mitë. Mitër misri (gruri).
- MIZË** f. Lule mize shih te LUL/E,~JA.
- MJALCË** f. 3. Bar blete.
- MJEDËR** f. 1. Shkurre deri një metër e lartë, me kërcell zakonisht me gjemba të hollë, që lidh kokrra të kuqe, të ëmbla e me erë të mirë, të ngjashme me ato të manaferrës; fryti i kësaj shkurreje. Mjedër e kuqe. Mjedër e egër. Kokrra mjedre. Lëng (shurup) mjedre.
- MJEDHËR** f. Mjedër.
- MJEGULL** f. 4. Sëmundja e hitshit; mykëz.
- MODHULL** f. Bimë bishtajore e ngjashme me grashinën, me lastar të gjatë e të përdredhur, që mbin nëpër grunjëra e kapet pas bimëve dhe bën kokrra të vogla, të zeza e të rrumbullakëta; mollëz. Grurë me modhull.
- MOHAQ** m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të drejtë e të lartë deri një gjysmë metri, me lulesë në trajtë të një kalliri të dendur, që mbin e rritet në toka fushore e zakonisht të lagështa dhe që dëmton drithërat. Presin (shkulin) mohaqin.
- MOLLDRAGË** II f. Bordullak.
- MOLLË** f. Hiri i mollës. Kroma e mollës.
- MOLLË DHEU** Bimë me kërcell si të lules së diellit, me rrënjë shumë të zhvilluar e me zhardhokë, të cilët hahen ose përdoren si ushqim për bagëtinë. **MOLLË E EGËR** Dru i vogël, me lëkurë të ashpër në ngjyrë të hirtë në të murrme a në të kuqërremtë, me degë të vogla plot gjemba e me gjethe vezake të dhëmbëzuara, që rritet nëpër pyje, buzë arave etj. dhe bën kokrra të vogla e të tharta; fryti i këtij druri; molçinë.
- MOLLËMUÇE** f. Mushmollë.
- MOLLËZ** II f. Modhull.
- MORINË** f. Shelg i egër.
- MOSMËHARRO** mb. Lule mosmëharro shih te LUL/E,~JA.
- MOSMËPREK** mb. Lule mosmëprek (mosprek) shih te LUL/E,~JA.
- MOSPRAK** mb. Lule mosprak (mosmëprek) shih te LUL/E,~JA.
- MREÇË** f. Lloj shqope mjaft e përhapur në vendin tonë, me lule të bardha ose në ngjyrë trëndafili e me pak erë, me rrënjë të forta, që rritet si dru i vogël a si shkurre dhe që përdoret për të bërë çibukë etj.; shqopë e butë.
- MRESHTË** f. 1. Shkurre me lule të vogla të bardheme, me gjethe gjithnjë të gjelbra, që rritet kudo e bën kokrra të vogla si ulli në ngjyrë të murrme; krifshë.
- MRET** m. Krifshë. Pyll me mret. * Mret i egër rrushkull, therpelë.
- MUHAR** m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të gjatë deri një metër, me lulesë në trajtë kalliri e me gjethe të mbuluara me push, që mbin e rritet sidomos në orizore dhe misërore, që ngjitet rrobave si rrodhja dhe përdoret si ushqim për bagëtinë.
- MURRIZ** m. Shkurre e egër me shumë degë e me gjemba, me gjethe të vogla me majë të mprehtë dhe me lule të bardha, që bën kokrra të kuqe me lëng, të cilat mund të hahen ose të përdoren në mjekësi; kokrrat e kësaj shkurreje. Murrizi i kuq ushinh. Kokrrat e murrizit. Lule murrizi. Lëng murrizi. I hyri një gjemb murrizi. Thuri gardhin me murriz. Ishte plot murriza e driza.

MURRMË mb. 2. Përdoret si pjesë e dytë në emërtimet e pathjeshta për disa kafshë, bimë a lëndë që janë tërësisht a pjesërisht në ngjyrë hiri të mbyllur si në të zezë. Krimbi i murrme. zool. Miu i murrme. zool. Ariu i murrme. zool. Bretkosa e murrme. zool. Algat e murrme. Ndryshku i murrme i grurit (i thekrës). Tokat e murrme. Qymyri i murrme. Giza e murrme.

MUSHKË f. b) ashtu e do puna. I gjeti mushka drutë keq. gjeti atë që kërkonte, e pësoi siç e meritonte, mori përgjigjen a dënimin e merituar. Harro mushkë Valarenë! iron. s'është më ajo kohë, iku ajo kohë (kur dikush e kishte çdo gjë të lehtë). Nuk mbarset mushka të pjellë mëz fj.u. nuk mund të bëhet a të ndodhë diçka e pamundshme, jashtë mendjes, edhe pse e mendon dikush. Gjurmë mushke shih te **GJURMË**, ~A. Thundër mushke shih te **THUND/ËR**, ~RA.

MUSHLINZË f. Bimë barishtore kacavarëse, me gjethe si trekëndësh, me lule si zile, në ngjyrë të trëndafilin, të bardhë ose të përzier, që del anës arave, buzë rrugëve etj. dhe lulëzon nga maji deri në fund të shtatorit. Lule mushllinze. Ushqeheshin me rrënjë mushllinze.

MUSHMOLLË f. Dru frutor i viseve të ngrohta, që bën lule të bardha dhe kokrra si të mollës, me ngjyrë të gjelbër në gështenjë të çelur; kokrrat e këtij druri, të cilat kur janë të papjekura kanë shije të athët, ndërsa, kur ndulken, ëmbëlsohen. Mushmollë verore (dimërore).

MYK m. 1. Shtresë a grumbull kërpudhash mikroskopike ose mikroorganizmash të dëmshme të përbëra nga fije shumë të holla e të gërshetuara ndërmjet tyre që riprodhohen e përhapen me anë të sporeve dhe që shfaqen si push ose si njolla mbi organizmat, në drurë, mbi sende të ndryshme etj., zakonisht në një mjedis të errët, të ngrohtë e me lagështi; sëmundje kërpudhore e tillë që u bie zakonisht bimëve a pemëve. Myk i zi (i bardhë, i gjelbër, i hirtë, i kaltër). Myku

i bukës. Myku i gështenjave (i rrushit, i agrumeve, i mollës, i duhanit). Bie erë myk. Ka zënë myk diçka. U prek nga myku. U mbulua me myk.

MYSHK I m. Grup bimësh me ndërtim më të ndërlikuar se algat, kërpudhat e likenet, pa lule, që kanë gjethe, kërcell dhe rrënjë, riprodhohen me spore dhe rriten në vende me lagështi, mbi trungje drurësh, mbi tjegulla, mbi gurë a mbi shkëmbinj, buzë përrenjsh etj. Myshku i gjelbër (i butë). Myshqe të njoma. Myshk druri. Myshk uji. Myshk pylli. Myshku i kënetës. Fije myshku. I veshur (i mbuluar) me myshk. Mbrojtja e bimëve nga myshku. Zuri myshk.

NDAJGJETHËZ f. Pjesë e vogël e një bime, që ka trajtën e një fletëze a të një zgjatimi dhe që është e vendosur aty ku zë fill gjethja.

NDËRGISHTE f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të drejtë të mbuluar me push të hollë, me lule të verdha në trajtë të gishtëzës dhe me gjethe të zgjatura, nga të cilat nxirret një lëndë mjekuese.

NDJELLËS m. Bar me të cilin ndjellim bletën, bar blete.

NDRYSHKULL m.

1. Bimë barishtore shumëvjeçare, që rritet sidomos në toka djerre e shpate gëlqerore, me kërcell deri gjysmë metri të gjatë, me lule të imëta të mbledhura tufë, që lëshon një lëng si qumësht, lloj qumështoreje. 2. Bimë barishtore shumëvjeçare, që rritet deri në një metër e lartë, me lule të mëdha, të bardha në të kuqe e me erë shumë të mirë dhe që mbillet për zbukurim.

NEJÇË f. Bimë barishtore me kërcell nyjnyja, me gjethe si heshtë e me lule ngjyrë trëndafili a të bardhëreme, që rritet zakonisht në vende të ulëta e me lagështirë. Nejçë bregdetare. Nejçë ranishtash.

NEKTARBAJTËS mb. Që mban nektarin; që prodhon nektarin. Gjëndër nektarimbajtëse.

- NEKTAROR** mb. Që ka të bëjë me nektarin; i nektarit; nektarimbajtës. Gjëndrat nektarore të luleve.
- NENEXHIK** m. Mendër e butë, dhiozmë. Nenexhik i njomë (i thatë). Gjellë (qofte) me nenexhik.
- NENË** f. Bimë barishtore njëvjeçare, që mbin në ara e në kopshte, me fara të imëta e të shumta në majë dhe me gjethe të mëdha mishtore në ngjyrë të gjelbër si në të kuqe, që përdoren për lakror; nenëz. Nenë e butë (e egër). Nenë e bardhë. Lakror me nenë.
- NENËZ** f. shih NENË, ~A.
- NENORE** f. vet. Familje bimësh barishtore si nena etj., me gjethe të këmbyera e të përkundërta dhe me lule të vogla.
- NERVËZIM** m. 2. Mënyra e vendosjes së djve në një gjethe, dellëzim. Nervëzim pendor (pëllëmbor).
- NETËR** f. Kopër. Netër qeni maraskë.
- NETULL** f. 1. Bimë e egër barishtore dyvjeçare, që rritet deri në një metër e gjysmë, me gjethe si të lëpjetës, me kërcell të fortë e me lule të vogla e të verdha në formë vileje, fijet e së cilës përdoren për të bërë fshesa.
- NEVESTËR** f. Ferrënuse.
- NËNPETËL** f. Secila nga gjethëzat, zakonisht të blerta, që përbëjnë kupën e lules, sepal.
- NËNQINGJE** f. Mendër e butë, dhiozmë.
- NËNTËSHËM** mb. spec. Që është vendosur nën diçka. Shtresë e nëntëshme. gjeol. Vezore e nëntëshme.
- NËNTOKËSOR** mb. Që gjendet nën sipërfaqen ose në brendësinë e tokës; që ndodh ose që bëhet në thellësi të tokës. Pasuritë nëntokësore. Burimet nëntokësore. Ujëra nëntokësore. Punime (galeri, tunele) nëntokësore. min. Kërçelli nëntokësor. Shpërthime nëntokësore. gjeol.
- NGASJE** II f. Prrall. Dru ngasjeje. Lëndët e ngasjes.
- NGJITËS** I m. 2. Bimë barishtore që rritet ndër ara e nëpër gjerde, me kërcell të hollë e të gjatë si të kulprës, me gjethe të çara e me gjemba, që të ngjiten pas trupit, dhe me lule të bardha në të gjelbër, që lëshojnë disa fara të murrme.
3. Urth.
- NGJITËS** II mb. 2. Kacavarës. Fasule ngjitëse.
- NUSE** f. Buzë nuseje shih te BUZ/Ë, ~A.
- NYJË** f. 4. Vendi i fryrë i një dege a kërcelli prej nga shpërthejnë gjethet; pjesë e fryrë e trungut, nga ku dalin degët; gdhe në një dëm a dërrasë. Nyja e gjethit. Nyjat e drurit (e pemës). Dërrasë me nyja.
- NJËANËSOR** mb. 1. I vendosur a i kthyer vetëm nga njëra anë. Lulesë njëanësore. Plug njëanësor.
- NJËTHELBOR** mb. 1. Që e ka farën me një thelb. Fare njëthelbore. Bimë njëthelbore. 2. si em. E, JA f. zakon. sh. E, ET. Klasë bimësh, që i kanë farat me një thelb; bimë që bën pjesë në këtë klasë.
- NJËVJEÇAR** mb. 3. Që e kryen ciklin e plotë të zhvillimit brenda një viti. Bimë (lule) njëvjeçare.
- OKËR** f. Tepë. Kashtë okre. Bollgur okre. Ngjyrë okre.
- OKLIM** m. Dru pylli me fletë si të dardhës e me push, me degë të holla, që kanë palcë të trashë në mes dhe që përdoren për të bërë cigarishte.
- OMAN** m. Shkurre e helmët, me lule të verdha dhe me erë të mirë, që rritet në vende me lagështi.
- ORESHKË** f. krahin. Mollë dheu.
- ORIZ** m. Bimë barishtore njëvjeçare e vendeve të ngrohta me kërcell të drejtë e me nyja, që mbillet e rritet në ngastra me ujë dhe që bën kokrra të vogla si të grurit; kokrrat e kësaj bime, me të cilat bëjmë pilaf ose gjellë të tjera. Oriz i veshur (i zhveshur, i qëruar, i rrahur). Kokrrat e orizit. Miell (lëng) orizi. Fidane orizi. Oxhakë orizi. Gëzhutat e orizit. Oriz me

qumësht sytliaç. Fabrika e zhveshjes së orizit. Mbjellin (korrin, shijnë) orizin. * Nuk mban më ujë orizi (pilaf, kosi, vera) shih tek UJ/Ë, I. E bëri dy ujë e një oriz shih tek UJ/Ë, I. S'ka oriz pa gurë fj. u. shih te GUR, I.

ORKIDE f. Bimë barishtore shumëvjeçare e vendeve të nxehta, me rrënjë si patate, me lule të bukura e të merme në trajta e në ngjyra të ndryshme, që përdoren për zbukurim ose për vajra erëmira. Orkide e zezë. Llojet e orkideve. Lulja e orkidesë.

OSAKË f. Bezgë, sfakë.

PAEMËR f. 5. edhe ~RA, ~RAT (të) Bimë barishtore shumëvjeçare e liqeneve dhe e kënetave, me kërcell të lartë, me fletë gjatore, që përdoret në mjekësinë popullore për të shëruar urdhjen.

6. edhe ~RAT, ~RAT (të) Lloj myshku i bardhemë, që vesh sipërfaqen e gurëve në trajtë njollash.

PAFRUT mb. Që nuk lidh kokrra, që nuk jep fruta. Pemë e pafрут.

PAKËRCELL mb. Që nuk ka kërcell, që i dalin gjethet afër rrënjës. Bimë e pakërcell.

PALCË f. 2. Pjesa e butë që gjendet brenda trungut a brenda degëve të disa drurëve ose brenda kërcjeve, rrënjës a degëve të bimëve dythelbore; buka ose zemra e trungut a e kërcellit. Palca e shtogut. Palca e arrës thelbi i arrës, buka e arrës. I heqin palcën. Mos i shiko lëvozhgën, po shikoj palcën! fj. u.

PALCËT mb. Që ka palcë (për disa drurë). Dru i palcët.

PALCOR mb. libr. 2. Që ka të bëjë me palcën e bimëve. Rreze palcore vija të holla që duken në prerjen tërthore të një druri, të cilat nisin prej pjesës së jashtme dhe shkojnë drejt palcës. Njolla palcore njolla të vogla, të rralla e me ngjyra të ndryshme, që duken në trungun e disa drurëve kur i presim tërthorazi.

PALMË f. 1. Emërtim i përgjithshëm për disa pemë të vendeve të nxehta, me trung të

gjatë e të drejtë pa degë, me gjethë gjithnjë të gjelbra, të mëdha, si pendë a si pëllëmbë, të grumbulluara në majë dhe me lule të mbledhura në trajtë rrethi, që lidhin kokrra, të cilat hahen. Palma e hurmasë. Palmë rrushi. Gjethet e palmës. Vaj palme. Verë palme. 2. Emërtim i përgjithshëm për disa bimë zbukurimi, që i ngjajnë këtyre pemëve. Palmë uji. Palmë shpatore. Palmë pëllëmbore.

PALMORE f. vet. Familje bimësh, në të cilën përfshihen palmat e llojeve të ndryshme.

PALLAMAR m. det. 3. Bar i dëmshëm, me kërcell të trashë e të gjatë si të kulprës.

PALLUA m. zool. * Syri i palloit shih te SY, ~RI.

PAMBUK m. 1. Bimë barishtore njëvjeçare e vendeve të ngrohta, me gjethë pëllëmbore që kthehen nga rrezet e diellit, me lule të mëdha e të verdha, e cila bën një boçe vezake me shumë fara të veshura me fije të gjata si push i bardhë. Ara me pambuk. Rritësit e pambukut. Boçe pambuku. Farat e pambukut. Vaj pambuku vaj nga farat e kësaj bime. Bërsi pambuku bërsi nga farat e kësaj bime. Mbjellin (ujitin, mbledhin, vjelin) pambukun.

Pambuk i egër bimë barishtore, e ngjashme me pambukun, e cila rritet në toka të rënda të mbjella me bimë që prashiten dhe i dëmton këto.

PAMBUKORE f. * Pambukorja e agrumeve sëmundje që u bie zakonisht agrumeve e që shfaqet me disa plagë në lastarë në trajtën e një shkume të bardhë, sidomos pranë sythave dhe nyjave.

PANKUSHE f. Kërpudhë që hahet, me kësulë të rumbullakët të murrme nga sipër e të bardhë nga poshtë dhe me këmbën të trashë e të kuqërreme.

PANXHAR m.

1. Bimë barishtore dyvjeçare, me gjethë të mëdha vezake e në tufë afër rrënjës dhe me një zhardhok të tultë, të madh, të rumbullakët sipër e me majë poshtë,

që përmban sheqer në sasi të ndryshme sipas llojit; zhardhoku i kësaj bime, prej të cilit nxirret sheqer ose që përdoret si ushqim. Panxhar i bardhë. Panxhar i kuq. Panxhari i sheqerit panxharsheqeri. Kokë panxhari. Sallatë me panxhar. Bërsi panxhari. Breshkëza e panxharit. zool. Mbjellin (shkulin) panxharin. 2. Panxharsheqeri.

PANXHARSHEQERI m. Lloj panxhari, nga rrënjët e të cilit nxirret sheqer.

PANJË f. Dru i pyjeve malore, me trung të lartë, të trashë e të drejtë dhe me lëvore të lëmuar në ngjyrë hiri, me gjethe të mëdha në trajtë pëllëmbë e të dhëmbëzuara, me lule të verdha e të blerta në vile, lënda e të cilit përdoret për orendi, për vegla, për gdhendje etj. Panja fletëgjëri. Panja e butë. Panja e malit. Dru panje. Orendi panje.

PAPIRUS m. 1. Lloj kallami që rritet në vendet e nxehta, zakonisht buzë lumenjve, me gjethe të holla që dalin pranë rrënjës dhe me kërcell të gjatë trekëndësh, prej të cilit në lashtësi bënin letër dhe sende të tjera. Papyrus i blertë.

PATATE f. Bimë barishtore njëvjeçare, me gjethe me push nga poshtë e me lule të bardheme, e cila mbillet zakonisht në toka të shkrifëta dhe bën zhardhokë që përmbajnë shumë niseshte e përdoren gjerësisht si ushqim etj.; zhardhokët e kësaj bime. Patate e ëmbël lloj patateje me tul shumë të ëmbël. Patate e kuqe lloj patateje me zhardhokë gjatoshë, që e kanë lëkurën si të kuqe. Patate e verdhë lloj patateje që e ka lëkurën në ngjyrë të verdhë të zbehtë. Patate verore. Patate të hershme (të vona). Patate të ziera (të skuqura, të fërguara, të pjekura). Kokrra patatesh. Niseshte (miell) patatesh. Qofte (pure) patatesh. Gjellë (tavë, mish) me patate. Dy thasë me patate. Buburreci (vrugu) i patates. zool. Mbjellin (shkulin) patate. Qëroj (ziej, skuq, pjek) patate.

PATËLLXHAN m. 1. Bimë barishtore njëvjeçare me gjethe të mëdha vezake, që

mbillet si perime dhe bën fryte gjatoshë të tulta në trajtën e kastravecit e me ngjyrë manushaqe të errët, e cila përdoret për gjellë a për turshi; fryti i kësaj bime. Patëllxhanë të skuqur (të zier, të pjekur). Patëllxhanë të mbushur. Patëllxhanë turshi. Pure (qofte) me patëllxhanë. Mish (musaka) me patëllxhanë. Bojë patëllxhani. 2. bised. Fik patëllxhanës. U poqën patëllxhanët.

PAZI f. Bimë barishtore si spinaqi, por me gjethe më të mëdha që përdoret për të bërë lakror e për gjellë të ndryshme. Gjethe pazie. Lakror me pazi.

PELIN m. 1. Bimë barishtore shumë e hidhur, me kërcell të mbuluar me push dhe me gjethe ngjyrë hiri të zbardhëlleme, me lule të vogla në ngjyrë si të verdhë, që përdoret në mjekësi, për prodhimin e pijeve të ndryshme etj. Gjethe pelini. Erë pelini. I hidhur si pelin.

PENDËKAPOSH m. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, me degë të holla që kanë në krye kallinj të vegjël me fara me majë të hollë e me gjemba të kthyer së prapi, të cilët ngjiten në leshin e dhenve ose futen në lëkurën e kafshëve dhe mund të shkaktojnë plagë të rëna. 2. Bimë barishtore shumëvjeçare, që rritet nëpër shpate malesh, në toka shkëmbore e gëlqerore dhe që ka një tufë gjethesh të dendura afër rrënjë

PENDOR mb. Që ka trajtën e një pende a të një puple. Gjethe pendore. Degëzime pendore.

PENIK m. 1. Lloj meli me kokrra të vogla të verdheme a të kuqe; mel i kuq.

PERIUDHË f. * Me periudha në mënyrë jo të vijueshme, me ndërprerje, me disa etapa. Periudhë vegetative shih te VEGJETATIV, ~ E.

PESËGISHTE f. Bar gjaku.

PESHK m. Bar peshku shih te BAR, ~ I I. Lule peshku shih te LUL/E, ~ JA..

- PESHKULLIZË** f. Bimë barishtore, që rritet duke u zvarritur për tokë ose që ngjitet pas kërcellit të misrit.
- PETAL** m. shih PET/ËL,~LA.
- PETËZ** f. 2. Petël.
- PËRBËRË** mb. Gjethe e përbërë. gjethe e formuar prej disa gjethëzash që kanë një bishtak të përbashkët.
- PËRCE** f. shih PËRCËLLAK,~U II.
- PËRDREDHËS** mb. 1. Që ka kërcell të eposhëm dhe ngjitet pas një bime tjetër duke u përdredhur, kacavarës. Bimë (shkurre) përdredhëse. Laverdhëza përdredhëse. 2. si em. E, JA f. sh. E, ET. Lastar i hollë te disa bimë, që kapet e dridhet pas bimëve të tjera, dredhe, dredhkë.
- PËRNAR** m. Prrall, ngasje. Gjethe përnari.
- PËRVASHË** f. Përvashëz.
- PËRVASHËZ** f. Bimë e egër barishtore e vendeve të ulëta, me lule të kaltra e me gjethe me të çara të shumta, që nuk hahet nga kafshët. Kurorë me përvashëza. Vinin përvashëzave mbi pìrgun e grurit të shirë.
- PËRZHUTË** f. Lulekorcull, balç, bar të preri.
- PËSHTJELLIZË** f. Dredhkë e arave.
- PIKALORE** f. Sëmundje bimësh të ndryshme, që shfaqet kryesisht me njolla në gjethet. Pikalorja e gjetheve të panxharit (të kumbullës). Pikalorja e bardhë e duhanit.
- PIPER** m. 1. Bimë kacavarëse, që rritet në vende tropikale dhe bën kokrra të zeza, djegëse e me erë të mirë; kokrrat e kësaj bime ose pluhuri djegës që bëhet duke bluar këto kokrra; piper i zi. Bima e piperit. Bluaj piper. I hedh piper pilafit.
- PIPERKË** f. 1. Bima dhe fryti i specit, spec. Piperka të kuqe. Piperka të mbushura.
- PIRRË** f. Bimë barishtore me kërcell të trashë e të ashpër, me gjethe të gjata, të ngushta e me majë të mprehtë, që rritet zakonisht nëpër kënetë. I shtroi pìrrë bagëtisë.
- PISTIL** m. Organi femëror i lules, që përbëhet nga vezorja, shtyllëza dhe kreza. Pistili është në qendrën e lules.
- PISHË** f. 1. Dru pylli me trung të lartë e të drejtë, me lëvore të plasaritur e me gjethe halore përherë të blerta, që e ka lëndën të fortë, me rrëshirë e që digjet lehtë.
- PISHORE** f. Familje bimësh halore, në të cilën hyjnë pisha, bredhi, cedri etj.
- PJALM** m. 2. Pluhur shumë i imët, zakonisht me ngjyrë të verdhë që e kanë lulet kur çelin dhe që shërben për të pllenuar bimët. Bletët (grerëzat) mbartin pjalmën nga një lule në tjetrën.
- PJALMIM** m. Veprimi sipas kuptimeve të foljeve PJALMON, PJALMOHET. Pjalmimi me anë të bletëve. Pjalmim i drejtë pjalmim që bëhet ndërmjet organeve mashkullore e femërore të së njëjtës lule. Pjalmim i zhdrejtë (i kryqëzuar, i tërthortë) pjalmim që bëhet kur pjalmi vjen nga një lule tjetër, i sjellë nga era, nga bletët etj.
- PJALMOHET** vetv. Pës. e PJALMON. Tërfili pjalmohet nga brumbujt.
- PJALMON** kal. Pllenon një bimë a një lule me pjalmim që mbartet nga thekët te maja e pistilit. Insektet pjalmojnë lulet.
- PJALMORE** f. Koka a pjesa e sipërme e thekës së lules, që përmban pjalmim. Pjalmore e kthyer nga brenda.
- PJATË** f. Lule pjate shih te LUL/E,~JA.
- PJEPËR** m. * Pjepër i egër bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell pothuaj të shtrirë në tokë, pa lastarë dhe me gjethe të trasha vezake.
- PJERËZ** f. Arrç. Lule (kokrra) pjerëze.
- PLAGË** f. Tërfil plagësh luleleshe.
- PLAK** m. 6. Madërgonë.
- PLAKË** f. Bar plakash lulevjeshtë.
- PLASJE** f. * S'i këllet plasjen (flamën)! shih te KËLLAS. Më vinte plasja më vinte shumë inat, më vinte të pëlças. Bar plasjeje shih te BAR,~I I.

- PLENËR** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, që ka kërcell të drejtë e të trashë, gjethe të zgjatura e të plota, lule në trajtë gjuhëze e në ngjyrë ari të vendosura në një radhë dhe që mund të hahet ose të përdoret për ngjyrosje e për mjekime.
- PLEP** m. 1. Dru i lartë i familjes së shelgjeve, me trung të drejtë e me degë të holla të shtrira përpjetë, me gjethe në trajtë zemre, që rritet shpejt në vende me lagështirë dhe që ka lëndë të përshtatshme për ndërtim, për orendi shtëpiake, për prodhimin e letrës etj. Plep i bardhë plep deri në 35 metra i lartë, me lëvore në ngjyrë hiri të çelur, të lëmuar e të ndritshme, me gjethe me push të bardhë në faqen e poshtme. Plep i butë plep i zakonshëm, me trung të hollë e të gjatë, që rritet në fushat e vendit tonë. Plep i egër plep deri 10-15 metra i lartë, me kurorë të rregullt, me lëvore ngjyrë hiri, me gjethe vezake të dhëmbëzuara, me bisht të gjatë e pa push, që rritet zakonisht buzë përrrenjve, në shpate malesh etj. Plep kavak plep i butë. Plep kanadez plep me kurorë të gjerë. Plep i zi lloj plepi deri në 25 metra i lartë, me lëvore ngjyrë hiri në të murrme. Dru plepi. Gjethe plepi. Dërrasë plepi. Pyll plepash. Mbjellin plepa. Është si plep ka shtat të lartë e të drejtë. U bëftë sa një plep! ur.
- Duhan plepi shih te DUHAN, ~I 1. Lule plepi shih te LUL/E, ~JA.
- PLISH** m. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drejtë e të gjatë deri katër metra, me gjethe të zgjatura e të sheshta ngjyrë hiri në të gjelbër, me lulesë në trajtën e një xhufke dhe me kallëza të dendura e të buta, që rritet nëpër kënetat e në vende me lagështirë dhe përdoret për të thurur rrogoza etj. Rrogoz prej plishi.
- PLLENOJ** kal. 2. Bëj të krijohet fara e një bime duke bashkuar bërthamën mashkullore (pjalmin) me qelizën femërore. Pllenon lulet. I pllenojnë në mënyrë artificiale.
- POLEN** m. Pjalm, end. Polem i luleve. Polenit dhe nektari.
- POLENIZIM** m. Pjalmim. Polenizim artificial. Polenizimi i kryqëzuar. Llojet e polenizimit.
- POLIK** m. krahin. Susak, kungull ujës.
- PORTOKALL** m. 1. Pemë e familjes së agrumeve, me gjethe të zgjatura, të lëmuara e gjithnjë të gjelbra, me lule të bardha e të murrme, që rritet në vende me klimë të ngrohtë dhe bën kokrra të rrumbullakëta, me lëkurë të trashë e të verdhë në të kuqe kur piquen; kokrra e kësaj peme, që ka tul të ndarë në disa pjesë, me shumë lëng, të ëmbël dhe me erë të mirë. Portokall i kuq lloj portokalli me tul të kuq e shumë të ëmbël, gjakoshare. Portokall i egër nerënxë. Lulet e portokallit. Lëvozhgë (lëkurë) portokalli. Lëng (reçel) portokalli. Erë portokalli. Fidanishte me portokaj. Brezare me portokaj. Vjelja e portokajve. Miza e portokajve. zool. Arkë me portokaj. Qëroi (hëngri) një portokall.
- PRANVERË** f. Lule pranvere agulice.
- PREKË** I f. Vrugu i bimëve. I ra preka grurit (misrit, duhanit, rrushit).
- PRESJE** I f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare gjithnjë e gjelbër, me kërcell të drejtë deri në dy metra të lartë, me gjethe të ngushta si të preshit, me anë të mprehta e të dhëmbëzuara si sharrë dhe me lulesë të gjatë, që rritet nëpër kënetat. Korrin presjet. Presja ta pret dorën si brisk.
- PRESH** m. Presh i egër (presh gjarpri) bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të shkurtër e me gjethe si të preshit, që rritet zakonisht nëpër lëndina fushore.
- PRRALL** m. Lloj dushku i vendeve të ngrohta, që bëhet rreth pesë a gjashtë metra i lartë dhe që i ka gjethet të vogla me gjemba anës; përnar. Prrall i butë beronjë. Gjethe prralli. Dru prralli.
- PSHELINOK** m. Bar blete, milcë.

PULË f. Meli i pulës kostreve. Rrush pule mana toke. Thua pule thuapulë. Verbëria e pulave mjek., veter. shih te VERBËRI,~A.

PULITH I m. Bimë barishtore e egër dhe e helmët, me lule të verdha e të grumbulluara në tufë, që rritet zakonisht në toka të lëna djerr dhe që përdoret në mjekësi.

PULLAGJEL m. Burth.

PUNGACË f. 1. Bishtdhelpër. 2. Belishë leshatake.

PUPËLOR mb. 2. Pendor. Gjethe pupëlore.

PUSH m. * Bar pushi shih te BAR,~I I.

QAFË f. 8. Pjesa e ngushtë që bashkon trungun me rrënjët e një bime, qafëz. Qafa e rrënjës. Kalbëzimi i qafës.

QAFËZ f. 6. Pjesa e ngushtë që bashkon kërcellin me rrënjët e disa bimëve. Qafëza e fidanit. Qafëza e rrënjës.

QARR m.

Lloj dushku me trung të trashë e të gjatë, me lëkurë të errët plot të çara e me gjethe vezake, që bën lëndë të mëdha. Qarr i bardhë. Qarr i leshtë bungëbutë. Qarr i kuq (i zi, i egër) bujgër. Dru (dërrasa, trarë) qarri. Gjethe qarri. Lende qarri. * Kur të bëjë qarri arra iron. kurrë, asnjëherë, kur të pjellë këndesi.

QARRABUTË m. Bungëbutë.

QARRAZI m. Bujgër.

QARRUCË f. Përnar.

QELBËS m. 2. Shkurre me degë të holla, me gjethe heshtake, që mbajnë erë të rëndë dhe me lule të verdha, që bëjnë bishtaja; karthë e egër, rrunjë. Farat e qelbësit.

QELBINË f. Arrç, shurrëpelë.

QEN m. Kërpudhë qeni shih te KËRPUDH/Ë,~A. Lule qeni shih te LUL/E,~JA. Trofta e qenit fulterëz. Kopër qeni maraskë.

QENDROR mb. 2. Që është në pjesën e mesit të një vendi, të një sendi a të një grumbulli, që ndodhet në qendër të diçkaje. Pjesa qendrore. Krahinë qendrore. Evropa Qendrore. Sheshi qendror. Tribunë qendrore. Fronti qendror. Druri qendror. shkopi i bardhë që mbetet pasi t'i hiqet një dege lëvorja.

QEPË f. 1. Bimë barishtore me kokë të nëndheshme prej shumë fletësh të tulta, të mbledhura njëra mbi tjetrën, me rrënjë si tufë, me gjethe të gjelbra si bishta të hollë e të gjatë, të zbrazët brenda e të mbyllur në majë, që bën lule të vogla të mbledhura si çadër dhe fara shumë të imëta; koka dhe gjethet e kësaj bime me shije djegëse, që përdoren si ushqim. Qepë e bardhë (e kuqe). Qepë të njoma (të thata). Qepë djegëse (e ëmbël). Qepë e tharë. Qepë të grira (të skuqura). Kokë (fletë) qepe. Farë qepe. Lëng qepe. Bishatat e qepës. Karabushi i qepës. Cipa e qepës. Barut qepe. bised. farat e imëta të kësaj bime. Varg me qepë. Mish me qepë. Sallatë me qepë. Mbjell (shkul) qepët. I vë plagës qepë e kripë. 2. Pjesa e nëndheshme e disa bimëve, që ka trajtën e një koke të rrumbullakët e pak të zgjatur prej shumë fletësh të mbledhura njëra mbi tjetrën, qepore. Qepa e zambakut. Shumëzohet me qepë.

QEPË DETI Boçkë.

QEPË GJARPRI Xhërrokull.

QEPËZ f. shih QEPOR/E,~JA I.

QEPOR mb.

1. Që e ka pjesën e nëndheshme në trajtën e një koke të rrumbullakët e pak të zgjatur si të qepës dhe prej shumë fletësh të mbledhura njëra mbi tjetrën. Bimë qepore. Perime qepore. 2. si em. f. vet. sh E, ET. Bimë barishtore si zambaku etj. që e kanë pjesën e nëndheshme si kokë qepe.

QEPOR I f. Pjesa e nëndheshme e disa bimëve barishtore, që ka trajtën e një koke të rrumbullakët e pak të zgjatur si

të qepës dhe prej shumë fletësh të mbledhura njëra mbi tjetrën. Qeporja e zam-bakut. Degëzat e qepores.

QEPUJKË f.

1. Qepë e vogël që rritet nga fara dhe që përdoret për t'u mbjellë ose për ushqim. Qepujka të regjura. Ngastër me qepujka.
2. Qepore e vogël e disa bimëve barishtore. Bimë me qepujka.

QERSHI f. Dru frutor me gjethe vezake të dhëmbëzuara, me lule të bardha të grumbulluara tufë, që bën kokrra të kuqe a të verdha, të ëmbla e me bërthamë në mes, të cilat piqen në fillim të verës; kokrrat e kësaj peme që përdoren për të ngrënë a për reçel. Qershi e butë (e egër). Qershi belica. Qershi gurje (krapje). Kokrra qershie. Bishtat e qershive. Lëng (reçel) qershie. Druri i qershisë. Vjel qershitë.

QERSHI TOKE Qershigël

QERSHIGËL f. Shkurre e ulët me shumë degë, me gjethe të vogla e të dhëmbëzuara, me lule të blerta ose në ngjyrë trëndafili të zbehtë, që bën kokrra të vogla e të rumbullakëta në ngjyrë vishnje të errët, me shije të ëmbël e pak të athët; kokrrat e kësaj bime, që hahen ose përdoren për reçel etj.; qershi toke, qershizë e egër, rrush mali, thrashegër. Kokrra qershigle. Lëng qershigle. Reçel qershigle.

QERSHIZË f. Qershigël.

QERTHULL m. 7. Pjesët e bimës, që rriten rreth e rrotull kërcellit a trungut kryesor.

QERTHULLAK mb. shih QERTHULLOR, ~E.

QERTHULLOR mb. Që është vendosur përreth kërcellit ose trungut kryesor. Gjethe (degë) qerthullore.

QËNDRUESHËM mb. 5. Që nuk bie nga druri ose nga shkurrja; kund. rënës. Gjethe të qëndrueshme.

QIME f. 6. Fije e hollë që del në rrënjët a në kërcellin e disa bimëve. Qime thithëse.

QIMNON m. Bimë barishtore dyvjeçare me kërcell të degëzuar në majë, me lule të bardha ose ngjyrë trëndafili të mbledhura si çadër, që bën disa fara të vogla me vaj, të cilat përdoren për t'u dhënë erë pijeve, ëmbëlsirave etj. Farat e qimnonit.

QINGËL I f. shih SHPEND/ËR, ~RA 1.

QIPARIS m. Dru halor mesdhetar me trup të drejtë e të gjatë dhe me një majë të zgjatatur, me gjethe të vogla luspake përherë të blerta, të renditura kryq nëpër degëza, që bën disa boçe të vogla e të forta, selvi. Qiparis i moçëm. Dru qiparisi. I drejtë si qiparis. E kishte trupin si qiparis.

QIQËR f. 1. Bimë barishtore me kërcell mjaft të degëzuar, me gjethe të vogla e të dhëmbëzuara, me lule ngjyrë qielli të hapur, që bën bishtaja vezake me kokrra të rumbullakëta si bizele, por me ngjyrë si të verdhë; kokrrat e kësaj bime, që përdoren për ushqim. Qiqra të pjekura. Bukë me qiqra. Sa një qiqër shumë i vogël.

QIQËRVIQËR f. shih KIKIRIK, ~U.

QIRITH m. Gjunjéz, bar guri.

QITRO f. Dru frutor i ngjashëm me limonin, me gjethe gjithnjë të gjelbra, që bën kokrra të mëdha me ngjyrë të verdhë e me lëkurë të trashë, me pak lëng me shije si të athët; fryti i këtij druri, që përdoret për ëmbëlsira dhe për të nxjerrë një esencë me erë të mirë. Kopsht me qitro. Reçel qitroje. Një kokërr qitro.

QUMËSHT m. Bar qumështi shih te BAR, ~I I.

Dhëmbët e qumështit shih te DHËMB, ~I I. Gjak qumështi tamblagjak.

QUMËSHTOR mb. * Lule qumështore shih te LUL/E, ~JA.

QUMËSHTORE f.

1. Bimë barishtore me gjethe të këmbëra, me lule të vogla, të verdha, të mbledhura tufë në formë çadre, kërcelli i së cilës nxjerr një lëng të bardhë si qumësht; rryell.

- QYQE** f. Lule qyqeje shih te LUL/E,~JA. Misër qyqeje këllkazë. Rrushi i qyqes shih te RRUSH,~I.
- RADHIQE** f. Bimë barishtore njëvjeçare e livadheve me gjethe të gjata e të dhëmbëzuara, me kërcell të kuq e të bardhë, që përdoret e zier për sallatë; bresë. Sallatë me radhiqe. Mbledh radhiqe.
- RAKITIK** mb. 2. Që nuk është rritur e nuk është zhvilluar si duhet, që është i dobët e i pafuqishëm (për bimët). Bimë rakitike. Fidanë rakitikë.
- RAMEÇË** f. Bimë barishtore e kënetave, me të cilën bëhen fshesa. Fshesa rameçe.
- RAVEN** m. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të trashë e të lartë, me gjethe të mëdha, të dhëmbëzuara e me bishta të tultë, e cila përdoret për ushqim. Gjethe raveni. Reçel (marmelatë) raveni.
- RESË** I f. 2. Bimë barishtore e kënetave dhe e liqeneve, që bën fije të gjata, të cilat përdoren për të thurur; kashtë kënete.
- REZHDË** f. * Lule rezhde shih te LUL/E,~JA.
- RËNËS** mb. Që shkëputet nga druri e nga pema, që bie. Gjethe rënëse.
- RICIN** m.
Bimë barishtore ose shkurre e vendeve të ngrohta, me gjethe të mëdha e me bisht të gjatë dhe me lule në trajtë vileje, nga farat e së cilës nxirret një vaj që përdoret në industri ose në mjekësi si bar për të dalë jashtë. Bima e ricinit. Farat e ricinit. Vaj ricini.
- RIGON** m.
Bimë barishtore shumëvjeçare me erë të këndshme, me kërcell të hollë, me gjethe të vogla vezake, me lule të bardha ose ngjyrë trëndafili, që rritet vetvetiu në toka të thata dhe që thahet e përdoret si erëz për gjellë. Rigon i ri (i njomë, i thatë). Gjellë (qofte) me rigon. Çaj rigoni. Raki rigoni. I hedh rigon.
- RIZOMË** f. Kërcell i nëndheshëm e i nyjzuar i disa bimëve, që nxjerr disa gjethe të vogla e rrënjë plotësuese. Rizomat a patates (e gramin, e fierit). Rizomat e pishës. Shumëzimi me rizoma.
- ROZMARINË** f.
Shkurre përherë e gjelbër e vendeve të ngrohta, me lule të vogla ngjyrë qiell ose të bardha, me gjethe të imëta si hala e me erë të këndshme, që përdoren në gjellë ose për të nxjerrë prej tyre një lloj vaji. Rozmarinë e egër. Era e rozmarinës. Vaj rozmarinë.
- RYZË** f.
Bimë mjekësore me fletë që kanë erë të fortë e të rëndë, me lule të verdha të mbledhura në tufa të vogla, nga e cila nxirret një vaj i hidhur; bar shporetke. Lëngu i ryzës.
- RRABOSHTË** f. Fshikakuq, herdhagen.
- RRAP** m. 1. Dru i lartë me trung të trashë, me degë të gjera, me gjethe të mëdha në trajtë pëllëmbë, që bën lëndë të vogla me gjemba të imët përsipër. Rrap i vjetër (i moçëm, i madh). Rrap shekullor. Dru rrap. Gjethe rrap. Pyll rrapesh. Në hije të rrapit. I fortë (i shëndoshë) si rrap. * U bë rrap e rrënjë ka jetuar shumë; ka parë e ka dëgjuar shumë.
- RRAPORE** f. vet. Familje që përfshin pak lloje drurësh, ndër të cilët më i njohuri është rrap, familja e rrapeve.
- RRATHJE** f. Kërpudhë që hahet, me kësulë të verdhë e me vija të bardha rrrathë-rrathë, e cila, kur shtrydhet, nxjerr një lëng të bardhë e pak si të kuq.
- RREPAN** m. Rrepë e bardhë.
- RREPË** f. Bimë barishtore kryqore me lloje të ndryshme zakonisht dyvjeçare, me gjethe si të panxharit, që bën nën tokë një kokërr të rrumbullakët me tul e me bisht të zgjatur, me cipë të bardhë, të errët ose të kuqe; zhardhoku i kësaj bime, që përdoret si ushqim. Rrepë e bardhë. Rrepë e kuqe rrikë. Rrepë e egër. Rrepë

- e zier. Rrepë sheqeri panxharsheqeri. Lëng rrepash. Sallatë me rrepa.
- RREPICË** f. Bimë barishtore, që mbin zakonisht vetë nëpër arat e mbjella me të lashta, që bën lule të verdha e bishtaja të holla me fara të zeza dhe që ka gjethe të gjera, të cilat përdoren për ushqim si lakra.
- RREZAK** mb. Që i ka petlat anësore me lllapë më të shtrirë sesa ato të qendrës (përdoret për lulet e përbëra, si lulja e dhenve etj.).
- RREZORE** f. vet. Familje bimësh barishtore e drurësh të vendeve të nxehta (ku hyn edhe druri i kafesë) me lule zakonisht në trajtë vilesh, që përdoren në mjekësi, për të ngjyer etj.
- RRËFESHK** m. 1. Gjembaç, gjemb gomari. Push rrëfeshku. E ka mbuluar rrëfeshku.
- RRËKUALL** m. Bimë barishtore dyvjeçare me gjethe të mëdha e të dhëmbëzuara, me lule të verdha, që rritet në vende të thata dhe që lulëzon në qershor-shtator.
- RRËNJAK** mb. Që del drejtpërdrejt nga rrënja e jo nga kërcelli. Gjethe rrënjake.
- RRËNJË** I f. 1. Pjesa kryesisht nën dhe e një bime barishtore, e një shkurreje a e një druri, që e mban atë të ngulur dhe që i shërben për të thithur ujin a ushqimin; pjesa e nëndheshme e disa bimëve, që përdoret për ushqim, për të bërë barna a pije ose për të përgatitur sende të ndryshme. Rrënjë e hollë (e trashë, e shkurtër, e thellë). Rrënjë kryesore (nëntokësore, ajrore, mbitokësore, anësore). Rrënjë boshtore (xhufkore, penjëzore). Rrënjë të kalbura. Rrënjë në ujë. Qafa e rrënjës. Qimet (sythat) e rrënjës. Pije (barna) me rrënjë bimësh të egra. Çibuk nga rrënja e shqopës. Lëshon (nxjerr, zë) rrënjë. I pres rrënjët. Shkul rrënjën. I zbuloj (i mbuloj, i mbath) rrënjët. E nxjerr me gjithë rrënjë. Shtoj me rrënjë.
- RRËNJË** II f. Lloj dushku me trup të drejtë e me gjethe si të gështenjës, që bën lende të bashkuara zakonisht tri e nga tri dhe që përdoret për lëndë ndërtimi, për të nxjerrë tanin, për të bërë qymyr të cilësisë së lartë etj. Druri i rrënjës. Lende e rrënjës.
- RRËNJËZ** f. Fije e hollë që del nga degëzimi i rrënjës kryesore; fije e hollë që nxjerr si rrënjë fara kur sapo fillon të mbijë. Rrënjëz e re (fillestare). Rrënjëz e vogël (e imët). Rrënjëzat e bimëve.
- RRËNJJOR** mb. 1. Që ka të bëjë me rrënjën e bimës, i rrënjës. Sistemi rrënjor. Zhvillimi rrënjor.
2. Që ka kërcell të nëndheshëm të trashë e të tultë (si panxhari, karota etj.). Bimë rrënjore. Perime rrënjore. Ushqime rrënjore ushqim për kafshë nga bimët si panxhari, karota etj.
- RRËNJORE** f. vet. Familje bimësh si panxhari, karota, rrepa etj. që kanë rrënjë të trashë e të tultë, e cila përdoret si ushqim për njerëzit e për kafshët, në industrinë ushqimore etj. Rrënjore me vlerë të lartë ushqimore. Ushqehen me rrënjore.
- RRËSHQANOR** mb. 2. Që e ka kërcellin të shtrirë për tokë, që nuk rritet drejt lart; zvarritës. Bimë rrëshqanore.
- RRËSHQITJE** II f. Lloj kërpudhe që hahet, e cila e ka kësulën ngjyrë hiri nga sipër e të bardhë poshtë dhe vjen si e yndyrshme kur preket me dorë. Mbledh (ha) rrëshqitje.
- RRËSHYELL** m. Bimë barishtore helmuese e arave dhe e kullotave, me kërcell të butë, i cili nxjerr një lëng si qumësht, me gjethe të mëdha shumë të çara, të dhëmbëzuara e me gjemba dhe me lule të vogla të verdha. Rrëshyell i ashpër. Lulet e rrëshyellit.
- RRËZË** II f. Bimë barishtore e vendeve të ngrohta, me gjethe të holla që dalin si fije nga kërcelli, me lule të imëta, të verdha e të mbledhura tufë dhe me rrënjë të tultë, e cila thahet, bluhet e përdoret si bojë për të ngjyer në të kuqe të ndezur. Rrënjët e rrëzës. Ngjyesh me rrëzë.

- RRIKË** I f. Rrepë. Rrikë e kuqe. Lëngu i rrikës. * I lë rrikën dikujt ia ngarkoi fajin a gabimin dikujt tjetër, ia hedh fajin tjetrit. Ia bëri (kokën) rrikë e qethi shumë shkurt, ia bëri kokën rrafsh.
- RRILKË** f. shih RRIK/Ë,~A I.
- RRILLË** f.
1. Bimë barishtore me gjethe të imëta e me lule të verdha, që bën kokrra të vogla e të rrumbullakëta dhe që lëshon një lëng helmues. 2. përd. mb. Që e ka kokrrën shumë të vogël, kokërrvogël. Mollë rrilë. Groshë rrilë.
- RRITËS** mb. 2. Që rritet e zhvillohet më tej, që vazhdon të rritet. Organ rritës. Zona (maja) rritëse (e bimës). Syth rritës.
- RRJETËZUAR** mb. spec. Që ka në sipërfaqe vija të ndërthurura e të kryqëzuara si rrjetë. Farë e rrjetëzuar.
- RROBOÇ** m. Mënjollë. Rroboçat e ullirit. Dalin rroboçat. Pres një rroboç.
- RROBULL** m. Dru halor i pyjeve malore, i ngjashëm me pishën e zezë, me trung të trashë, me degë të drejta e me pak gjethe në majë dhe me lëndë të fortë e të eprhme, e cila përdoret për fuçi, për bucela, për ndërtim etj.; pishë mali. Rrobull i kuq. Rrobull i bardhë molikë. Druri i rrobullit. Boçet e rrobullit. Pyll rrobulli.
- RRODHE** f. 1. Bimë barishtore njëvjeçare e livadheve, me kërcell të degëzuar e me lule të bardha, që bën kokrra vezake e me gjemba si grep. Rrodhe e egër. Shkulin (djegin) rrodhet. 2. Kokrra me gjemba e kësaj bime, që u ngjitet bagëtive në trup ose njerëzve në rroba; kokërr me gjemba e çdo bime tjetër. Iu ngjitën rrodhet. Heq (qëroj) rrodhet. Të ngjitet si rrodhe të qepet e nuk të ndahet.
- RRODHËZ** f. Kokrra e rrodhes, rrodhe. Pas-troj leshin nga rrodhëzat.
- RROLBË** f. Bimë barishtore njëvjeçare, që rritet nëpër shkëmbinj gëlqerorë, me gjethe heshtore e me lule si të gjembaçëve, rrënjët e së cilës lëshojnë një bojë të kuqe. Ngjyey me rrolbë.
- RRUAZË** f. * La rruazën diku shih te LË. Si rruaza në pe stisur bukur, lidhur e radhitur bukur. Shtie (fut) rruaza në pe dikush shih te PE,~RI. Zuri rruazën (qafën, zverkun) keq. shih te ZË. Lule rruaze shih te LUL/Ë,~JA.
- RRUNJË** f. Dru a shkurre e pyjeve, me gjethe vezake, të shkëlqyera përsipër a të zbehta poshtë, me lule të blerta të grumbulluara në vile, që bën kokrra të vogla, në fillim me ngjyrë të kuqe e më vonë si gështenjë dhe me shije të athët; qelbës, frashër i egër. Kokrrat e rrunjës. Fshikëzat e rrunjës.
- RRUSH** ARUSHE Gërdec.
- RRUSH** GJARPRI Shkurre e vogël me kërcell të hollë e të drejtë, me gjethe vezake e të trasha, me lule të vogla, të bardha e me pesë cepa, që bën kokrra të zeza, të cilat hahen kur piqen mirë.
- RRUSH** MALI Thrashegër, qershizë.
- RRUSH** PULE Mana toke.
- RRUSH** QENI Vadhëz e egër.
- RRUSH** TOKE Shkurre me degë të holla me gjemba, me gjethe si të hardhisë e me lule të bardheme, që bën kokrra me cipë të gjelbër në të verdhë si të tejdukshme, me pak qime e me shije të athët.
- RRUSH** THËLLËZE Qershie e egër, bar thëllëze.
- RRUSHI** I QYQES Rrushqyqe.
- RRUSHK** m.
1. Fryti i disa bimëve, që ka tul plot lëng dhe farat të shpërndara nëpër të, pemël.
 2. vet. sh. Bimë si rrushi, luleshtrydhja, mjedra, manaferra etj. që bëjnë kokrra të vogla me lëng, pemlat.
- RRUSHKULL** m. Shkurre e viseve mesdhetare, me kërcell shumë të degëzuar e me lëng të hidhur, me gjethe të vogla

si luspa, përherë të blerta e me majë të mprehtë si gjemb, që bën kokrra të kuqe, të cilat piqen në dimër dhe hahen; therpelë. Kokrra rrushkulli. Ha si dhitë në rrushkull ha si i zijosur.

RRUSHKUQE f.

1. Shkurre e vogël e ngjashme me gjineshrën, që ka gjethe të lëkurta, të shkëlqyera, përherë të blerta e me majë, lule të vogla të verdheme dhe që bën kokrra të vogla të kuqe. 2. Lulja e kuqe e lofatës, e mbledhur në vile. Lëshon rrushkuqe. Mbushet me rrushkuqe. I ka fëmijët si rrushkuqe i ka fëmijët të shëndetshëm e me faqe të kuqe.

RRUSHQYQE f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të ulët e të tultë, me gjethe vezake të dhëmbëzuara, me lule të verdha të mbledhura në majë, që bën kokrra të vogla si të rrushit, me ngjyrë në të gjelbër; bar urdhjeje, thonj qete.

RRUSHZEZË f. Thanukël.

RRYELL m.

1. Qumështore. 2. përd. mb. Shumë i hidhur, helm. M'u bë goja rryell. U bë buka rryell.

SABAH m. vjet. * Lule sabahu Lule mëngjesi.

SAHAT m. bised. Lule sahati shih te LUL/E,~JA.

SAKËZ f. Halmucë.

SALEP m. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare me gjethe të gjata, të mbështjella rreth kërcellit, me lule të mbledhura si kalli dhe me zhardhok të nëndheshëm, që përdoret për të përgatitur një pije dhe në mjekësi. Bima e salepit. Zhardhoku i salepit.

SALLATË f. 1. Bimë barishtore njëvjeçare e llojeve të ndryshme, me gjethe të mëdha të gjelbra, që hahen të gjalla me vaj, me uthull e me kripë. Sallatë e njomë. Sallatë marule. Sallatë pambukore (pambukje) sallatë me gjethe shumë të buta. Sallatë lakër lloj sallate e mbledhur kokë si lakër. Gjethe sallate.

SALLATË DETI

Lloj alge me gjethe të blerta e të valëzuara që rritet në det.

SANËZ f. Bimë barishtore shumëvjeçare me lule të mëdha e të verdha në majë të kërcellit, me gjethe të holla e të gjata, rrënja e së cilës ka shije të hidhur e përdoret në mjekësi; bar zemre, agnushe.

SAPUN m. Lule sapuni shih te LUL/E,~JA.

SEFERGJEN m. shih BORZILOK,~U.

SEKULL f. Pazi. Lakror me sekull.

SEKULL m. Bimë barishtore rreth dy metra e lartë, me gjethe të grathëta, me lule që i ngjajnë lulediellit dhe me rrënjë si të patates që përdoren për ushqim.

SELINO f. Bimë barishtore dyvjeçare, e ngjashme me majdanozin, por me gjethe më të mëdha, e cila mbillet në kopshte dhe përdoret si erëz ndër gjellë ose për sallatë. Selino e egër sherp. Gjethe selinoje. Rrënjë selinoje. Supë me selino. Sallatë me selino.

SELVI f. Qiparis. Selvitë e varrezave. Dru selvie. Kodra me selvi. E ka trupin si selvi e ka trupin të hedhur, të drejtë dhe të hijshëm.

SEPAL m. shih NËNPET/ËL, ~LA. Sepalet e luleve. Kupa me katër sepale.

SERDEN m. Lulemëllagë.

SINAP m. Bimë barishtore njëvjeçare me kërcell të gjatë, me gjethe të mëdha trekëndëshe dhe me lule të verdha në majë në trajtë vilesh, që bën fara të vogla, të ndritshme, me shije të athët e djegëse; farat e kësaj bime që përdoren në mjekësi dhe për të përgatitur mustardën. Sinap i bardhë (i zi). Fletë (gjethe) sinapi. Llapa me sinap.

SITKË f. Bimë barishtore shumëvjeçare me rrënjë të trashë zvarritëse, me kërcell të lartë të rumbullakët, me gjethe të ashpra e të forta, që rritet nëpër kënetat dhe që përdoret për të bërë rrogoza ose për mbulesa të lehta. Rrogoz prej sitke.

- SOJË** f. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të drejtë e të gjatë, me lule të vogla të bardha ose në ngjyrë trëndafili, që bën bishtaja, kokrrat e të cilave përdoren për të nxjerrë një lloj vaji ushqimor, për miell etj. Vaj soje. Miell soje. Fara soje. Qumësht soje. Silazh soje e misri.
- SOPOJAK** m. Shkozëbardhë.
- SORGUM** m. Bimë njëvjeçare me kërcell të drejtë e të lartë, me gjethe të gjata e me lule që i përngjajnë misrit, e cila përdoret si ushqim për kafshët, zakonisht e grirë, ndërsa disa lloje përdoren në industri për prodhime të ndryshme; melekuqe. Mb-jellin (korrin) sorgumin. U japin sorgum.
- SPEC** m. 1. Bimë barishtore e butë me kërcell të degëzuar, me gjethe vezake, me lule të vogla të bardha, që bën fryte të fryra me lëkurë mishtake në ngjyrë të gjelbër, të verdhë a të kuqe me fara brenda dhe është një nga perimet me të përhapura; frytet e kësaj bime që përdoren për ushqim; piperkë. Spec i kuq. Spec djegës. Spec gogozhare. Spec të tharë. Spica të mbushur. Spec të pjekur (të skuqur). Spec turshi. Salcë specash.
- SPËRËNGË** f. Shpargull.
- SPINAQ** m. Bimë barishtore e butë njëvjeçare me gjethe të mëdha si trekëndësh i zgjatur, që dalin nga rrëza e kërcellit; gjethet e njoma të kësaj bime që përdoren për lakror e për gjellë të ndryshme. Spinaq dimri. Gjethe spinaqi. Spinaq me oriz. Lakror (supë, mish) me spinaq. Lau (griu) spinaqin.
- SPONTAN** mb.lib. 3. Që mbin e rritet vetiu, pa ndërhyrjen e punës së njeriut; kund. i kultivuar.
- SQETULL** f. 3. Vend i thelluar aty ku nis të ndahet gjethja nga dega ose një degë nga trupi i pemës. Sqetulla e gjethes.
- SQETULLOR** mb. Që është i vendosur në sqetullën e një gjetheje a të një dege. Lulesa sqetullore. Sytha (filiza, lastarë) sqetullorë.
- SQETULLORE** f. Filiz a lastar që del nën sqetull të gjetheve ose të degëve të disa bimëve si hardhia, domatja etj. Heqja (këputja) e sqetulloreve. Pastrimi i sqetulloreve.
- STËRGI** f. Shkurre e vendeve të Evropës Jugore, që rritet deri në dy metra e gjatë, me gjethe në trajtë të këmbës dhe që bën disa kokrra të kuqe.
- STËRKUNGULL** m. 1. Bimë barishtore kacavarëse e helmët, me rrënjë mishtake, me lule si të blerta të mbledhura në tufa, që lulëzon në maj-qershor dhe përdoret në mjekësinë popullore.
- SUMAK** m. shih SHQEM/E, ~JA.
- SUMBULLARE** f. Bimë barishtore kacavarëse me gjethe të ashpra në trajtë zemre, që bën kokrra si boça pishe me fara, të cilat përdoren për t'i dhënë birrës shijen dhe erën e veçantë; kulpër e butë.
- SURVË** f. Vadhëz.
- SUSAK** m. 1. Kungull ujës.
- SUSAM** m. Bimë barishtore e vendeve të ngrohhta, me kërcell të drejtë deri një metër e gjysmë, që mbillet për farat e saj, nga të cilat nxirret një lloj vaji për ushqim. Vaj susami.
- SY** m. Bari i syrit shih te BAR,~I I.
- SYGJARPËR** m. Lloj lulëkuqeje, që rritet në vende të papunuara ose në arat me grurë si bimë e egër e dëmshme.
- SYKA** m. Bimë barishtore e helmët, që rritet në livadhe e pyje, me gjethe të vogla të rrumbullakëta dhe me lule ngjyrë trëndafili a vjollce në trajtë ylli.
- SYTH** m. 1. Bulë në majë a në anë të degës së drurit, nga e cila shpërthejnë gjethet dhe rriten bisqe të reja; mugull. Sytha anësorë. Syth i fjetur syth që nuk zhvillohet. Shartojnë me sytha. Nxjerrin sytha pemët në pranverë.
- SHAFRAN** m. 1. Bimë barishtore e vendeve të ngrohhta, me zhardhok si të qepës, me

gjethe të ngushta e të gjata rreth dy pëlëmbë dhe me lule ngjyrëvjollcë e si hinkë, nga krezat e të cilave nxirret një lëndë e verdhë me erë të mirë e me shije të hidhur; lënda që nxirret nga lulet e kësaj bime dhe që përdoret në gjellëtari e në industrinë ushqimore, në parfumeri, në mjekësi, për ngjyrosje etj. Lule shafrani. Ngjyrë shafrani. Vaj shafrani. Erë shafrani. I verdhë si shafran. Sikur ka ngrënë shafran.

SHALQI m.

Bimë njëvjeçare me kërcell të gjatë e të shtrirë përtokë, me gjethe si pëlëmbë, që bën kokrra të mëdha, të rrumbullakëta ose vezake; kokrra e kësaj bime me lëkurë të trashë, të gjelbër ose laramane, e me tul të kuq, të lëngshëm e të ëmbël, i cili hahet. Shalqi farëvogël (farëmadh). Shalqi laraman. Shalqi vendi. Zemra e shalqirit. Thelë shalqiri. Fara shalqiri.

SHARK I m. 2. Tuli që mbështjell bërthamën ose farat e disa pemëve si pjeshka, kumbulla, rrushi, portokalli etj. Sharku i pjeshkës (i qershisë, i ullirit, i thanës). Pemë me shark të ëmbël.

SHARRË f. * I ha sharra shih te HA. I ka prerë një sharrë janë të tërë njësoj. E sharroftë sharra! mallk. vdektë!, u shkretoftë! I vuri sharrën diçkaje e prishi diçka krejt, e shkatërroi. Është bërë për ta çarë me sharrë shak. është shëndoshur shumë. S'e kapte as sharra, as lima ishte shumë i varfër, ishte krejt i këputur. I zuri (i ndeshi, i hasi, i ra) sharra në gozhdë i doli përpara një vështirësi e pakapërcyeshme dhe e paparashikuar. I ngeci (i ngeli) sharra në gozhdë ngeci në vend nga një pengesë e pakapërcyeshme, nuk shkon dot më tej. Sharra që pret, shkëlqen edhe vetë fj.u. ai që mëson e ndihmon të tjerët, mëson e përfiton edhe vetë prej tyre. Lule sharrë shih te LUL/E,~JA.

SHAVAR m.

1. Bimë shumëvjeçare deri tre metra e lartë, me kërcell të drejtë pa nyja, me gjethe të gjata e të ngushta dhe me lule

të mbledhura si kalli, që rritet në kënetat e buzë ujërash dhe që përdoret për të mbuluar kasollet, për të bërë rrogoza etj.; shurdhac. Shavari i kënetës. Rrogoz shavari. Tufa shavari. Korr shavar. Kasolle e mbuluar me shavar.

SHEBOJË f. Bimë barishtore zbukuruese me kërcell të degëzuar, me gjethe të ngushta e të gjata dhe me lule tufa-tufa me ngjyrë të verdhë, të kuqërremtë a në kafe, që e ka erën si të vjollcës, menekshe. Lulet e shebojës. I ka faqet si shebojë.

SHEFTELI f. Një lloj pjeshke, që i bën kokrrat të vogla; kokrra e kësaj peme. Shefteli çahje (mishje).

SHEGË f. Dru mesdhetar, zakonisht si shkurre deri në pesë-gjashtë metra e lartë, me degë me gjemba, me gjethe vezake, me lule të kuqe si gjak, që bën kokrra të rrumbullakëta e të mëdha, me lëkurë të trashë dhe brenda me shumë fara të kuqe, me lëng, të ëmbla a majhoshe; kokrra e këtij druri me farat, të cilat hahen kur piqen. Shegë e kuqe. Shegë e ëmbël (e thartë). Shegë e egër. Shegë devedishe. Lule shege. Lëng shege. Ngjyrë shege. Bulë shege (kaposhe shege) një pjesë e kokrrës së shegës, që i ka farat të mbledhura në një vend. I kuq si shegë. Ngjyjej me lëkura shege.

SHEGORE f. Familje drurësh e shkurresh si shega etj., me gjethe të përkundërta, me lule të kuqe, që lidhin një fryt të rrumbullakët me lëkurë të trashë e me shumë fara brenda.

SHELGI m. Dru ose shkurre me degë të holla e të lakueshme dhe me gjethe gjatoshë, të ngushta a vezake, që rritet zakonisht në vende me lagështi. Shelgu i bardhë. Shelgu i kuq (shelgu industrial) shëlgjishtër. Shelgu i zi. Shelgu i egër lloj shelgu që rritet si shkurre e ulët, me gjethe pushatake e me lule të verdha. Shelgu i butë. Shelg lotues (vajtues) lloj shelgu me degë shumë të ephme e të gjata që varen poshtë. Thupër shelgu.

SHELGORE f. vet. Familje drurësh e shkurresh, ku bëjnë pjesë llojet e ndryshme të shelgjeve e të plepave.

SHELGISHTË f. 2. Shelgjishtër.

SHELGISHTËR f. Një lloj shelgu me degë në ngjyrë të kuqe të errët, shumë të buta e të lakueshme, që përdoren për të bërë shporta, karrige, tryeza e prodhime të tjera xunkthëtarie; shelg i kuq. Thupra shelgjishtre.

SHEQER m. Kallam sheqeri shih te **KALLAM**, ~I.

SHERBELË f. Shkurre e vogël e viseve të ngrohta bregdetare, përherë e gjelbër, me gjethe vezake ose heshtake, të mbuluara me push ngjyrë hiri e me një erë të veçantë, e cila përdoret në mjekësinë popullore, në industrinë farmaceutike etj. Lulet (gjethet) e sherbelës. Lëngu i sherbelës. Era e sherbelës. Grumbullimi i sherbelës. Tharja e sherbelës.

SHERE f. Gjembaç, gjemb gomari.

SHERMASHEK m. Urth. Degë (kurorë) shermasheku. Mur (dru) i veshur me shermashek.

SHERP m. Bimë barishtore që përdoret në gjellë të ndryshme për shije ose hahet si sallatë; selino e egër.

SHIGJETAK mb. I gjatë dhe i hollë si shigjetë, që i përngjan shigjetës. Gjethe shigjetake.

SHIMSHIR m. Bush. Lugë shimshiri.

SHITË f. 2. veter. Shkepëz. Bar shite. Lloj bari që përdoret për mjekimin e shkepëzës.

SHKARPË III f. krahin. Xinë.

SHKELLËZ f. Shkozëzezë.

SHKËLNJET m. krahin. Krifshë.

SHKOPKUQE f. Mëllagiër, shtopje.

SHKOZË f. Dru pylli ose shkurre, me degë të holla e me gjethe vezake, që përdoret për të djegur, në industri etj. Shkozë

e bardhë shkozëbardhë. Shkozë e zezë shkozëzezë. Shkozë e keqe shkozëzezë. Pyll shkozë. Dru shkozë. Gjethe shkozë. U preu dhive ca shkozë.

SHKOZËBARDHË f. Shkozë me trung të trashë, me gjethe vezake të dhëmbëzuara, me lëkurë ngjyrë hiri, të hollë e të lëmuar, që rritet si dru pylli dhe që përdoret në industri ose për të djegur e për qymyr.

SHKOZËZEZË f. Shkozë me degë të holla të mbuluara me push, me gjethe vezake, të vogla e të dhëmbëzuara, që rritet si shkurre a si dru i vogël deri në tetë metra dhe që përdoret për të djegur, si ushqim për dhitë etj.

SHKUMËZ f. Bimë barishtore shumëvjeçare, e lartë afër një metër, me kërcell të drejtë, me gjethe vezake e me lule ngjyrë trëndafili ose të bardha, rrënjët e së cilës përmbajnë një lëndë që shkumëzon si sapuni.

SHKURRAK mb. Që është si shkurre, që rritet si shkurre. Bimë (bimësi) shkurrake.

SHKURRE f.

1. Bimë me kërcell të drunjtë, pa trung, që degëzohet që në rrënjë dhe që nuk rritet shumë e lartë. Vend me shkurre. Kodra të veshura me shkurre. Rritet si shkurre. Fshihet (e bën folenë) nëpër shkurre. 2. përmb. Pyll i imët, imshhtë; shkorret.

SHOGËT mb. 2. Pa push, pa qime (për bimët). Gjethe të shogëta. Kërcell i shogët.

SHOJZË II f. Fryti i thatë i disa drurëve, i pajisur me një flatër vemesore, që e lejon të përhapet duke fluturuar në ajër. Shojzë frashri (vidhi, panje).

SHOQËRIM m. 3. Tërësia e bimëve të llojeve të ndryshme që rriten së bashku në një vend. Shoqërim bimor.

SHOSHË II f. Një lloj gjembaçi, që rritet në vende të thata e nëpër rripa, me lule të përbëra e me kërcell të ëmbël, i cili hahet pasi të qërohet.

- SHPARDH** m. Lloj lisi me gjethe të gjera e të prera thellë, që rritet deri në dyzet metra i lartë e përdoret për lëndë ndërtimi. Pyll shpardhi. Lëndë shpardhi. Dërrasa shpardhi.
- SHPARG** m. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare, rreth një metër e lartë, me fije të imëta e të vogla, me lule të gjelbra në të verdhemë dhe me bitme të tulta e me shije të ëmbël, që hahen sa janë të njoma. Shparg i zier. 2. Brengë thiu, bar miu. 3. Bimë zbukurimi me fije të imëta, të vogla e të dendura, që formojnë një kurorë të gjelbër e të bukur.
- SHPARGULL** m. shih SHPARG, ~U 1.
- SHPARTË** f. Gjineshtër.
- SHPARR** m. Shpardh.
- SHPATË** f. Lule shpatë lulshpatë, shpatore.
- SHPATËZ** II f. 1. Bimë barishtore zbukuruese me gjethe të gjata, të ngushta e me majë si shpatë, me kërcell të lartë, e cila nxjerr një vile lulësh të mëdha, zakonisht të bardha, të purpurta ose të trëndafilta. Shpatëz e bardhë (e kuqe).
2. Shpatore, lulshpatë. Lule (ngjyrë) shpatëze.
- SHPATORE** II f.
1. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe si shpatë, me rizomë zvarritëse dhe me lule të mëdha ngjyrëvjollcë në të kaltër, që rritet deri në një metër; lulshpatë. Lulja e shpatores. Rrënjët e shpatores. Kanë çelur shpatoret.
- SHPATULL** f. 8. Bisk që del në rrëzë të trungut të një peme ose degë që shqitet nga pema për t'u mbjellë. Shpatull ulliri (fiku, ftoi). Shtohet me shpatulla.
- SHPENDËR** f.
1. Bimë barishtore shumëvjeçare e ngjashme me shtogun, që rritet në djerrina dhe nëpër ledhe e gërmadha, me kërcell pak të degëzuar, me gjethe të përbëra prej shumë fletëzash, me lule të bardha si tufë, të cilat bëjnë disa kokrriza të zeza që përdoren nganjëherë për të ngjyer. Lulet e shpendrës. U fut nëpër shpendra. E kanë mbuluar shpendrat.
- SHPENË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me zhardhok të helmët, me gjethe të gjata e të ngushta dhe me lule të bardha e të vogla si zile, që del në fillim të pranverës. Kanë dalë shpenet.
- SHPËRGËTI** II f. Liken. Pastroj drurët nga shpërgëtitë.
- SHPOR** II m. 2. Zgjatim si gyp i kupës a i kurorëzës së lules, ku mblihet nektari.
- SHPORIZ** m. Bimë barishtore shumëvjeçare me gjethe të ngjashme me ato të hithrës, po ma të vogla, me lule të imëta ngjyrë jargavani të çelur, që rritet në toka të papunuara dhe shtohet shumë; lulemine. U shtua si shporizi. U bë shporiz u shtua e u përhap shumë (për bimët etj.).
- SHPROHË** f. Helmarinë.
- SHQEME** f.
Shkurre e vendeve të ngrohta, e lartë deri në dy-tre metra, me lule të vogla e të bardha dhe me gjethe vezake, të dhëmbëzuara e të veshura me push të imët; lënda që nxirret nga gjethet e nga lëkura e kësaj bime dhe që përdoret për të regjur lëkurët. Grumbullimi i shqemes. Ekstrakti i shqemes.
- SHQEMËZ** f. shih SHQEME, ~JA.
- SHQEMORE** f. vet. Familje drurësh e shkurresh të vendeve të ngrohta (si shqemja, bafra, xina, cërmëdelli etj.). me gjethe të përkundërta, që te disa lloje bien e te disa lloje qëndrojnë gjithë vitin.
- SHQERRË** f. * Lule shqerre luledele.
- SHQIND** m. Xinë, liqe.
- SHQIPONJË** f. 3. Bimë shumëvjeçare zbukurimi, përherë e gjelbër, me gjethe të mëdha e të prera thellë, që u përngajnë krahëve të shqiponjës, lulëshqiponjë.
- SHQIRRË** f. Plish. Mure me shqirre. Hasra prej shqirre.

- SHQOPË** f. 1. Shkurre përherë e blertë, që rritet në djerrina të thata e në gurishta, me gjethe të vogla si hala e me lule si vile, degët e së cilës përdoren për fshesa dhe rrënjët për të bërë çibukë, kërraba e sende të tjera; mreçë. Pyll shqope. Qymyr shqope. Fshesë shqope. Lullë (çibuk, lugë) shqope.
- SHQOPORE** f. vet. Familje drurësh të vegjël e shkurresh, me gjethe rënese ose të qëndrueshme, zakonisht të këmbyera, ku bëjnë pjesë shqopa, marja, gërdeci, thrashegra etj.
- SHTALBËS** m. Bimë kacavarëse, me kërcell të gjatë që përdridhet nëpër drurë e gardhe, me gjethe vezake, me lule të vogla të kuqe në të murrme, që rritet zakonisht buzë ujërash dhe që e hanë bagëtia e trashë e kuajt.
- SHTARCË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare e viseve malore, me gjethe vezake të mëdha, që përdoren për të ngjyer.
- SHTARË** f. 1. Bimë barishtore e helmët e viseve malore, me kërcell të drejtë deri në një metër e gjysmë të lartë, me gjethe vezake e të gjera dhe me lule zakonisht të verdha në të gjelbër, nga rrënjët e së cilës nxirret një lëndë me veti mjekuese. Rrënjët e shtarës.
- SHTËRMEN** m. Trumzë. Era e shtërmenit.
- SHTIJË** f. 3. Bisht i zhveshur që del nga kërcelli nëntokësor dhe që mban një ose më shumë lule, kërcell i zhveshur.
- SHTOG** m. * Shtog i egër shih SHTOG/ËR, ~RA 1.
- SHTOGËR** f. 1. Shkurre ose dru i vogël, me gjethe vezake, me majë e të dhëmbëzuara imët, me lule të bardha pak në të kuqe, që rritet zakonisht në pyje; shtog i egër.
- SHTOPJE** f. Mëllagjër, shkopkuqe.
- SHTRAPËR** m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell të ngritur përpjetë ose të përkulur, me gjethe rrënjake të shtrira përtokë e me lule të vogla e të bardha, që hahet e zier e përdoret edhe për të ndaluar gjakun.
- SHTRAT** m. 10. Pjesa e sipërme e bishtit të lules, që është më e gjerë e që mban lulen. Shtrati i lules.
- SHTRYDHËZ** f. Luleshtyrdhe, dredhëz.
- SHTYLLËZ** f. 1. Pjesë e pistilit, si qafë e hollë, që del nga vezorja dhe që mban në majë krezën. Shtyllëza e lules. Lule me shtyllëza të gjata (të shkurtra).
- SHUKULL** m. Djegës.
- SHUMËFISH** mb. 1. Që përbëhet prej shumë njësisish, pjesësh, elementesh etj. Emërtime shumëfishë. Formë shumëfishë. Fryt shumëfish.
- SHUMËVJEÇAR** mb. 3. Që jeton dy a më shumë vjet (për bimët). Bimë (lule) shumëvjeçare.
- SHURDHAC** m. Një lloj shavari me gjethe pak më të gjera.
- SHURDHI** f. Lloj dushku që i përngjet bujgrit, me gjethe të dhëmbëzuara, me degë të murrme e me push dhe me lëkurë të trashë e të plasaritur, prej së cilës nxirret një lloj tape.
- SHURRËPELË** f. Arrç. Shurrëpelë e madhe. Shurrëpelën e hanë delet.
- SHYT** mb. 3. Që nuk është me majë, që vjen si rumbullak, që nuk e ka majën të mprehtë. Qylaf shyt. Gjethe shytë. gjethe me majë të rumbullakët. Kazmë shytë kazmë pa kep.
- TAÇE** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me gjethe gjatoshe të dhëmbëzuara e gjithnjë të blerta, me lule të mëdha në të gjelbër e me erë të mirë që çelin në dimër, e cila rritet në vende me shkurre ose në kullota dhe përdoret në mjekësinë popullore.
- TAKËR** f. Bimë barishtore nga familja e mëllagoreve, me fletë pak të trasha e pushatake, të cilat, së bashku me rrënjët, përdoren në mjekësi; mëllagë uji.

- TALLË** f. 3. Bimë barishtore e dëmshme, e gjatë rreth një pash, me rrënjë të trasha e të helmëta, e ngjashme me misrin, por me gjethe të holla e me një xhufkë plot fara si të melekuqes në krye; vulër. U helmuan nga talla. Shkulin (heqin) tallen.
- TAMBËL** m. krahin. * Bar tambli qumështore. Lule tambli qumështore, bar tambli.
- TAMBLAGJAK** m. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell shumë të gjatë, me rrënjët plot me një lëng si qumësht, shumë të hidhur e të verdhë, me gjethe në ngjyrë deti nga ana e poshtme dhe me lule të verdha, që përdoret në mjekësi; bar jodi, gjak qumështi.
- TAMBLATORE** II f. krahin. Qumështore.
- TAPË** f. Dru tape. dru, nga i cili nxirret kjo lëndë. Lisi i tapës.
- TATAREQ** m. Herdhaqen, fshikakuq. TATË f. sh. bised.
- TATULL** f. 1. Bimë barishtore e helmët, e lartë deri një metër e gjysmë, me lule si zile, me frytin me gjemba të dendur dhe me gjethe vezake e të dhëmbëzuara, të cilat përdoren për mjekimin e astmës, të plagëve etj. Vaj tatulle lëng si vaj që nxirret nga gjethet e kësaj bime dhe që përdoret në mjekësi. Piu tatull.
- TELISH** II m. Bimë shumëvjeçare, me kërcëj të dendur, me rrënjë të holla e me shumë gjethe në fund, që rritet në kullota e në livadhe dimërore, lulëzon nga maji në korrik dhe shërben si ushqim për bagëtinë.
- TËRFIL** m.
Bimë barishtore me kërcell të drejtë e të hollë, me degëza të vogla që kanë në krye tri gjethe së bashku në trajtë zemre, me lule të vogla në ngjyrë të kuqe, të trëndafilte, të verdhë a të bardhë, që lulëzon në muajt qershor-korrik dhe që mbillet e përdoret si ushqim me vlerë për bagëtinë ose për të pasuruar tokën. Tërfil i kuq (i bardhë, i verdhë). Tërfil i egër. Tërfile i livadheve (i fushave). Gjethet e tërfilit. Mbjellin tërfil. Korr tërfilin.
- TËRSHËRË** f. * S'di sa (ku) shkon tërshëra është rrëmujë e madhe, nuk e merr vesh i pari të dytin, s'e merr vesh qeni të zotin. Tërshërë e egër bar i keq njëvjeçar i ngjashëm me tërshërën, që dëmton rëndë të lashtat. Tërshërë e zbehtë bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të hollë deri një metër të lartë, me zhardhok të shkurtër, me gjethe të gjera e me lule të mbledhura si fshesë, që bën disa kallinj të vegjël.
- TIS** II m. Bërshen.
- TJEGULLORE** f. Lloj fieri me fletë të gjata dhëmbë-dhëmbë që mbin nëpër shkëmbinj e nëpër mure. Ishte mbushur muri me tjegullore.
- TOKË** I f. vet. nj. Qershi toke shih te QER-SHI, ~A. Rrush toke (frëngu) shih te RRUSH, ~I.
- TRASHJE** f. * Kërpudhë trashje lloj kërpudhe në ngjyrë të bardhë, me shumë mish, që halet.
- TREFLETËSH** mb. 3. si em. ~, ~I m. Tërfil.
- TRËNDAFIL** m. 1. Shkurre zbukuruese deri në dy metra e lartë, me gjemba të gjatë, me lule të mëdha fletë-fletë, të bukura, të mbledhura, me erë të këndshme e në ngjyrë të bardhë, të kuqe, të verdhë etj.; lulja e kësaj shkurreje. Trëndafil i kuq (i bardhë, i verdhë). Trëndafil me erë. Gonxhe trëndafili. Tufë trëndafilash. Erë trëndafili. Ujë trëndafili. Shurup (reçel) trëndafilash. Vaj trëndafili. Kopsht (oborr) me trëndafila.
* Trëndafil breshke balkrocë. Trëndafil i egër shkurre e egër deri në tre metra e degëzuar dhe me gjemba të fortë, me lule në ngjyrë të bardhë me pesë petla e me erë të mirë, që bën kokrra të kuqe me shumë fara brenda; kaçë.
- TRËNDAFILORE** f. vet. Familje bimësh, në të cilën hyjnë trëndafilat, ferrat, murrizi etj.
- TRIDHËBOTË** f. Lloj zambaku, me gjethe të gjata e si gyp, me lule me gjashtë-shtatë

- petla të përveshura e në ngjyrë jargavani, që varen poshtë.
- TRIKË** f. 1. Bimë barishtore njëvjeçare e helmët, me gjethe të holla, me lule tufatufa, të vogla, të kuqe e si hinkë, që mbin nëpër livadhe e që përdoret në mjekësi; bar ethesh.
- TRISHULL** m. Shkurre pyjesh shumë e lartë, me lëvore të lëmuar, me gjethe të përbëra prej pesë ose shtatë fletëzash të përkundërta, në trajtë vezake e të dhëmbëzuara, me lule të bardha pak si në të kuqe të grumbulluara në vile, që bën kokrra të vogla si qiçra; shtog i egër. Gjethe (lule) trishulli.
- TRUMZË** f. Shkurre shumëvjeçare me kërcej të vegjël, të fortë e me shumë degë, me gjethe të ngushta, në ngjyrë hiri si në të gjelbër dhe me erë të këndshme; me lule të bardha, që bën kokrra të vogla vezake e që përdoret shumë për përgatitjen e lëndëve të merme. Trumzë e butë, livandë.
- TUFËKUQE** f. Bimë që i ka lulet si tufa të kuqe.
- TUFK** m. Pluhuri i lules, endi.
- TUNIKË** f. Vemesë.
- THANË** f.
1. Bimë që rritet e lartë a si shkurre, me dru të fortë, me gjethe të vogla vezake e të ashpra, që lulëzon herët në pranverë dhe bën kokrra të kuqe, gjatoshë si ulli me shije të athët; kokrrat e kësaj bime. Thanë e butë (e ëmbël). Dru (shkop) thane. I fortë si thana (si dru thane). I kuq si thana me shëndet shumë të mirë. Lëng (shurup) thanash. Si fletë thane i ashpër. Thanë e egër thanukël. Thanë ujku thanukël.
- THANËKEQE** f. Thanukël.
- THANËKUQE** f. Thanë.
- THANËQERE** f. Thanukël.
- THANUKËL** f. Dru a shkurre që i ngjan thanës, me gjethe vezake, të lëmuara nga sipër dhe me push poshtë, që bën kokrra të zeza e të hidhura si të shtogut, të cilat nuk hahen; thanë e egër.
- THARTORE** I f. Lëpjetë mali, uthullaç; uthullishte, uthullnike, lëpjetë lepuri.
- THARTUSHË** f. 2. Një lloj nejtçe, që i ka fletët të ngjashme me ato të lëpjetës së kalit.
- THEK** II m. kryes. Pjesa e lules së disa bimëve, që përmban endin. Thekët e misrit. Theket e zambakut.
- THEKË** f. kryes. 2. shih THEK, ~U II.
- THEKËR** f. * E futi në thekër dikë e futi në ngatërresa, e futi në të thella, e ngatëroi. Ra në thekër e humbi toruan, u shushat. Ra si pula (si gjeli) në thekër ra në bollëk ushqimesh, ra në të ngrëna të bollshme. Kapardiset (krekoset) si maçoku në thekër shih te MAÇOK, ~U. Mbeti (ra) si ujku (si zagari) në thekër shih tek UJK, ~U I. Mbolli thekër e i doli grurë diku shih te MBJELL. Kur s'ke grurë, e mirë është edhe thekra fj.u. njeriu bën si të ketë, kënaqet me atë që ka; kur s'ke pulën, ha edhe sorrën. Thekra është e gjatë, po gruri hahet fj. u. vlen puna, jo pamja, mos i shih gunën, po punën. Hamë bukën tonë e rrahim thekrën (bëjmë davanë e botës) shih te BUK/Ë, ~A. Bri thekre shih te BRI, ~RI.
- THELB** m. 3. Fletët e para që mbështjellin embrionin brenda farës së bimëve, të cilat çelin lule, e lidhin fryte.
- THELBOR** mb. 3. Që ka fletë, të cilat mbështjellin embrionin brenda farës (për bimët që çelin lule e lidhin fryte).
- THERIBUJKË** f. Ferrënuse
- THERIMI** m. Rrushkull.
- THERPELË** f. Rrushkull.
- THËLLËZË** f. zool. Rrush thëllëze shih te RRUSH, ~I.

- THËRROKE** f. vet. Familje bimësh që rriten si shkurre si gjysmëshkurre, si drurë të vegjël a si barëra pothuaj në të gjithë botën, e sidomos në vendet e ngrohta (si xerxelet etj.) dhe që përmbajnë në lëngun e lëvares lëndë helmuese, e cila përdoret zakonisht në mjekësi. Familja e thërrokeve.
- THËRROKORE** f. Shkurre e ulët helmuese, me shumë degë, me lëkurë të murrme, me gjethe vezake të qëndrueshme, me lule të bardha e me erë të këndshme, që çel në maj dhe bën kokrra të kuqe e me lëng; xerxele, bar thëllëze.
- THI** m. * Brengë thiu shih te BRENG/Ë, ~ A II.
- THITHAK** m. 1. Filiza, lastarë a degë shumë të holla anësore, që dalin në sytha të pemëve ose në nyje të bimëve dhe që rriten duke thithur ushqimin nga pemët a nga bimët ku mbijnë. Thithak parazitare. Kanë dalë thithakë. Lëshon thithakë. Presin (pastrojnë, heqin) thithakët.
- THITHËS** m. 2. Thithak.
- THJERRË** f. 1. Thjerrëz.
- THJERRËZ** f. 1. Bimë bishtajore njëvjeçare, me lule të vogla e të bardheme dhe me bishtajë të shkurtër; kokrrat e kësaj bime, të vogla, e të shtypura me dy faqe të mysëta dhe me buzë të holla, që përdoren për ushqim. Thjerrëza të mëdha (të vogla, të kuqe).
- THOI** m. Lule thoi shih te LUL/E, ~JA. Thua pule shih THUAPUL/Ë, ~A.
- THONJËZ** f. sh 1. Bimë me kërcell të veshura plot me gjethe në trajtë gjembash si thonjtë e maces; që qel lule të vogla në ngjyrë portokalli; thonj maceje; lulja e kësaj bime. 2. Pjesa e poshtme e petlës së lules, që vjen më e ngushtë se pjesa e sipërme.
- THONJËZAK** Që ka trajtën e thoit, që është si thua. Petla thonjzake.
- THRASHGËR** f. Qershizë, qershigël, qershi toke, rrush mali. Lëng thrashegre.
- THRUMBE** f. Shkurre e vogël e vendeve të thata mesdhetare, përherë e gjelbër, me erë të këndshme, me lule në ngjyrë trëndafili në të bardhë e si kalli, që çelin nga maji deri në gusht. Erë thrumbe. Lule thrumbesh.
- THRUMBISHTË** f. Thrumbe.
- THUAPULË** f. Bimë shumë vjeçare e kulotave; me rrënjë, boshtore, me kërcëj të shpeshtë e të lartë, me gjethe pesë e nga pesë në çdo degë dhe me lule në ngjyrë të verdhë në të kuqërremtë.
- THUNDËR** f. * Ra në thundër u pengua e gati sa s'ra, u pengua keq (për, kalin etj.). I ktheu thundrat (potkonjtë, këpucët, këmbët) nga dielli për b. shih te DIELL, ~I. I vajti thundra në qafë shih te QAF/Ë, ~A. Thundër mushke thundërmushkë.
- THUNDËRMUSHKË** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, më kërcell të mbuluar me push të hollë, me gjethe të dhëmbëzuara, të ngjashme me gjurmën që lë thundra e mushkës, me lule të verdha, të mbledhura në majë të kërcellit, e cila rritet në vende me lagështi dhe përdoret në mjekësi.
- THUNDËRZ** f. Thundër mushkë.
- UJË** m. Mëllagë uji Takër.
- UJËS** mb. * Kungull ujës kungullujës.
- UJK** I m. Thanë ujku shih te THAN/Ë, ~A.
- UJTH** I m. 2. Lëng që qarkullon në trupin e bimëve dhe që ndryshon sipas stinëve, limfë. Ujthi i pemëve.
- ULPËTI** m. Hithës.
- ULZË** f. Dru i vogël ose shkurre nga gjinia e panjave, me degë të murrme në të kuqe, me gjethe vezake e të dhëmbëzuara, me lule të bardha në të blertë, që lidh fara me një cipë të hollë si krah.
- ULLASTËR** f. Ulli i egër, me degë të gjembta, që lidh kokrra shumë të vogla, të rrumbullakëta, të zeza dhe pa shije. Dru ullastrë. Shartojnë ullastrat.

ULLI m.

1. Dru frutor i vendeve të ngrohta, gjithmonë i blertë, me gjethe gjatoshë, që bën kokrra të vogla me shumë vaj; kokrra e këtij druri, që përdoret për të nxjerrë vaj ose për të ngrënë. Ulli i butë. Ulli i egër ullastër. Ulli i zi (i bardhë). Ulli kokërrmadh (kokërrvogël). Ulli gjatosh (i rumbullakët). Ulli vajës. Ulli kripës. Ullinj të kripur (të regjur). Ullinj të çarë (të shtypur). Ullinj stafidhe. Ullinj pa bërthamë. Ullinj vaji. Ullinj për të ngrënë (tryezë). Ullinj Berati (Vlore...). Dru ulliri. Kokërr ulliri. Vaj ulliri. Bërthamë ulliri. Bërsi ullinjsh. Bojë (ngjyrë) ulliri. Sallatë me ullinj. Miza (breshkëza...) e ullirit. zool. Mbledhin (shkundin) ullinjtë. Krip (regj) ullinjtë. Çaj (shtyp) ullinjtë.

ULLINJORE f. vet. Familje drurësh që bëjnë kokrra me vaj, në të cilën futen ulliri, ullastra etj. Familja e ullinjoreve.

URDHJE f. mjek. * Bar urdhjeje rrushqyqe.

URENJË f. Bërshen.

URITHE f. Shkurre e vogël me gjeth të ashpra e me qime, që e kanë bishtin me gjemba; me lule të verdha ose të bardha në trajtë vileje.

UROV m.

Bimë barishtore njëvjeçare, e ngjashme me grashinën, me kërcell të shkurtër e me qime, me gjethe tek, me lule të kaltra, që bën bishtaja me fara të rumbullakëta dhe përdoret si ushqim për kafshët. Kokrra urovi. Bishtaja urovi. Mb-jell (korr) urov. Kullot në urov. E ushqen me urov.

URTYTË f. Dredhëz, luleshtrydhe.

URTH I m. Shkurre kacavarëse, më kërcell të bardhë në të verdhë, me gjethe gjithmonë të gjelbra e me bisht të gjatë me lule të vogla, të verdha në të blertë, që bën kokrra të vogla sa një qiçer dhe që rritet si bimë zbukuruese. E mbuloi urthi. Ngjitet si urth.

URTHORE f. vet. Familje bimësh barishtore ose shkurresh, në të cilën hyjnë urthi e disa bimë të tjera.

URRË f. Pjesë e drurit që vjen fill pas myjës ose zemrës së drurit dhe shkon gjer te barma, blanë. Urra e drurit. Urra e pishës. E ka urrën të shëndoshë. Iu kalb urra.

USHEJZË f. Bimë dyvjeçare me gjethe të dhëmbëzuara e plot me gjemba therës në majë, me lule në ngjyrë të verdhë, që rritet në vende të thata dhe dëmton kullotat dimërore.

USHINTH m. Shkurre e vogël me gjemba, me gjethe përherë të gjelbra, vezake e me majë me lule të bardha si tufë me kokrra të vogla në ngjyrë të kuqe e të shndritshme, që rritet në vende malore e në pyje ose si bimë zbukuruese; murriz i kuq, farëkuqe. Dru ushinthi. Kokrrat e ushinthit.

USHQERË f. Bimë barishtore dyvjeçare e kullotave, me gjethe të gjera, të trasha e me push, që përdoren në mjekësinë popullore për të shëruar plagët dhe me lule të kaltra ose në ngjyrë vjollce, që përdoren për të ngjyer.

UTHULLAÇ m. shih UTHULLISHT/E,~JA.

UTHULLARE f. shih UTHULLISHT/E,~JA.

UTHULLICË f. shih UTHULLISHIT/E, ~JA.

UTHULLIMË f. shih UTHULLISHT/E,~JA.

UTHULLIRË f. 2. ~A, ~AT Uthullishte.

UTHULLISHTË f. Bimë barishtore, që mbin në vende të lëna djerr dhe që i ka gjethe gjatoshë si të lëpjetës, por më të vogla e mjaft të tharta; lëpjetë lepuri. Uthullishte mali. Lakror me uthullishte.

UTHULLNIKE f. shih UTHULLISHT/E,~JA.

VADHË f. Dru i lartë deri njëzet metra, me lëvore të fortë e të ashpër, me gjethe të gjata, të dhëmbëzuara e me push nga poshtë, që bën lule të bardha dhe kokrra të vogla me ngjyrë të verdheme e me shije të athët; kokrrat e këtij druri, që

- përdoren për të ngrënë, për të bërë raki etj.; vadhëz. Vadhë e egër. Vadhë e butë. Vadhë të thara. Çeli vadhë.
- VADHËVIÇE** f. Lloj vadhe me gjethe në trajtë pëllëmbë, që rritet ngadalë dhe bën lule të bardha e kokrra shumë të vogla. Vadhëviçe e bardhë ftua i egër. Vadhëviçja e Alpeve. Druri i vadhëviçes.
- VAJTUESE** mb. § Shelg vajtues (lotues) shih te SHELG, ~U 1.
- VALANIDH** m. Lloj dushku i viseve mesdhetare, me trung të trashë e të lartë, me lëkurë ngjyrë hiri e të plasaritur, me gjethe vezake, dhe që bën lëndë të mëdha e me kapuç të gjerë, të cilat përmbajnë tanin e përdoren për të regjur lëkurët. Valanidh i butë (i egër). Lëndë (dru) valanidhi. Pyll me valanidhe.
- VALERIANË** f. 1. Bimë barishtore shumëvjeçare me kërcell të drejtë, me gjethe të zgjatura e të dhëmbëzuara, me lule të bardha ose të trëndafilta në trajtë tufe, që rritet në livadhe, në pyje etj. dhe që ka një rizomë të shkurtër me rrënjë të holla e të degëzuara, e cila përdoret në mjekësi. Rrënjët e valerianës.
- VANILJE** f. 1. Bimë barishtore kacavarëse e vendeve tropikale, që bën fryte në trajtë bishtaje të gjatë e të hollë dhe me erë të këndshme; fryti i kësaj bime. Bishtajat (kokrrat) e vaniljes.
- VARËS** mb. 2. Që i ngjitet një bime a diçkaje tjetër, kacavarës; që nuk rri drejt më këmbë, që përkulet a që varet, që shtrihet për tokë. Bimë varëse. Kërcell varës.
- VASTAK** m. 1. Tufëz lulësh a kokrrash, që dalin së bashku në një bisht ose në një kërcell të hollë dhe që varen poshtë si kalli gruri; vile, bistak. Vastak arre. Vastak shelgu. Vastak qershie. Një vastak rrush. Kishin rënë vastakët.
- VATH** m. * Iu bë vath në vesh dikujt shih te VESH, ~I. E vari (e vuri, e mban, e ka) vath në vesh diçka shih te VESH, ~I. Vath i florinjte në vesh të derrit shih te FLORINJTË (i,e). Lule vathi shih te LUL/E, ~JA.
- VE** f. * Lule veje (veze) shih te LUL/E, ~JA.
- VEDËR** f. * Bie shi me vedra bie shi i madh, bie shi me gjyma. Lule vedre shih te LUL/E, ~JA.
- VEMESOR** mb. anat. Që është i veshur a i mbuluar me një cipë të hollë, me vemesë (për një farë, për qelizën etj.); që është si vemesë. Cefël vemesore.
- VENJË** f. Shkurre jo e lartë e viseve malore, me lëvore ngjyrë hiri të errët, me degë të holla, me gjethe në trajtë fluskash në degët e sipërme e në trajtë halash në degët e poshtme, që bën kokrra të trasha me fara brenda dhe përdoret për të bërë vegla shtëpiake e sende zbukurimi.
- VERË** I f. Lule vere shih te LUL/E, ~JA.
- VERR** m. Dru i ulët me lëvore të lëmuar ngjyrë hiri, me gjethe vezake e të dhëmbëzuara, dhe me lëndë të fortë që rritet buzë lumenjve e në vende me lagështirë dhe që përdoret zakonisht në ndërtim. Verri i bardhë. Verri i zi. Dru verri. Gjethe verri. Pyll me verra.
- VERRI** m. Verr. Druri i verririt.
- VESH** m. Bar veshi shih te BAR, ~I 1. Dhëmballët e veshit shih te DHËMBALLË, ~A 1. Gishti i veshit shih te GISHT, ~I 1.
- VESH GOMARI** Veshgomar, babanik
- VESHLEPUR** m. Bimë barishtore njëvjeçare, me kërcell zvarritës, me gjethe të zgjatura si vesh lepur, me lule të bardha në trajtë kupe dhe me frytin si kapsulë të mbushur me fara të helmëta, që mbin zakonisht nëpër arat me grurë.
- VESHTULL** f. 1. Gjini bimësh që rriten në vende me klimë të nxehtë a të butë, me gjethe të trasha, me lule që dalin në majë të degëve, me fryt të tultë e me shumë fara brenda. Veshtulla e bardhë bimë barishtore e vendit tonë me gjethe pa bisht, me lule të verdheme, që mbin e rritet si bimë parazitare në degët e disa drurëve

- të mëdhenj (në plepa, lisa, pisha, gështenja etj.) dhe që bën kokrra të vogla sa një qiçër e me një lëng ngjitës. Veshtulla e lisit (e plepit, e gështenjës).
2. Veshtullake.
- VETËPJALMIM** m. Pjalmimi i luleve me polenin e vet. Vetëpjalmimi i luleve (i thekrës, i tërshërës).
- VEZË** f. Lule veze (veje) shih te LUL/E,~JA.
- VEZORE** f. 2. Pjesa e poshtme dhe e fryrë e pistilit të lules, që formohet pas pjalmimit të saj. Vezorja e lules.
- VËLLA** m. 6. Kalli misri, gruri etj., që del e rritet njëkohësisht nga e njëjta rrënjë; këlysh; vet. disa kallinj misri të ngjitur së bashku. Bimë me shumë vëllezër. Ka nxjerrë vëllezër. Kanë dalë vëllezër.
- VËLLAZËRIM** m. Vëllazërimi i grurit. Frymë vëllazërimi.
- VËLLAZËROJ** kal. 2. jokal. vet. veta III Nxjerr bisqe a filiza nga i njëjti vend, nxjerr vëllezër. Vëllazëron gruri (elbi, tërshëra, orizi). Vëllazërojnë të lashtat.
- VGJE** m.
Pishë e zezë, kreshtë, halë; pishë e butë. Kurora e vgjerit. Pyll me vgjenj. Dru vgjeri. I gjatë si vgjeri.
- VIDH** m.
1. Dru i lartë që rritet nëpër pyje, me trung të drejtë, me kurorë të gjerë, me gjethe vezake të mprehta në majë, me lëvore në ngjyrë të kuqërremtë, që ka lëndë të fortë dhe përdoret në ndërtim e për mobilie. Dru vidhi. Kurora e vidhit. Trung vidhi.
- VIDHEZ** f. Kokrra e caracës, kalibobë.
- VIDHORE** f. vet. Familje drurësh e shkurresh, ku bëjnë pjesë vidhi etj.
- VIGJËZ** f. Grashinë.
- VILE** f. 2. Lulesë e disa bimëve e drurëve, që përbëhet prej lulesh të mbledhura tufë në një bisht të përbashkët si një vesh rrushi. Vile lulesh. Vilet e jargavanit.
- VISHNJË** f. 1. Lloj qershie që bën kokrra ngjyrë të kuqe të errët dhe pak majhoshe; kokrrat e kësaj peme. Vishnje e butë. Ngjyrë vishnje. Lëng vishnje. Reçel vishnje.
* VISHNJË E EGËR Shkurre a dru i ulët me gjethe të rrumbullakëta, me lule të imëta, të bardha e me erë të këndshme, që bën kokrra sa një qershi e vogël, në ngjyrë të zezë, pa lëng e të hidhura; qershi e egër.
- VIZAK** mb. 2. Që vjen i zgjatur dhe është njësoj në të gjithë gjatësinë e vet. Gjethe vizake.
- VIZHË** f. * Lule vizhe lulevizhë;
- VJEGJËS** m. Shkurre e vendeve mesdhetare e të ngrohta, me degë të holla e të gjata, me gjethe treshe të vogla e vezake, me lule të verdha në trajtën e një fluturë në majë të çdo kërcelli të ri, që rritet më shumë në shkëmbinj e në troje malore.
- VJESHTË** f. * Lule vjeshte shih te LULE,~JA.
- VJOLLCË** f.
- VRESHT** m. * Si lepur në vresht shih te LEPUR,~I. Flet në arë e në vresht shih tek AR/Ë,~A. Shkoi (u vra) si qenë në vresht (në rrush) shih te QEN,~I. Hajde baba të të tregoj vreshtin (arat)! iron. shih BABA,~I. Lule vreshti dorëzonjë, lulevreshtë.
- VRUSHKULLORE** f. Ferrac.
- VULËR** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të trashë e të drejtë, me gjethe të gjata e të holla, me lule në trajtë tufëze në majë të çdo kërcelli, që mbin e rritet zakonisht nëpër ara dhe që dëmton të mbjellat; tallë.
- XANË** f. sh 1. Gjineshtër. Lule xane. Litar xane. Torbë (hejbe) xane. Thur me xana.
- XERXELE** f. Shkurre e ulët helmuese me lëvore të murrme, me gjethe vezake të zgjatura, me lule të bardha e me erë të këndshme që çelin gjatë muajit maj; bar thëllëze. Lulet e xerxeles.

- XINË** II f. Shkurre me shumë degë, me lëvore të murrme leskra-leskra me gjethe vezake përherë të blerta që përmbajnë tanin e me lule të kuqërreme në vile që lidh si fryt disa kokrra të vogla të zeza, nga të cilat nxirret një lloj vaji me erë të këndshëm; shqind. Degë xinash. Pyll xinash.
- XINXIFE** f. sh Hide.
- XUNKTH** m. sh 1. Bimë barishtore që rritet në brigjet e lumenjve, të liqeneve ose nëpër kënetat, me shumë kërcje pa gjethe, të rrumbullakët, të hollë e të epshëm, të cilët përdoren për të bërë shporta, fshesa etj., për të mbuluar çatitë e kasolleve etj.
- XUNKTHORE** f. 1. vet. Familje bimësh ku hyjnë xunkthi dhe disa bimë të tjera të ngjashme me të.
- XHENXHEFIL** m. Bimë barishtore shumëvjeçare e vendeve të nxehta, me gjethe si heshta e me lule të verdha, rizomat e së cilës kanë një lloj vaji dhe përdoren të thara për t'u dhënë erë të mirë pijeve, gatesave etj. Vaj xhenxhefil. Salep me xhenxhefil. Me karafil e xhenxhefil. I hedh xhenxhefil.
- XHIXHËLL** f. Bimë barishtore dyvjeçare e dëmshme, me kërcell të drejtë, me gjethe bardhoshe, me lule në ngjyrë të kuqe, që mbin në kullota a në gurishte.
- XHUFKË** f. 4. Bimë barishtore shumëvjeçare e livadheve, me gjethe të gjata e të ashpra që dalin tufë nga rrënjët dhe me lule të imëta ngjyrëmanushaqe mbi një kërcell të hollë, të cilën nuk e ha bagëtia.
- YLL** m. b) i ka kaluar koha, e kapërceu kulmin e vet e tani shkon drejt rënies. U pjek ylli kanë një natyrë ose zakone, dëshira e synime të njëjta, shkojnë mirë njeri me tjetrin; kanë gjetur njëri-tjetrin. Iu shua ylli diçkaje shih te SHUHEM. Ylli i ballit lulja e ballit. Me yll në ballë i shquar midis të tjerëve; trim i madh. Si yll i këputur shih te KËPUTUR (i, e). Sheh yllin e merr pyllin thuhet për dikë, që nuk matet para se të bëjë diçka, që shkon pas berihisë. Lule ylli shih te LUL/E,~JA.
- YLLËS** m. 1. Lloj karafili i vogël, që ka zakonisht pesë petla në ngjyrë trëndafili.
- ZABARI** f. Bimë barishtore shumëvjeçare, me kërcell të drunjëzuar, që rritet nëpër vende të thata dhe që përdoret në mjekësinë popullore për të shëruar sifilizin.
- ZAKUM** m. krahin. Helmës.
- ZAMBAK** m. Bimë me kërcell të hollë e të drejtë, me zhardhok të vogël, me gjethe të gjata si heshtë, me lule si hinkë në ngjyrë të kuqe, të bardhë, të verdhë etj. dhe me erë të mirë, që lulëzon në fillim të verës dhe që rritet për zbukurim. Zambak i bardhë (i kuq, i verdhë). Zambak fletëgjërë. Zambaku shqiptar. Zambak uji (deti). Lule zambaku. Erë zambakësh. Tufë zambakësh. I bukur si zambak.
- ZAMBAKORE** f. vet. Familje bimësh, në të cilën bëjnë pjesë zambakët, zymbylat, qepët e hudhurat. Familja e zambakoreve.
- ZBARDHËSH** m. Zbardhulinë.
- ZBARDHULINË** f. Shtresë e hollë, e zbërdhulët, që gjendet ndërmjet pjesës së drurit dhe lëkurës së drurit; barmë. I heq zbardhulinën.
- ZBEHTË** mb. * Tërshërë e zbehtë shih tek TËRSHËR/Ë,~A.
- ZERDELI** f. Pemë e afërt me kajsinë, që bën kokrra më të vogla, me ngjyrë të verdhë, me erë të këndshme dhe me bërthamë të hidhur; kokrrat e kësaj peme. Reçel zerdëlie. Bërthama e zerdëlisë.
- ZGJEBE** f. mjek. veter. * Bari i zgjebes shih te BAR,~I I.
- ZGJEBËÇ** m. Shkurre kacavarëse, e gjatë pesë-gjashtë metra, me gjethe të vogla rënëse, me lule të bardha ose ngjyrëvjollcë, që bën kokrra të vogla me bisht të shkurtër.
- ZGJOHEM** vetv. Po zgjohet natyra. Bimët janë zgjuar. U zgjua fara. U zgjua pylli. U zgjua miniera (qyteti).

- ZGJUAR** mb. 4. Që sapo ka nisur të mbijë, që sapo ka filluar të ngallojë. Syth i zgjuar. Farë e zgjuar.
- ZI** mb. Myku i zi. Pisha e zezë. Dëllinja e zezë. Mani i zi. Ulliri i zi. Preshi i zi. Trëndafili i zi. Lakra të zeza. Sinapi i zi.
- ZJARR** m. Lule zjarr i shih te LUL/E,~JA. Zjarri i egër (zjarri i duhanit) sëmundje që u bie gjetheve të duhanit e që shfaqet me njolla të murrme.
- ZJARRTH** m. 2. Sëmundje e disa bimëve si duhani, misri, rrushi etj., që u djeg gjetet.
- ZOGËL** f. 1. Shkurre a dru i vogël me myjë ngjyrë trëndafili, me gjethe rënëse, të gjera e me bisht të gjatë, me kokrra të rrumbullakëta e të zeza kur piqen, lëvorja e kokrrat e së cilës përdoren për ngjyrosje dhe në mjekësi. Zogla e shkëmbinjve (e bjeshkëve). Lulet e zoglës. Druri i zoglës.
- ZOKTH** m. Vadhëviçja e bardhë.
- ZONJË** f. * Zonjë e bukur helmarinë. Zonjë e mirë euf. sëmundja e lisë. Lule zonje shih te LUL/E,~JA.
- ZVARRANIKE** f. 2. Lloj luleje me kërcell të hollë, i cili zvarritet e ngjitet zakonisht nëpër mure dhe në pemë. Çeli zvarranikja.
- ZYMBYL** m.
Bimë barishtore me zhardhok të vogël, me gjethe të zgjatura si heshtë, me lule të vogla si hinkë e zakonisht të grumbulluara në tufë, në ngjyrë të kaltër, të bardhë, trëndafili etj. dhe me erë të mirë, që lulëzon në fillim të pranverës. Zymbyl i kaltër (i bardhë). Erë zymbylash. Kanë çelur zymbylat.
- ZHABIL** m. 1. Zhabinë. Lulet e zhabilit.
- ZHABINË** f. Bimë barishtore e helmët, zakonisht njëvjeçare, që bën lule të verdha me pesë petla dhe që rritet në toka me lagështirë. Zhabina e arave. Zhabina e ujit.
- ZHABINOK** m. Zhabinë.
- ZHABINORE** f. vet. Familje bimësh barishtore e shkurresh, ku bëjnë pjesë zhabina, kulpra etj.
- ZHAPATRINË** f. Bimë barishtore, rrënja e së cilës përdoret në mjekësinë popullore për të bërë një bar kundër etheve.
- ZHARDHOK** m. Pjesë e rrënjës a e kërcellit të disa bimë si patatja etj., e tultë dhe e fryrë si kokërr, që zhvillohet nën tokë e që mund të përdoret si ushqim. Zhardhokët e patates. Sythat e zhardhokut. E mbjellin me zhardhok. Shumëzohet me zhardhok.
- ZHARDHOKËZIM** m. Veprimi sipas kuptimit të foljes ZHARDHOKËZON. Zhardhokëzim i mir ë(i shpejtë).
- ZHARDHOKËZON** jokal. Krijon zhardhok nën tokë në rrënjë a në kërcell (për disa bimë si patatja etj.).
- ZHARDHOKOR** mb. Që ka zhardhok; që formon zhardhok në rrënjët a në kërcellin e vet nën tokë (për disa bimë si patatja etj.); që trashet e bëhet zhardhok (për rrënjët); që është si zhardhok. Bimë zhardhokore. Rrënjë zhardhokore.
- ZHUKË** I f. 1. Lloj xunkthi, me rrënjë të gjerë dhe me fije të holla e të gjata, që dalin drejtpërdrejt nga rrënja dhe që mbarojnë sipër me një krekëz të mbushur me fara dhe me një gjemb. Krekëza zhuke. Shkulën (dogjën) zhukat. U fshehën nëpër zhuka.
- ZHUKORE** f. vet. shih XUNKTHORE,~T.
- ZHULICË** f. Lloj gruri i vendit, mielli i të cilit është i mirë për petë. Zhulica e bardhë grurë me hala të shkurtra, të cilit i shkunden kokrrat lehtë. Zhulica e kuqe grurë pa hala, që mbillet kryesisht në toka kodrinore e malore.
- ZHUMBRICË** f. Bar që rritet si tufë në livadhe e kullota, me gjethe të vogla ngjyrë hiri e me erë të mirë, që përdoret në mjekësi e si erëz për gjellë. Era e zhumbricës. Kundërmon zhumbrica.